TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

# RAPORTI

# I

# VETËVLERËSIMIT

# PËR

# AKREDITIMIN INSTITUCIONAL PERIODIK

GRUPI I VETËVLERËSIMIT:

1. Prof. Asoc. Dr. Rezart Dibra Kryetar
2. Gerti Dajçi, PhD Anëtar
3. Dr. Enkeleda Shehi Anëtar
4. Kd. Dr.Xhezmije Lulo Anëtar
5. Sidorela Marini, MSc. Anëtar
6. Endi Saliko Anëtar (Student)

Datë 21.02.2025

Përmbajtja


1. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit....3
2. Historiku i TBU-së....5
3. Fusha I "Institucioni i Arsimit të Lartë, Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i Cilësisë"....11
4. Fusha II "Burimet dhe Partneriteti"....21
5. Fusha III "Programet e Studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi"....41
6. Fusha IV "Aktiviteti Shkencor / Artistik dhe Inovacioni"....67
7. Fusha V "Studentët dhe Mbështetja e Tyre"....92
8. Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm....106
9. Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së....111

## 1. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Kolegji Universitar: "Tirana Business University" (TBU) përbën aktivitetin aktualisht të vetëm të "Tirana Business University sh.p.k. (TBU sh.p.k.). Pas parapërgatitjeve të duhura aktiviteti i TBU-së filloi në vitin akademik 2010-2011, mbi bazën e licensës së akorduar nga Këshilli i Ministrave, me vendim Nr. 794, datë 6.10.2010[1].

Në fund të vitit të tretë akademik, TBU mori akreditimin institucional dhe të çdo programi Bachelor dhe Master, me vendim Nr. 506 datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit dhe Urdhrin Nr. 326, dt. 15.08.2013 të Ministrisë së Arsimit[2].

Mbi këtë bazë, TBU diplomoi me sukses brezin e parë të studentëve në ciklet Bachelor dhe Master dhe vijoi më tej duke iu përmbajtur qëllimit fillestar për një shkollë universitare të vogël, por cilësore, korrekte në zbatimin e legjislacionit në fuqi. Gjate vitit akademik 2016-2017, TBU ju nënshtrua procesit të riakreditimit institucional, proces që u finalizua me Vendimin e Bordit të Akreditimit (BA) të ASCAL, Nr.104, dt. 10.11.2017. Vendimi i BA ishte pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 3 vite. Në përfundim të vlefshmërisë së këtij akreditimi, në vitin 2021 TBU i nënshtrohet procesit të riakreditimit, proces që u finalizua me Vendimin e Bordit të Akreditimit të ASCAL, Nr.56, dt. 16.12.2021. Vendimi i BA ishte pozitiv me një kohëzgjatje prej 5 vitesh. Për rekomandimet e lëna nga BA, TBU hartoi një plan veprimi për t'i realizuar brenda afateve të vendosura në të[3].

Me daljen e Ligjit 80/2015: "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statuti i TBU-së, me Vendim të Senatit, në Tetor 2016, u përshtat në përputhje me këtë ligj, dhe më tej, pas takimeve dhe konsultave me MASR u aprovua versioni final i tij, fillimisht nga Bordi i Administrimit në 26 Qershor 2017, dhe më pas nga Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 10 Korrik 2017. Statuti u aprovua nga MASR me Urdhër të Ministrit të Arsimit Nr.417, datë 20.09.2017[4].

Si rezultat i ndryshimeve në strukturën institucionale të TBU, në Shkurt 2023 Senati Akademik dhe Bordi Administrimit miratuan ndryshimet e reja në Statutin e TBU-së. Pas takimeve me MASR u aprovua versioni final i tij me Vendim Senati Nr.8 dt. 10.05.2024 dhe Vendim Bordi Administrimit Nr. 6 dt. 09/05/2024. Me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve Nr. 246 dt. 25.05.2024, miratohet statuti me ndryshimet përkatse[5].

TBU është një institucion i vogël, me jo më shumë se 600 studentë, dhe për këtë arsye edhe Ligji 80/2015 në nenin 17 pika 7 ka pranur që, për kolegjet universitare me më pak se 600 studentë, të përjashtohen nga detyrimi për të respektuar nenin 25 pika 4 e këtij ligji. Në

---

[1] 39. TBU_Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06. 10. 2010 Licensimi i TBU.

[2] 39.1. Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 506, dt 18.07.2013; 39.2. Urdhër MAS Nr. 326, dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve.

[3] 39.7. Vendim i Bordit Akredititimi Nr. 104. dt 10.11.2017 Akreditimi i dytë Institucional TBU; 39.8. Vendim BA- ASCAL Nr. 56. dt. 16.12.2021 Akreditmit Institucional Periodik TBU; 01. Plani Veprimit TBU.

[4] 39.3. Vendim Senati Akademik Nr. 34-1 dt.17.10.2016 Për miratimin e Statutit dhe Organigramës; 39.4. Vendim Bordi Nr. 18 dt.26.06.2017 Mbi Statutin e TBU në përputhje me LAL; 39.5. Vendim Senati Akademik Miratim i Statutit 2017; 39.6. Urdhër MASR Nr.417 dat.20.09.2017 Miratimi i Statutit TBU.

[5] 13.1.1. Procedura vendim për ndryshime në Statut nga TBU; 13.1.2. Procedura e miratimit të ndryshimeve në Statut nga MAS.

përputhje me këtë ligj, TBU ka hartuar dhe dakordësuar marrëveshjen e parë me MASR në Nëntor 2018 dhe më pas si rezultat i ndryshimeve strukturore të institucionit ka lidhur marrevshjen e dytë në Korrik të 2024 me MASR, lidhur me përcaktimin e numrit të personelit akademik me kohë të plotë në njësitë bazë[6].

Që në krijim, TBU ka përcaktuar kuota të kufizuara pranimi, me nivel maksimal 100-120 studentë në vitin e parë të ciklit Bachelor për të dy fakultetet së bashku. Për rrjedhojë, numri në total i studentëve në një vit akademik, në kushtet e operimit me kapacitet të plotë të TBU-së, për të dy ciklet dhe të dy fakultetet është stabilizuar në rreth 500 studentë. Për sa i përket stafit akademik me kohë të plotë, TBU i ka përmbushur dhe tejkaluar kërkesat sipas marrëveshjes që TBU ka lidhur me MASR, të përmendur më lart, ku për këtë vit akademik numëron në total 27 anëtarë, si personel akademik me kohë të plotë.

Lidhur me përgatitjen e dokumentit të vetëvlerësimit, ai është produkt i një procesi vijues, të përditshëm e të përvitshëm vetëvlerësues, por edhe i një procesi *ad-hoc* i këtyre tre muajve të fundit. Ai është kontribut i çdo strukture akademike apo administrative, i studentëve si dhe i partnerëve tanë.

Dokumenti i vetëvlerësimit bazohet në: i) dokumentet bazë, si: Statuti, Rregullorja e Institucionit, Rregulloret specifike, Rregulloret e programeve; ii) në dokumentacionin e plotë të mbajtur ndër vite për veprimtarinë dhe vendimet e strukturave statutore; iii) në të dhënat statistikore, sasiore dhe/ose cilësore të akumuluara ndër vite; iv) në dokumentacionin shkresor të komunikimit dhe bashkëveprimit me autoritete shtetërore dhe palë të treta.

[6] 10. Marrëveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik; 10.1. Marrëveshja e MAS_TBU_ 2018 _ Përcaktimi i Personeli Akademik.

## 2. Historiku i TBU-së

Tirana Business University College (TBU) e filloi veprimtarinë në vitin akademik 2010-2011 me 15 studentë Bachelor dhe 29 studentë Master. Vit pas viti, me një rritje graduale e të mirëkontrolluar, TBU ka sot 500 studentë, gjithsej.

Pasi nisi veprimtarinë në Tetor të vitit 2010, TBU mori akreditimin institucional dhe të të gjitha programeve të studimit me Vendimin nr.326, dt.15.08.2013 të Ministrit të Arsimit[7]. TBU ka diplomuar 10 breza të studentëve në Bachelor dhe në Master. Mbi 86% e studentëve të TBU-së janë punësuar gjatë studimeve, ose fill pas tyre, në biznese të njohura si: Tirana Bank, Raiffeisen Bank, Neptun Albania, Spar Albania, Mane Development, BALFIN Real Estate, BALFIN Shpk, Deloitte, Credins, Philip Morris, apo në kompani të tjera jashtë vendit.

Në vitin akademik 2016-2017 u arrit për herë të parë realizimi i kuotave maksimale të pranimeve në vitin e parë të ciklit Bachelor (përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit) prej 108 studentë gjithsej, përmes një procesi konkurrues me raport rreth 4 aplikantë për kuotë. Në vitet e mëpasme akademike ky raport ka variuar nga 4 deri në 8 aplikantë për kuotë. Në vitin akademik 2019-2020 gjithashtu numri i aplikantëve në programet master ishte më i madh se kuotat e pranimit në këto programe. Për vitin akademik 2020-2021, TBU u përball me një situatë të jashtëzakonshme, për shkak të pandemisë së COVID-19, që kërkoi kalimin e menjëhershëm në mësimin online, në përputhje me udhëzimet e MASR. Megjithatë, edhe në këto kushte të vështira, TBU arriti të realizonte të gjitha objektivat e tij për mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe aktivitetet e tjera akademike. Ky rezultat tregon fleksibilitetin dhe angazhimin e universitetit, për të ruajtur cilësinë e arsimit dhe për të siguruar që studentët të vazhdojnë të përfitojnë nga mundësitë e arsimimit të avancuar, pavarësisht sfidave të krijuara nga pandemia.

Totali i studentëve për vitin akademik 2020-2021 në TBU ka qenë 527 studentë, ku 329 studentë ishin në ciklin e studimit bachelor dhe 198 studentë në ciklin master për të dy fakultetet, Fakultetin e Administrimit të Biznesit dhe Fakultetin e Drejtësisë[8].

Ndërsa për vitin akademik 2021-2022 në TBU ka qenë 474 studentë, ku 284 studentë ishin në ciklin e studimit bachelor dhe 190 studentë në ciklin master për të dy fakultetet, Fakultetin e Administrimit të Biznesit dhe Fakultetin e Drejtësisë[9].

Totali i studentëve për vitin akademik 2022-2023 në TBU ka qënë 443 studentë, ku 252 studentë i përkasin ciklit të studimit bachelor dhe 191 studentë ciklit master për të dy fakultete, Fakultetin e Administrimit të Biznesit dhe Fakultetin E Drejtësisë[10].

Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit janë dy strukturat e reja të TBU-së, pas ristrukturimit të universitetit. Ky hap tregon një zhvillim të rëndësishëm në ofrimin e mundësive të arsimit të specializuar, duke përmirësuar mundësitë për

[7] 39.2. Urdhër MAS Nr. 326, dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve.

[8] 35.1. Raporti Vjetor TBU 20-21.

[9] 35.2. Raporti Vjetor TBU 21-22.

[10] 35.3. Raporti Vjetor TBU 22-23.

studentët dhe krijuar një fokus të thelluar në fushat e biznesit, drejtësisë, teknologjisë dhe informacionit.

Tirana Business University (TBU) ka si qëllim rritjen e numrit të studentëve vit pas viti, duke ruajtur standardet e cilësisë së arsimit. Ky objektiv është i orientuar për të ofruar mundësi më të shumta për studentët, ndërkohë që sigurohet që cilësia e mësimdhënies dhe mbështetjes për studentët të mbetet në nivele të larta. Kjo përpjekje ka për qëllim të sigurojë një balancim të mirë midis numrit në rritje të studentëve dhe ofrimit të një edukimi të cilësisë së lartë, duke garantuar që çdo student të përfitojë një përvojë akademike të pasur dhe relevante[11].

Krahas rezultateve në formimin teorik rezultatet më të rëndësishme të arritura, nga fillimi i aktivitetit e deri më sot, janë ato lidhur me punësimin e studentëve në pozicione pune të lidhura me profilin e studimit.

Përfshirja e studentëve në procese pune dhe praktike në një fazë sa më të hershme ndihmohet nga Zyra e Karrierës dhe Çështjeve Studentore. Në ciklin e studimeve Bachelor në vitin akademik 2020-21 u diplomuan 111 studentë (28 studentë në E Drejtë Biznesi), nga të cilët 83 studentë rezultojnë të punësuar në profil. Në ciklin e studimeve master në vitin akademik 2020-2021[12]; u diplomuan gjithsej 121 studentë, (16 studentë në E Drejtë Biznesi), nga të cilët rezultojnë të punësuar 115, e nga këto, 112 në profil. Nga këto në profil mbi 50 prej tyre raportuan ngritje në përgjegjësi dhe/ose page.

Në ciklin e studimeve bachelor në vitin akademik 2021-2022[13]; u diplomuan 106 studentë (19 studentë në E Drejtë Biznesi), nga të cilët 15 studentë rezultojnë të punësuar në profil. Në ciklin e studimeve master në vitin akademik 2021-22 u diplomuan gjithsej 97 studentë, (17 studentë në E Drejtë Biznesi), nga të cilët rezultojnë të punësuar 78 e nga këto 75 në profil.

Në ciklin e studimeve bachelor në vitin akademik 2022-2023[14]; u diplomuan 62 studentë (1 student në E Drejtë Biznesi), nga të cilët 51 rezultojnë të punësuar dhe nga këto studentë rezultojnë të punësuar në profil 37. Në ciklin e studimeve master në vitin akademik 2022-2023 u diplomuan gjithsej 66 studentë, (4 studentë në E Drejtë Biznesi), nga të cilët rezultojnë të punësuar 63 e nga këto 45 në profil.

Për vitin akademik 2023-2024, të dhënat janë mbledhur nëpërmjet një pyetësori të realizuar me një kampion studentësh nga çdo cikël studimi. Konkretisht, nga 57 studentë të pyetur të ciklit të parë (Bachelor), 28 prej tyre janë të punësuar, që përbën rreth 50% të totalit. Ndërkaq, nga 30 studentë të ciklit të dytë, 23 janë të punësuar, që përbën rreth 77%. Këto shifra pasqyrojnë një vlerësim të studentëve në secilin cikël studimi dhe do të shërbejnë si një indikacion i mundshëm deri në momentin kur të kemi shifrat reale të punësimit[15].

Shkalla e lartë e punësimit është rezultat i modelit të shkollës dhe lidhjeve të saj të shumta me botën e biznesit. Procesi mësimor është ndërtuar si avancim i njëkohshëm dhe harmonik mes mësimit në auditor me praktikën profesionale.

---

[11] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 35. Raporti Vjetor TBU 23-24.
[12] 35.1. Raporti Vjetor TBU 20-21.
[13] 35.2. Raporti Vjetor TBU 21-22.
[14] 35.3. Raporti Vjetor TBU 22-23.
[15] 35. Raporti Vjetor TBU 23-24.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

Praktikisht, TBU është ngritur që në fillim me synimin e arritjes së një treguesi të lartë të punësimit të studentëve, si rregull përpara mbarimit të studimeve.

Praktikat e studentëve të TBU kryhen sipas një plani të mirëmenduar në korporata, banka, agjensi, zyra profesionale të cilat i kushtojnë rëndësi zhvillimit të burimeve njerëzore të sotme dhe të së ardhmes, që rekrutimin dhe karrierën e personelit e bazojnë në meritë dhe jo në lidhje politike apo nepotike. Organizata të këtilla janë të pakta edhe në sektorin privat ndaj, sipas nesh, nuk ka mundësi të garantohet kryerja cilësore e praktikave për një numër të madh studentësh[16].

Ngritja dhe arritjet e derisotme të TBU-së janë bazuar fillimisht në një strategji 2+6 vjeçare zbatuar në tre faza. Faza e parë, vitet 2010-2011, përfshiu parapërgatitjet, licencimin, ngritjen e strukturave dhe testimin e programeve dhe stafeve. Faza e dytë, vitet 2012-2013, përfshiu marrjen e akreditimit institucional dhe të të gjitha programeve dhe diplomimin e brezit të parë të studentëve. Në vitin 2014, u përditësua strategjia fillestare 2012-2017 e, mbi këtë bazë, në vitet 2014-2017 u mundësua edhe rritja numerike në kufijtë e parashikuar të modelit, krahas rritjes së cilësisë së procesit mësimor dhe pasurimin kurrikular, zgjatjes dhe pasurimit të praktikave profesionale, punësimit në shkallë edhe më të lartë të studentëve. Me pas, TBU ka vazhduar me Strategjine e Zhvillimit 2018-2024 dhe sot vijon me Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2024-2029[17].

Për periudhën 2019-2023[18] Tirana Business University (TBU) ka arritur rezultate financiare të qëndrueshme, duke përmbyllur çdo vit me një fitim modest. Ky rezultat pasqyron menaxhimin e efektshëm dhe një rritje të qëndrueshme, që ka mundësuar ruajtjen e një ekuilibri të shëndetshëm financiar. TBU ka garantuar përfitime të vazhdueshme për studentët, stafin dhe partnerët e tij, duke i ofruar mundësi arsimore cilësore dhe duke siguruar një bazë të fortë financiare për zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve dhe projekteve të tij.

Fundi i vitit 2023 dhe fillimi i 2024[19] do të sillnin ndryshime të mëdha për TBU-në, duke i ofruar një bazë të fortë për zhvillim të mëtejshëm dhe arritjen e objektivave ambicioze. Investimi i TBU-së në infrastrukturë dhe teknologji bashkëkohore është një hap i rëndësishëm për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe modern për studentët dhe stafin akademik e administrativ. Në vazhdim të këtyre ndryshimeve, viti 2024 e gjeti TBU-në në një godinë të re, të pajisur me teknologji të avancuara dhe mjedise bashkëkohore, që do të ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e mësimdhënies dhe përvojën e studentëve. Godina e re[20] prej 2,700 m² në zonën e Lundrës do të mundësojë përdorimin e teknologjive më të fundit në mësimdhënie, përfshirë infrastrukturën e rrjetit dhe teknologjinë e informacionit, duke ofruar mundësi për mësim interaktiv. Kënde të përbashkëta dhe mjedise të përshtatshme për studimet grupore do të krijojnë mundësi për bashkëpunim dhe diskutime, ndërsa mjediset e reja do të kontribuojnë në forcimin e komunitetit të TBU-së. Ky ndryshim përputhet me synimet strategjike të TBU-së për rritjen e cilësisë së arsimit, numrit të studentëve dhe forcimin e lidhjeve me industrinë.

---

[16] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi

[17] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

[18] 18.2.2. Pasqyrat Financiare 2022; 18.3.3. Pasqyrat Financiare 2023.

[19] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

[20] 18.3.1. Kontratë Qeraje Godina e Re_TBU-UAT 13.12.2023.

Në vitin 2023, Grupi BALFIN u bë aksionari kryesor dhe mori administrimin e Tirana Business University, duke i dhënë një hov të ri zhvillimit të TBU, për sa i takon rritjes së standardeve, cilësisë, kërkimit shkencor dhe investimeve në infrastrukturë[21].

Kjo shkollë e lartë synon përgatitjen e studentëve me njohuritë dhe aftësitë të nevojshme për të përballuar sfidat e një tregu të punës gjithnjë e më konkurrues dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Përmes ofrimit të programeve të studimit të përshtatura me nevojat e tregut dhe përmes partneritetit me industrinë dhe komunitetin e biznesit, "Tirana Business University College" synon të edukojë një brez të ri profesionistësh, të cilët do të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e një tregu global. Kjo përputhet me nevojat e zhvillimit të vazhdueshëm të ekonomisë shqiptare dhe me kërkesat e një shoqërie moderne, të integruar në tregun ndërkombëtar. Si pjesë integrale e Balfin Group, TBU ka mundësinë të përfitojë nga një sërë avantazhesh dhe sinergjish, si:

- *Mundësi për Bashkëpunim dhe Zhvillim:* TBU mund të përfitojë nga përvoja dhe burimet e Balfin Group, për të zhvilluar programe dhe projekte novative në fushën e arsimit dhe zhvillimit të biznesit e teknologjisë së informacionit.
- *Akses në Rrjetin e Biznesit dhe Industri:* Nëpërmjet Balfin Group, TBU ka mundësi për të ndërtuar lidhje të forta me industrinë dhe bizneset, duke siguruar mundësi praktike për studentët dhe shkëmbim informacioni për fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë së informacionit.
- *Burimet dhe Mbështetja Financiare afatgjatë:* Balfin Group mund të ofrojë mbështetje financiare dhe burime për zhvillimin e infrastrukturës, programeve akademike dhe projekteve novative të TBU-së.
- *Përfitim nga Ekspertiza e Grupit:* TBU mund të përfitojë nga ekspertiza dhe përvoja e Balfin Group në fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë së informacionit, duke e bërë atë një institucion akademik më të përshtatshëm me kërkesat e tregut të punës.
- *Mundësi për Programe të Përbashkëta dhe Shkëmbim Kulturor:* Balfin Group dhe TBU mund të zhvillojnë programe të përbashkëta, shkëmbime studentore, dhe veprimtari të tjera, kombëtare dhe rajonale, që promovojnë shkëmbimin kulturor dhe arsimor.

Në vitin akademik 2023-2024[22], Grupi Balfin, përmes Fondacionit Mane, ka akorduar 7 bursa për studentët e Tiranës Business University (TBU), duke ofruar mundësi të rëndësishme për mbështetje financiare dhe zhvillimin e talenteve. Po ashtu, për vitin akademik 2024-2025[23], ky grup ka rritur angazhimin e tij duke akorduar 14 bursa për studentët e TBU-së, duke e konsoliduar rolin e tij si një partner kyç në edukimin dhe avancimin e të rinjve. Gjithashtu, Grupi Balfin është një nga mbështetësit kryesorë për praktikat dhe mundësitë e punësimit për studentët e TBU-së, duke ofruar mundësi reale për t'u përfshirë në sektorin e biznesit dhe të zhvillimit profesional. Menaxherët e këtij grupi, të cilët kanë përvojë të pasur në menaxhimin e bizneseve dhe industrive të ndryshme, zhvillojnë shpesh biseda, trajnime dhe leksione për studentët, duke i mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi të vlefshme, njohuri të thelluara dhe lidhje

---

[21] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.
[22] 32.5.Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23.
[23] 32.6. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25.

profesionale që do t'i ndihmojnë në karrierën e tyre të ardhshme. Kjo mbështetje e vazhdueshme e Grupit Balfin krijon një mundësi të pasur për studentët e TBU për t'u integruar në tregun e punës dhe për t'u shndërruar në liderë të ardhshëm në industrinë e biznesit dhe teknologjisë.

**Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional**

*Në momentin e paraqitjes së raportit të vetëvlerësimit të IAL-së, lutemi referojuni Fushave të Vlerësimit për Akreditimin institucional dhe të gjithë standardeve të parashikuara në Shtojcën 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", të publikuar në faqen zyrtare të ASCAL.*

*Shtjellimi përkundrejt çdo standardi do të ndihmojë GVB të vlerësojë se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Grupi i vlerësimit të brendshëm duhet të paraqesë tekst përshkrues sesi IAL i përmbush standardet, me referencë në evidencat përkatëse. Vlerësimi duhet të mbështetet me fakte dhe evidenca si dhe i shoqëruar me dokumentacionin e përkthyer në Anglisht, sipas listës së paraqitur në Shtojcën 6.*

*Në fund të tekstit, për çdo fushë vlerësimi, GVB duhet të konkludojë, duke cituar vlerësimin përkatës, se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet për atë fushë, duke deklaruar nëse standardet përmbushen plotësisht, kryesisht, pjesërisht ose nuk përmbushen. Udhëzimet e mëtejshme mbi gjykimin përkundjet fushave të vlerësimit, gjenden në Aneksin 5.*

*Bazuar në gjykimet për çdo fushë vlerësimi, GVB do të konkludojë/arrijë në gjykimin e përmbledhur të vetëvlerësimit, duke identifikuar dhe parashikuar masat që do të ndërmerren nga IAL-ja për përmirësimin në vijim. Më tepër detaje për gjykimin e përmbledhur gjenden në Aneksin 3.*

*Aty ku parashikohet dokumentacion mbështetës, duhet te referohet në tekst dhe/ose të lidhet me adresën përkatëse web. Të gjitha dokumentet mbështetëse të referuara dhe/ose lidhura me adresën web duhet të paraqiten si pjesë e dokumentacionit të vetëvlerësimit.*

# I – INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË

**Standardi I.1 Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.**

Për të realizuar misionin dhe objektivat, Kolegji Universitar Tirana Business University (referuar si TBU në vijim) ka ngritur infrastrukturën e nevojshme dhe ka hartuar dokumentacionin themeltar që mundëson dhe lehtëson mirë-funksionimin institucional të TBU.

Me daljen e Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statuti i TBU-së, me Vendim të Senatit, në Tetor 2016, u përshtat në përputhje me këtë ligj, dhe më tej pas takimeve dhe konsultave me MASR u aprovua versioni final i tij, fillimisht nga Bordi i Administrimit në 26 Qershor 2017, dhe më pas nga Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 10 Korrik 2017. Statuti u aprovua nga MASR me Urdhër të Ministrit të Arsimit Nr.417, datë 20.09.2017[24].

Si rezultat i ndryshimeve në strukturën institucionale të TBU-së, në Shkurt 2023 Senati Akademik dhe Bordi Administrimit miratuan disa ndryshime në Statutin e TBU. Pas takimeve me MASR u aprovua versioni final i tij me Vendim Senati Nr.8 dt. 10.05.2024 dhe Vendim Bordi Administrimit Nr. 6 dt. 09/05/2024. Me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve nr. 246 dt. 25.05.2024 miratohet statuti me ndryshimet përkatëse[25].

Rregullorja e TBU-së gjithashtu është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ka ndjekur të njëjtën rrugë ndryshimesh ashtu si edhe Statuti. Rregullorja është miratuar me Vendim Senati në Nëntor 2017, mbështetur në LAL 80/2015 dhe Statutin e TBU-së. Kjo rregullore më tej është përshtatur në përputhje me VKM Nr.41, Datë 24 Janar 2018, i ndryshuar, dhe është miratuar me Vendim Senati Nr. 3/1, datë 20.06.2019. Në 2023, si rezultat i ndryshimeve në Statut, Rregullorja e Kolegjit Universitar "TBU"[26] është miratuar në përshtatje me këto ndryshime me Vendim Senati Nr.12 dt.20.11.2023.

Të gjitha rregulloret e tjera specifike janë ndryshuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme.

TBU dhe të gjitha strukturat e saj sipas organigramës[27] funksionojnë në përputhje me të gjitha përcaktimet sipas Statutit si edhe akteve të tjera rregullatore.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

[24] 39.3. Vendim Senati Akademik Nr. 34-1 dt.17.10.2016 Për miratimin e Statutit dhe Organigramës; 39.4. Vendim Bordi Nr. 18 dt.26.06.2017 Mbi Statutin e TBU në përputhje me LAL; 39.5. Vendim Senati Akademik Miratim i Statutit 2017; 39.6. Urdhër MASR Nr.417 dat.20.09.2017 Miratimi i Statutit TBU.

[25] 1. Statuti TBU; 13.1.1.Procedura vendim për ndryshime në Statut nga TBU; 13.1.2. Procedura e miratimit të ndryshimeve në Statut nga MAS.

[26] 3.Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 13.14. Procedura e miratimit të Rregulloreve & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2023; 13.15. Procedura e miratimit të Rregulloreve, Politikave & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2024; 13.15.1. Vendim Senati për një ndryshim në Rregulloren e Këshillit Studentor.

[27] 1.1. Organigrama e re me vulën e MAS.

**Standardi I.2 Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë eficiencë në menaxhim.**

TBU, sipas statusit civil/tregtar është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (TBU sh.p.k.), ndërsa sipas statusit akademik është një institucion arsimor i lartë i llojit Kolegj Universitar[28].

TBU i ka ndarë dhe balancuar përgjegjësitë akademike nga ato administruese-financiare sipas parimeve dhe rregullave të detyrueshme të legjislacionit mbi arsimin e lartë, në çdo fazë të evoluimit të këtij legjislacioni, dhe brenda lirisë legjislative për të zgjedhur, ka përcaktuar role dhe strukturë të balancuar e të kontrolluar (*check and balance),* si dhe në përputhje me specifikat e veta të një institucioni me një numër të vetëkufizuar studentësh dhe që operon vetëm në dy fusha dhe vetëm në dy cikle (Administrim Biznesi & Teknologji Informacioni, Bachelor dhe Master[29].

Përputhshmëria e organizimit institucional dhe roleve të autoriteteve dhe organeve me legjislacionin në fuqi dhe standartet e cilësisë, vihet re lehtësisht duke lexuar Statutin, Rregulloren e Kolegjit Universitar "TBU" dhe rregulloret e tjera specifike[30]. Çdo autoritet apo organ zhvillon veprimtarinë në përputhje me këto dokumente rregullatore, dhe në tërësinë e tij procesi i vendimmarrjes pasqyron rolet dhe përgjegjësitë e duhura të tri aktorëve themelorë - Themeluesit/Financuesit e TBU-së; Stafi Akademik; Studentët dhe Alumni – e gjithashtu, të partnerëve të jashtëm të TBU-së.

Në TBU ne besojmë te domosdoshmëria e rolit të secilit prej këtyre aktorëve dhe te veprimtaria e koordinuar dhe e harmonizuar mes tyre, për arritjen e objektivave të përbashkëta. Kjo demonstrohet më së miri përmes akteve të nxjerra nga këto organe në vijimësi të veprimtarisë së TBU, por në veçanti nga rezultatet e arritura në rreth 14 vite veprimtari[31].

---

[28] 1. Statuti TBU.

[29] 1. Statuti TBU; 1.1. Organigrama e re me vulën e MAS.

[30] Statuti TBU; 2. Rregullore e Senatit Akademik; 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 3.1. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë; 3.2. Rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit; 3.3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ; 4.1. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD); 4.2. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë (FBD); 4.3. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI); 4.4. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike (FTI); 4.5. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike (FTI); 8. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale; 15. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmesakademik dhe administrativ të "TBU"; 20. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 20.1. Rregullore për shkëmbimet studentore; 22.2. Rregullore e Arkivit; 23.6. Rregullore e Transferimeve në TBU; 24.1. Rregullore NJSBC; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 36. Rrregullore e Këshillimit Akademik; 37. Rregullore e Bibliotekës; 32.3. Rregullore e Këshillit Studentor.

[31] 13.3. Procedura e zgjedhjes të Senatit; 13.4. Vendimmarrja e zgjedhjes së Rektorit; 13.5. Vendimmarrja e zgjedhjes së Dekanëve; 13.6. Vendimmarrja për përzgjedhjen e Përgjegjësve të Departamentit; 13.6.1. Vendim për emerimin e drejtuesit dhe anëtarëve të QSKEJ 24-25; 13.7. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 13.8.1. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë TBU_ 24; 13.8.2. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FBD_ 24; 13.8.3. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FTI_ 24; 13.9.1. Procedura e përzgjedhjes së KMS_TBU_24; 13.9.2. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FBD_24; 13.9.3. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FTI_24; 13.10. Përzgjedhja e Komisionit të Etikës; 13.14. Procedura e miratimit të Rregulloreve & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2023; 13.15. Procedura e miratimit të Rregulloreve, Politikave & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2024; 13.15.1. Vendim Senati për një ndryshim në Rregulloren e Këshillit Studentor.

**Standardi I.3 Institucioni harton një strategji zhvillimi.**

TBU e bazon zhvillimin e veprimtarisë së saj mbi një strategji 5-vjeçare. Pas zbatimit të planit 2-vjeçar 2010-2011, zhvillimi i mëtejshëm është bazuar në Strategjinë e Zhvillimit 2012-2017, në Strategjinë e zhvillimit 2018-2024 dhe së fundmi në Strategjinë e Zhvillimit 24-29. Në strategjinë e zhvillimit përcaktohen drejtimet kryesore të zhvillimit. TBU ka përcaktuar objektiva strategjike për të shfrytëzuar mundësitë dhe për të adresuar sfidat në veprimtarinë akademike dhe shkencore. Fokus kryesor mbetet suksesi i studentëve përmes programeve fleksibël dhe zhvillimit profesional të stafit. Cilësia e edukimit do të monitorohet vazhdimisht, ndërsa lidhja me biznesin dhe rrjeti i alumni do të ndihmojnë në përshtatjen e kurrikulave me tregun e punës. Rritja e ndërkombëtarizimit synohet përmes kurseve në anglisht, programeve "Study Tour" dhe diplomave të dyfishta. Kërkimi shkencor do të promovohet përmes mentorimit, publikimeve dhe konferencave ndërkombëtare. Do të sigurohen burime për zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve, si dhe mundësi për financim të projekteve. TBU do të angazhohet në studime të aplikuara që pasqyrojnë kërkesat e tregut dhe nevojat institucionale. Optimizimi i binomit pedagog-student do të përmirësojë efikasitetin e transferimit të dijes. Synimi afatgjatë është pozicionimi konkurrues i TBU-së përmes një balance të mirëfilltë midis cilësisë dhe kostos së arsimit.[32]

TBU harton gjithashtu një plan strategjik vjetor[33], në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 24-29. Plani Operacional Strategjik njëvjeçar shërben si një instrument thelbësor për koordinimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të nevojshme për të arritur objektivat e strategjisë së zhvillimit të TBU-së. Nëpërmjet përcaktimit të veprimeve konkrete për një periudhë njëvjeçare, ndarjes së përgjegjësive dhe hartimit të një kalendari të detajuar, plani operacional siguron që të gjitha palët e interesuara të jenë të informuara mbi detyrat dhe afatet përkatëse, duke optimizuar përdorimin e burimeve në mënyrë efektive. Kjo qasje garanton përqëndrim të vazhdueshëm drejt arritjes së objektivave të përcaktuara dhe minimizon humbjet e mundshme të burimeve. Për më tepër, monitorimi dhe rishikimi i rregullt i planit operacional ndihmojnë në identifikimin e çdo problemi apo sfide, duke mundësuar ndërhyrje korrigjuese për të siguruar përparimin e qëndrueshëm të procesit drejt realizimit të objektivave shumëvjeçare të strategjisë së zhvillimit. Ky dokument strategjik kalohet për diskutim dhe miratim në Senatin Akademik (Neni 14 i Statutit) dhe më pas në Bordin e Administrimit (Neni 10 i Statutit)[34].

**Standardi I.4 Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.**

TBU gëzon autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit dhe respekton kufijtë e autonomisë, të cilat përcaktohen në nenin 6 të Statutit[35].

Krahas mbikëqyrjes së përditshme nga autoritetet apo organet akademike, është edhe "Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", e cila ka autonomi operative, dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit dhe raporton vetëm përpara senatit[36]. Misioni kryesor i NJSBC-së është përmirësimi

[32] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

[33] 6. Plani strategjik vjetor 2024-2025.

[34] 1. Statuti TBU; 13.20. Procedura për miratimin e planit strategjik vjetor 24-25.

[35] 1. Statuti TBU, fq.3.

[36] 1. Statuti TBU, Neni 27 fq.14.

cilësor i vazhdueshëm i TBU-së, përmirësim i cili arrihet nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm që mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve dhe strukturave të përfshira në këtë proces[37].

**Standardi I.5 Institucioni favorizon debatin konstruktiv.**

Organet dhe autoritetet drejtuese të TBU-së, secili në rolin e tij statutor, diskutojnë, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën mes tyre me frymë konstruktive dhe pa burokraci të tepërt. Në organet kolegjiale, vendimet janë produkt i diskutimit dhe mirëkuptimit të anëtarëve përkatës që në fazën e identifikimit të çështjes, diskutimit të zgjidhjes dhe miratimit të saj[38]. Këto tipare të procesit vendimmarrës ndihmohen edhe nga fakti që TBU është një organizatë e vogël, e për rrjedhojë, anëtarët e trupave organizativë janë në kontakt të përditshëm mes tyre dhe numri i individëve që përfshihen është i vogël ose i moderuar.

**Standardi I.6 Institucioni publikon veprimtarinë kryesore të organeve kolegjiale, raportin vjetor dhe aspekte të tjera të lidhura me transparencën.**

Institucioni siguron transparencën duke publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe në platforma të tjera komunikimi informacione të rëndësishme për publikun. Përmes publikimit, institucioni garanton aksesin e palëve të interesuara në informacionin e tij[39].
Pas mbylljes të çdo viti akademik, TBU përgatit raportin vjetor të aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit. Ky raport është hartuar referuar në mbështetje të nenit 32 të ligjit Nr. 80/2015: "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr.5, datë 19.02.2018: "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë"- ndryshuar me udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019 për një ndryshim në Udhëzimin nr.5, datë 19.02.2018: "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë".
Duke analizuar punën e një viti, raporti ndihmon për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Raporti është produkt i kontributeve të çdo organi dhe autoriteti statutor, sipas rolit përkatës dhe miratohet nga Senati akademik. TBU i përgjigjet çdo kërkese të MASR dhe institucioneve të tjera publike për raportim periodik[40].

---

[37] 24.1. Rregullore NJSBC.

[38] 8. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale; 13.12. Procesi i vendimmarrjes_planet_mësimore 24-25; 13.11. Vendim për miratimin e planit lëndor semestral (sem.2) 24-25; 13.23. Vendim për strukturën akademike 24-25; 13.14. Procedura e miratimit të Rregulloreve & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2023; 13.15. Procedura e miratimit të Rregulloreve, Politikave & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2024; 13.15.1. Vendim Senati për një ndryshim në Rregulloren e Këshillit Studentor; 24.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 24.5.1. Plan pune i KC TBU 24-25; 24.5.2. Plan pune i KC FBD 24-25; 24.5.3. Plan pune i KC FTI 24-25; 32.4.1. Plan i KMS 23-24 TBU; 32.4.3. Plan i KMS 24-25 TBU; 32.4.4. Plan i KMS 23-24 FTI; 32.4.6. Plan i KMS 24-25 FTI; 32.4.7. Plan i KMS 23-24 FBD; 32.4.9. Plan i KMS 24-25 FBD.

[39] 22.1. Politikat Institucionale të Publikimit të Informacionit.

[40] 35. Raporti Vjetor TBU 23-24; 35.1. Raporti Vjetor TBU 20-21; 35.2. Raporti Vjetor TBU 21-22; 35.3. Raporti Vjetor TBU 22-23.

**Standardi I.7 Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofron.**

TBU krijon dhe zbaton politika dhe procedura të qarta, të dokumentuara dhe të aksesueshme për të siguruar cilësinë e programeve të studimit që ofron. Këto politika dhe procedura përfshijnë përcaktimin e standardeve akademike, metodat e vlerësimit të mësimdhënies dhe të mësim nxënies, përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave, si dhe përfshirjen e studentëve dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e vlerësimit dhe zhvillimit të programeve[41].

Në TBU, sigurimi i cilësisë në programet e studimit realizohet përmes një strukture të mirë organizuar, ku secila njësi ka një rol të qartë në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) monitoron dhe analizon në mënyrë sistematike cilësinë e mësimdhënies dhe të mësim nxënies, duke mbledhur të dhëna përmes sondazheve dhe raporteve të vlerësimit[42]. Dy procese të rëndësishme në këtë këndvështrim janë: realizimi 2 herë në vit, përpara përfundimit të semestrit, i fokus-grupeve dhe pyetësorit me studentët, për të marrë opinionin e tyre lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies si edhe vlerësimin e dijeve. Pyetësori ndërtohet dhe shpërndahet online nëpërmjet TBULMS te të gjithë studentët[43]. Ai lejon mbledhjen e të dhënave me anë të një databazë, ku më pas kalohet në përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultateve[44]. Fokus-grupet në TBU zhvillohen sipas një plani paraprak në nivel fakulteti, duke përfshirë studentë nga cikli i parë dhe i dytë i studimeve me përfaqësim të balancuar sipas notës mesatare, vitit akademik dhe programit të studimit. Diskutimet ndër të tjera fokusohen edhe në cilësinë e procesit mësimor dhe stafit akademik[45]. NJSBC i përdor rezultatet e anketimit të studentëve dhe fokus-grupeve në funksion të sigurimit të cilësisë. Në bashkëpunim me Komisionet e Cilësisë, kjo njësi propozon masa për përmirësimin e programeve akademike dhe garanton që institucionet të respektojnë standardet e akreditimit kombëtar dhe ndërkombëtar[46].

Një rol kyç luan edhe Zyra e Kurrikulës, e cila siguron që programet e studimit të jenë në përputhje me zhvillimet më të fundit akademike dhe kërkesat e tregut të punës, duke bashkëpunuar me ekspertë dhe stafin akademik për rishikimin dhe përditësimin e kurrikulave[47]. Përveç kësaj, Njësitë Bazë Përgjegjëse për Programet e Studimit mbikëqyrin zbatimin e kurrikulave, sigurojnë trajnimin e stafit akademik dhe ndjekin ecurinë e studentëve, duke garantuar që metodologjitë e mësimdhënies të jenë efektive dhe inovative[48]. Në këtë mënyrë, TBU krijon një sistem të

[41] 1. Statuti TBU; 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; 23.2. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU; 24.1. Rregullore NJSBC.

[42] 1. Statuti TBU; 24.1. Rregullore NJSBC.

[43] 24.6. Njoftim për studentët për zhvillimin e pyetësorit; 24.6.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve.

[44] 24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024.

[45] 24.7. Raporti i Fokus Grupeve 23-24.

[46] 24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024; 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024. 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024.

[47] 23.2. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU.

[48] 4.5.2. Raporti vjetor i DBF 2023-2024; 5.2.2. Raporti Vjetor i DD 2023-2024; 5.3.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024; 5.4.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 5.5.2. Raporti vjetor i DIK 2023-2024; 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët.

| |
|---|
| qëndrueshëm dhe transparent të sigurimit të cilësisë, duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve akademike dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale. |
| **Standardi I.8 Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**<br><br>TBU ka në zbatim mekanizma dhe procese të qarta për rishikimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e rregullt të programeve akademike. Përmes këtij procesi monitorimi, identifikohen si sukseset ashtu edhe sfidat e programeve, duke nxitur përmirësimin e vazhdueshëm dhe adoptimin e praktikave më efektive. Kjo realizohet nëpërmjet analizave periodike, mbledhjeve të bordeve këshillimore dhe konsultimeve me aktorë të tregut të punës[49]. Një nga mekanizmat kyç në këtë proces është **studimi i tregut të punës[50]** i cili ofron një vlerësim të vazhdueshëm mbi kërkesat e punësimit dhe përputhshmërinë e programeve akademike me nevojat e industrisë. Kjo analizë siguron që kurrikulat të përditësohen në mënyrë dinamike, duke pasqyruar kërkesat aktuale të sektorit ekonomik dhe të punëdhënësve.<br>Për të garantuar një vlerësim sistematik dhe të paanshëm, **Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përgatit cdo vit akademik relacion**[51], i cili ofron një pasqyrë të hollësishme mbi ecurinë akademike, sfidat e hasura dhe masat për përmirësim. Ky relacion është i mbështetur nga raportet specifike të Komisioneve të Cilësisë në fakultete të ndryshme, siç janë: **raportet KC_FDB[52] dhe KC_FTI**[53].Këto raporte analizojnë efektivitetin e kurrikulave dhe ndikimin e tyre në formimin profesional të studentëve, duke identifikuar aspekte që duhen përmirësuar dhe duke propozuar masa konkrete për rritjen e cilësisë së programeve.<br>Një element tjetër thelbësor i procesit të monitorimit është **angazhimi i studentëve në vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve përmes një pyetësori të dedikuar**[54]. Ky pyetësor u mundëson studentëve të shprehin mendimet e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen akademike dhe metodologjitë e përdorura në leksione dhe seminare. Për të garantuar një pjesëmarrje të gjerë dhe të besueshme, është bërë një **njoftim për studentët mbi realizimin e pyetësorit**[55], duke inkurajuar angazhimin e tyre aktiv në procesin e vlerësimit.<br>Përveç të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve, një tjetër burim i rëndësishëm i informacionit mbi efektivitetin e programeve të studimit është **raporti i fokus-grupeve**[56]. Ky raport përfshin analizën e diskutimeve me studentë, pedagogë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në procesin akademik, duke mundësuar një vlerësim më të thelluar dhe cilësor mbi ndikimin e programeve të studimit. |

[49] 29.1. Studimi i tregut të punës; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.

[50] 29.1. Studimi i tregut të punës.

[51] 24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024.

[52] 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024.

[53] 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024.

[54] 24.6.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve.

[55] 24.6. Njoftim për studentët për zhvillimin e pyetësorit.

[56] 24.7. Raporti i Fokus Grupeve 23-24.

| |
|---|
| Nëpërmjet këtij sistemi gjithëpërfshirës monitorimi dhe vlerësimi, institucioni siguron që programet e studimit të mbeten të përditësuara, të orientuara drejt tregut të punës dhe të pajisura me mekanizma të fuqishëm të vet-përmirësimit, duke garantuar kështu një përvojë akademike cilësore për studentët dhe një përputhje të fortë me objektivat formuese dhe rezultatet e synuara të të nxënit. |
| **Standardi I.9 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.**<br><br>Programet e studimit hartohen për të përmbushur objektivat dhe rezultatet e të nxënit, duke kaluar përmes një procesi të qartë miratimi nga departamentet, Dekanati, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit[57], përpara licencimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Vlerësimi fokusohet në përputhshmërinë me legjislacionin, misionin institucional, prioritetet kombëtare, tregun e punës dhe kapacitetet institucionale. Bazuar në këto tregues, TBU zbaton politika promovuese për të nxitur zhvillimin akademik dhe institucional. Lidhur me ecurinë e programeve të studimit TBU përdor një metodologji studimi sasiore, ku instrumenti kryesor i vlerësimit është pyetësori i miratuar, i cili u dërgohet studentëve me e-mail[58] duke ruajtur anonimitetin e tyre. Ky proces mundëson mbledhjen e të dhënave objektive, për të analizuar cilësinë e programeve dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim, në përputhje me aktet rregullatore dhe treguesit cilësorë të përcaktuar.[59] Përgjigjet ruhen dhe analizohen në mënyrë anonime nga NJSBC, në bashkëpunim me komisionet e cilësisë sipas fakulteteve përkatëse, e përcaktuar dhe në planet e tyre të punës[60], e cila përpunon të dhëna statistikore për të identifikuar problematikat kryesore të perceptuara nga studentët dhe për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë akademike. Po ashtu, TBU përdor **fokus grupet**[61], si një metodë vlerësimi për të mbledhur mendimet dhe sugjerimet e studentëve dhe stafit akademik mbi cilësinë e mësimdhënies dhe programet e studimit. Këto diskutime të strukturuara ndihmojnë në identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim dhe në zhvillimin e strategjive për një përvojë më të mirë akademike. Rezultatet e fokus-grupeve analizohen dhe përdoren për të rritur efektivitetin e mësimdhënies dhe për të përshtatur programet me nevojat e tregut. Për diplomimin dhe tregun e punës, institucioni përdor procedura dhe metodologji vlerësimi për të monitoruar ecurinë e studentëve gjatë programit të studimit dhe për të siguruar që ata janë të përgatitur për kërkesat e tregut të punës. Pjesë e këtij vlerësimi janë analizat mbi aftësitë e fituara nga studentët, mundësitë për punësim pas diplomimit dhe lidhjet me industrinë[62], që ofrojnë mundësi praktike dhe zhvillim profesional. Kjo siguron që programet e studimit janë në përputhje me nevojat e tregut dhe kontribuojnë në një kalim të suksesshëm të studentëve nga arsimi në |

[57] 23.2. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU.
[58] 24.6. Njoftim për studentët për zhvillimin e pyetësorit.
[59] 24.6.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve.
[60] 24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024; 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024; 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024; 24.5.1. Plan pune i KC TBU 24-25; 24.5.2. Plan pune i KC FBD 24-25; 24.5.3. Plan pune i KC FTI 24-25.
[61] 24.7. Raporti i Fokus Grupeve 23-24.
[62] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU; 34.5. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| |
|---|
| karrierë. Po ashtu, studentët që nga viti i parë i studimeve deri në daljen në tregun e punës, përfitojnë mbështetje të vazhdueshme nga një këshilltar akademik, i cili i asiston në orientimin dhe zhvillimin e aftësive profesionale, duke siguruar një kalim të suksesshëm në tregun e punës.[63] Diploma e dhënë për programin studimit përputhet me nivelin e kornizës kombëtare dhe asaj europiane të kualifikimeve. |
| **Standardi I.10 Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre.** |
| TBU parashikon dhe garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. TBU ka përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e qarta për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e cilësisë, duke garantuar ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.[64] Pjesë e këtij procesi janë njësia bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin, personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët të përcaktuar dhe me statut[65], ku studentët janë në fokus përmes marrëdhënieve proaktive dhe mekanizmave të mbështetjes transparente. TBU e konsideron të rëndësishme përfshirjen e studentëve në procesin e vendimmarrjes dhe kanë mundësi të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë, duke përfaqësuar interesat e tyre në organe drejtuese dhe këshilluese, si: në Senatin Akademik dhe komisione të ndryshme. TBU angazhohet maksimalisht për të siguruar që zëri i studentëve të dëgjohet, duke i inkurajuar ata të kontribuojnë në proçesin e të nxënit dhe të ndajnë përvojat e tyre me të tjerët, në mënyrë që të ndiejnë veten pjesë të kolegjit. Sipas rregulloreve të TBU-së, përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese është e garantuar. Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese të Kolegjit, sipas Ligjit 80/2015, ku një anëtar për secilin fakultet i Këshillit Studentor përfaqëson studentët në Senatin Akademik, duke siguruar përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse të rëndësishme.[66] Studentët mund të përcjellin informacionin nga nivelet më të larta në ato më të ulëta dhe anasjelltas, duke krijuar një rrjet të hapur komunikimi që siguron që shqetësimet e tyre të dëgjohen dhe të merren parasysh në proceset vendimmarrëse. NJSBC siguron komunikim të rregullt dhe efektiv me të gjitha nivelet e organizatës për të promovuar cilësinë dhe për të ndarë informacion mbi praktikat më të mira. Gjithashtu, ajo komunikon me palët e interesuara të jashtme për të siguruar që kërkesat e tyre për cilësinë të përmbushen.[67] Si pjesë e paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë, TBU përdor edhe opinionet e pedagogëve. Këtu është e rëndësishme të theksohet se proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë janë të hapura |

[63] 36. Rrregullore e Këshillimit Akademik; 36.1. Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI.
[64] 1. Statuti TBU; 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 24.1. Rregullore e NJSBC; 23.2. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU.
[65] 1. Statuti TBU.
[66] 13.3. Procedura e zgjedhjes të Senatit; 13.7. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 13.8.1. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë TBU_ 24; 13.8.2. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FBD_ 24; 13.8.3. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FTI_ 24; 13.9.1. Procedura e përzgjedhjes së KMS_TBU_24; 13.9.2. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FBD_24; 13.9.3. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FTI_24; 13.10. Përzgjedhja e Komisionit të Etikës; 32.3.1. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25; 32.3.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25.
[67] 24.1. Rregullore e NJSBC.



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| |
|---|
| dhe përfshijnë bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm[68] , të cilët kontribuojnë me mendime dhe rekomandime të vlefshme për përmirësimin e programeve të studimit dhe rritjen e cilësisë akademike. Ky proces i rregullt i vlerësimit siguron përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. |
| **Standardi I.11 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**<br>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë nëTBU janë të ndërtuara mbi parimet e transparencës, efektivitetit dhe përfshirjes, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit [69] dhe vlerat që TBU promovon. TBU siguron publikimin dhe transparencën e informacionit në përputhje me **Politikën Institucionale të Publikimit të Informacionit** [70], duke garantuar akses të hapur për strukturat, shërbimet, proceset e regjistrimit, tarifat e studimit dhe rezultatet akademike. TBU angazhohet në sigurimin e cilësisë përmes **monitorimit dhe analizës së vazhdueshme të të dhënave**, duke përdorur platforma të integruara si: **Google Analytics/ Power BI** për të vlerësuar efektivitetin e informacionit të publikuar. Gjithashtu, TBU zbaton **masa sigurie dhe përditësimi të sistemeve**, duke siguruar një administrim të besueshëm dhe të mbrojtur të të dhënave të studentëve[71]. Për të garantuar që proceset e sigurimit të cilësisë janë efektive, TBU implementon një qasje gjithëpërfshirëse, ku të gjithë aktorët akademikë janë të angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm. **Diversiteti, liria akademike dhe shërbimi cilësor** janë vlera thelbësore që ndikojnë në mënyrën se si zhvillohen programet dhe si krijohet një **Kulturë e Brendshme e Cilësisë.**<br>TBU së fundmi ka marrë nismën për emërimin e Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO). Roli i tij qëndron të sigurojë që organizata të respektojë rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, si: Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) e Bashkimit Evropian. Ai monitoron përputhshmërinë ligjore, këshillon dhe trajnon stafin, mbikëqyr përpunimin e të dhënave, bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse dhe trajton kërkesat e subjekteve të të dhënave. Gjithashtu, vlerëson rreziqet për privatësinë, menaxhon incidentet e sigurisë dhe ndihmon në raportimin e shkeljeve, duke vepruar si një këshillues i pavarur brenda organizatës[72]. |
| **Përfundimi dhe Vlerësimi**<br>TBU ka ndërtuar një infrastrukturë dhe dokumentacion të plotë për të mundësuar funksionimin e duhur institucional. Statuti dhe rregulloret e tij janë përshtatur me legjislacionin në fuqi dhe janë miratuar dhe ndryshuar për t'u përputhur me ligjin 80/2015 dhe akte të tjera normative. TBU siguron që struktura dhe aktivitetet e tij janë në përputhje me këto akte, duke ofruar një sistem të qëndrueshëm dhe të rregulluar mirë për zhvillimin e tij. |

[68] 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.
[69] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.
[70] 22.1. Politikat Institucionale të Publikimit të Informacionit.
[71] 31. TBU - Rregullore e Sekretarisë.
[72] 13.24. Vendim Senati për emërimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave (DPO).

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

TBU është një institucion me përgjegjësi të kufizuar dhe ka një strukturë të balancuar mes përgjegjësive akademike dhe administrative. Struktura menaxhuese e TBU ka ndarë rolet dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin, duke siguruar një funksionim të organizuar dhe efikas. Procesi i vendimmarrjes është i qartë dhe përfshin aktorët kryesorë, si themeluesit, stafin akademik, studentët dhe partnerët e jashtëm, duke kontribuar në arritjen e objektivave të përbashkëta.

TBU ka një strategji zhvillimi të qartë dhe të dokumentuar, e cila është përshtatur për të adresuar mundësitë dhe sfidat në sektorin akademik dhe shkencor. Strategjia e zhvillimit është e bazuar në periudhë 5-vjeçare, me një fokus të veçantë në rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve. Pjesë e strategjisë janë edhe përpjekjet për të rritur ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. Planifikimi vjetor dhe monitorimi i rregullt i aktiviteteve janë instrumente të rëndësishëm për realizimin e këtyre objektivave, duke siguruar një përqendrim në arritjen e suksesit afatgjatë të TBU-së.

TBU respekton kufijtë e autonomisë së tij, duke siguruar një sistem mbikëqyrjeje të strukturuar dhe të pavarur, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) që ka autonomi operative. Ky proces është thelbësor për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit dhe për përputhshmërinë me kërkesat e akreditimit. Institucioni favorizon një kulturë të diskutimeve të hapura dhe bashkëpunuese, duke minimizuar burokracinë dhe siguruar që vendimmarrja është e bazuar në konsensus të plotë dhe në interes të zhvillimit të përbashkët.

TBU ka zhvilluar politika dhe procedura të qarta për sigurinë e cilësisë, duke përfshirë vlerësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit përmes sondazheve, pyetësorëve dhe fokus-grupeve. Pjesëmarrësit, përfshirë studentët dhe pedagogët, janë të angazhuar në këtë proces për të siguruar përmirësime të vazhdueshme.

TBU publikon raportet vjetore të aktivitetit të tij, duke siguruar transparencë të plotë në lidhje me veprimtaritë e institucioneve dhe pasqyrimin e performancës së brendshme dhe të jashtme, sipas kërkesave ligjore.

TBU monitoron dhe vlerëson vazhdimisht programet e studimit për të siguruar që ato mbeten relevante dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe të industrisë. Përdorimi i metodologjive të vlerësimit, përfshirë pyetësorët dhe analizat e tregut të punës, është një element kyç në këtë proces. Proceset e menaxhimit janë të mirë organizuara dhe të drejtuara nga praktikat më të mira ndërkombëtare, ndërsa angazhimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë është i pranishëm në çdo nivel. Si rezultat, janë ndërmarrë masa të forta për të garantuar dhe monitoruar sigurinë e cilësisë, duke siguruar një ambient të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për studentët dhe stafin akademik.

Standardet e **Fushës së vlerësimit: "Institucioni i Arsimit të Lartë, Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i Cilësisë" janë përmbushur plotësisht**.

## II – BURIMET DHE PARTNERITETI

| |
|---|
| **Standardi II.1 Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekruktimit të burimeve njerëzore.**<br><br>TBU punëson staf akademik dhe administrativ me kohë të plotë si dhe, staf akademik dhe mbështetës me kohë të pjesshme. Duke patur parasysh natyrën specifike të procesit të mësimdhënies-mësim nxënies në TBU, i cili qendërzohet te lidhja e teorisë me praktikën, TBU ndjek një strategji efikase për rekrutimin e stafit akademik. Kandidatët për t'u punësuar në TBU duhet të jenë jo vetëm akademikë, por edhe me përvojë në drejtim, administrim, sipërmarrje, shërbime juridike, në sektorin privat dhe/ose publik, me eksperiencë të dallueshme, në mënyrë që të sjellë në auditor realitetin shqiptar.<br>Procesi i rekrutimit të stafit akademik dhe administrativ në TBU ndjek me rigorozitet nenet e rregullores së punësimit, të cilat përcaktojnë kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve. Ky proces është i hapur, transparent dhe i bazuar në merita, duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët. Çdo fazë e procesit përfshin shpalljen e vendeve të lira të punës, pranimin e aplikimeve, vlerësimin e dokumentacionit dhe intervistat, të cilat realizohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet më të larta të cilësisë. Ky qasje siguron rekrutimin e profesionistëve të kualifikuar dhe të angazhuar, të cilët kontribuojnë në zhvillimin akademik dhe administrativ të institucionit[73].<br>TBU është kujdesur që stafi akademik i rekrutuar të ketë kualifikimin e duhur në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Pra, rekrutimi realizohet duke iu përgjigjur nevojave specifike në kohë për staf dhe duke garantuar përzgjedhje me nivel të duhur profesional për nevojën përkatëse per t'u plotësuar në kohën e duhur[74].<br>Gjithashtu, TBU i kushton vëmendje të veçantë dhe përparësi rekrutimit të stafit të diplomuar dhe specializuar në universitete të njohura në shkallë ndërkombëtare. |
| **Standardi II.2 Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.**<br><br>TBU ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ, duke siguruar një mjedis të barabartë dhe të përfshirë për të gjithë individët që kontribuojnë në zhvillimin akademik dhe administrativ. Kjo politikë ka si qëllim krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe mbështetëse, ku çdo anëtar i stafit ka mundësi të zhvillohet dhe të kontribuojë në mënyrë të barabartë dhe të drejtpërdrejtë në arritjen e |

[73] 15. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmesakademik dhe administrativ të "TBU"; 15.1. Politika e BNJ në TBU.

[74] 15. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmesakademik dhe administrativ të "TBU"; 15.1. Politika e BNJ në TBU; 13.13. Vendim për miratimin e personelit akademik njësive bazë - PAE & PAK 24-25; 13.13.1. Vendim për strukturën e personelit akademik 24-2513.11. Vendim për miratimin e planit lëndor semestral (sem.2) 24-25.

objektivave të institucioni. Përmes trajnimeve, mundësive të avancimit dhe një strukture të qartë të komunikimit, synohet të forcohet bashkëpunimi dhe të përmirësohet cilësia e shërbimeve për studentët dhe komunitetin akademik.

TBU informon në mënyrë të rregullt dhe në kohë reale, përmes email-it, rrjeteve sociale dhe në faqen e web-it, të gjithë personelin mbi aktivitete dhe evenimente të ndryshme të karakterit akademik, shkencor, kulturor dhe social të organizuara në institucion ose për llogari të institucionit; TBU inkurajon angazhimin e stafit në këto aktivitete me qëllim gjithë-përfshirjen e personelit[75].

Të paktën 1-2 herë në vit, stafi (akademik dhe administrativ), me kohë të plotë e të pjesshme, angazhohen në ditët informuese, që shërbejnë për të sensibilizuar opinionin dhe shoqërinë rreth programeve të TBU dhe ofertës akademike. Ditët informuese organizohen në mjediset e TBU-së si dhe në mjedise jashtë institucionit, veçanërisht në nisma zyrtare që organizohen nga Ministria e Arsimit dhe institucione të tjera, mbi karrierën, profesionet dhe përzgjedhjet akademike[76].

Me qëllim krijimin apo përforcimin e raporteve konstruktive, miqësore dhe frytdhënëse mes stafit akademik, administrativ dhe studentëve, TBU organizon shpesh aktivitete që sjellin së bashku këto grupe në një frymë kolegjiale, bashkëpunuese dhe miqësore[77].

**Standardi II.3 Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij dhe fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.**

TBU ka si prioritet të punës së saj rritjen profesionale të stafit akademik dhe personelit administrativ. Procesi i përditshëm vendimmarrës dhe zbatimi i vendimeve dhe detyrave të caktuara, monitorohet dhe vlerësohet nga strukturat përkatëse statutore. Stafi ndihmohet dhe udhëzohet për të kapërcyer vështirësitë dhe të papriturat.

TBU ndjek një politikë vlerësimi të aftësive të personelit, e cila përfshin: vlerësimin e performancës në bazë të kritereve të qarta, dhënien dhe marrjen e feedback-ut, identifikimin e nevojave për trajnime dhe zhvillim profesional, angazhimin në projekte dhe aktivitete akademike, si dhe pjesëmarrjen në seminare dhe konferenca. Kjo politikë synon mbështetje dhe rritje të vazhdueshme të aftësive të stafit për të kontribuar në zhvillimin e institucioni[78].

Politika e zhvillimit profesional përcakton qëllimet dhe objektivat e programit të zhvillimit profesional. Ajo përshkruan llojet e zhvillimit profesional që janë në dispozicion të stafit dhe përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre në këtë fushë. Planet për zhvillim profesional janë të lidhura ngushtë me procesin e vlerësimit. Kjo politikë ndërlidhet me politikën e menaxhimit të

[75] 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët.

[76] 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët; 38.3. Ditët informuese në TBU.

[77] 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët.

[78] 15. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmesakademik dhe administrativ të "TBU"; 15.1. Politika e BNJ në TBU; 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.

| |
|---|
| performancës dhe politikën e kurrikulës shkollore, të cilat identifikojnë fushat prioritare që duhet të mbështeten[79].<br>Zhvillimi i procesit mësimor nga stafi akademik kryhet nën koordinimin dhe monitorimin në vijimësi nga strukturat e departamenteve dhe fakulteteve. Çështjet e përditshme zgjidhen me operativitet. Drejtuesit e departamenteve herë pas here vëzhgojnë nga afer mënyrën e kryerjes së procesit mësimor dhe shkëmbejnë mendime, japin sugjerime apo bëjnë vërejtje me pedagogun e lëndës sipas rastit[80]<br><br>Performanca e pedagogëve vlerësohet edhe duke dëgjuar shqetësimet dhe sugjerimet e studentëve, qoftë përmes bisedave që ata realizojnë me këshilluesit akademik e deri te përdorimi i fokus grupeve dhe/ose pyetësoreve anonim. Të qenit një shkollë e vogël është nje avantazh i madh për TBU-në për kryerjen dhe monitorimin me efektivitet të procesit mësimor. Konkluzionet e nxjera nga këto vlerësime i shërbejnë procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave, metodave të mësimdhënies si edhe përmirësimit të komunikimit dhe bashkëpunimit me studentët.<br>Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila ngrihet dhe vepron me vendim Senati dhe raporton përpara tij. NJSBC, në bashkëpunim me komisionet e cilësisë (në rang Institucioni dhe Fakultetit), kryen monitorime dhe analizon në mënyrë sistematike cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, duke mbledhur të dhëna përmes sondazheve dhe raporteve të vlerësimit. Të dhënat përdoren në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë[81].<br>Në vlerësimin e performancës të stafit akademik vlejnë kriteret e disiplinës dhe etikës, risitë që sjellin në procesin mësimor, angazhimin për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve, rezultatet e arritura në lëndët e tyre si dhe përpjekjet që bëjnë për zhvillim e kualifikim profesional, përmes kërkimit shkencor[82] dhe proceseve të tjera formuese.<br>TBU e konsideron të vyer çdo arritje individuale apo kolegjiale të stafit dhe i promovon ato publikisht, ose në mbledhje të strukturave të ndryshme. Stafi i TBU-së gëzon mbështetjen e institucionit dhe inkurajohet nga qasja pozitive, lehtësuese, dhe fleksibël e TBU për të realizuar ambiciet pedagogjike, akademike, apo shkencore në universitetet perëndimore siç janë rastet e studimeve të doktoraturave të kryera këto vite apo në proces e sipër, nga disa anëtarë të personelit akademik. |
| **Standardi II.4 Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social.**<br>TBU, krahas mësimdhënies, i bën të mundur stafit akademik dhe administrativ si dhe studentëve edhe një jetë aktive sociale, duke siguruar pjesëmarrjen e tyre në veprimtari të ndryshme kulturore dhe sportive. |

[79] 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik.

[80] 15. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmesakademik dhe administrativ të "TBU"; 16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu.

[81] 24.1. Rregullore NJSBC; 24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024; 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024; 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024 24.6. Njoftim për studentët për zhvillimin e pyetësorit; 24.6.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve; 24.7. Raporti i Fokus Grupeve 23-24.

[82] 33.2. Indikatorët e matjes së performances.

Aktivitete të ndryshme sociale, siç janë: ekspozita, promovime librash, mbrëmje argëtimi, pjesëmarrje në kampionate sportive amatore etj, organizohen shpesh në TBU. Si evidencë të aktiviteteve me natyrë sociale shërbejnë të gjitha aktivitetet të publikuara me foto në faqen zyrtare të TBU, si dhe në platformat e rrjeteve sociale të TBU.[83] TBU është e angazhuar për të pasur një ndikim pozitiv në shoqëri dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit. Përgjegjësia sociale është një element kyç i misionit të institucionit, duke reflektuar angazhimin e tij ndaj edukimit cilësor, inovacionit dhe mbështetjes së sipërmarrjes.[84] Në kuadër të mbështetjes së arsimit të lartë për të gjithë, TBU ofron bursa sociale për studentët që i përkasin kategorive më vulnerabël të shoqërisë.[85] Këto bursa synojnë të mbështesin studentët nga shtresat vulnerabël, duke përfshirë jetimët deri në 25 vjeç, fëmijët e policëve dhe ushtarakëve që kanë humbur jetën në krye të detyrës, personat me aftësi të kufizuara, si dhe ata që i përkasin komuniteteve romë dhe ballkano-egjiptian. Po ashtu, ndihmohen studentët nga familje me vështirësi ekonomike, të cilët duhet të dorëzojnë dokumentacion për të vërtetuar gjendjen e tyre financiare. Dokumentet e nevojshme për aplikim përfshijnë diplomën dhe certifikatën e maturës, certifikatën familjare, vërtetimin e të ardhurave dhe çdo dokument shtesë që dëshmon situatën ekonomike. Për programet e nivelit Master, kërkohet edhe diploma dhe lista e notave të përfundimit të programit Bachelor.

Aplikimi kryhet në portalin përkatës dhe mbetet i hapur gjatë gjithë vitit, ndërsa shqyrtimi i dosjeve zhvillohet në gusht, përpara nisjes së regjistrimeve në raundin e parë. Kjo skemë bursash synon të sigurojë akses të barabartë në arsim dhe të lehtësojë barrën ekonomike të studentëve, duke i mbështetur në sfidat e tyre akademike dhe financiare.[86]

Nismat Kryesore të Përgjegjësisë Sociale të TBU: **Edukimi dhe Trajnimi për të Rinjtë**: Organizimi i konkurseve kombëtare si "Sipërmarrësit e së Nesërmes" dhe "TECHnovators", që nxisin mendësinë inovative dhe sipërmarrëse te maturantët. **Mbështetja e Studentëve në Biznes:** Trajnime, seminare dhe mentorim për të zhvilluar aftësitë e sipërmarrjes dhe lidershipit. **Inkubatori i Biznesit:** Ofrimi i mbështetjes teknike dhe këshillimore për studentët që duan të zhvillojnë projekte biznesore. **Këshillimi i Karrierës:** Orientim dhe lidhje me tregun e punës për maturantët dhe studentët përmes bashkëpunimeve me kompani dhe profesionistë të industrisë. **Trajnime për Mësuesit dhe Drejtuesit e Shkollave të Mesme:** Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në ekonomi, sipërmarrje dhe teknologji. **Java e Sipërmarrjes Shqiptare:** Promovimi i sipërmarrjes dhe zhvillimit ekonomik në kuadër të Javës së Sipërmarrjes Evropiane. **Ndërtimi i Rrjetit të Sipërmarrësve dhe Alumni:** Krijimi i një platforme bashkëpunimi mes sipërmarrësve dhe profesionistëve të fushës. **Debate, Forume dhe Konferenca Shkencore:** Diskutime mbi çështje të biznesit, teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik. **Veprimtari Kulturore dhe Promovimi i Trashëgimisë Shqiptare:** Ekspozita, forume dhe aktivitete kulturore për ruajtjen dhe promovimin e kulturës kombëtare. **Pjesëmarrja në Diskutime Publike dhe Mediatike:** Kontributi i stafit akademik në analizimin e çështjeve ekonomike dhe sociale. **Shërbime Konsulence për Bizneset dhe Institucionet Publike:**

[83] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

[84] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

[85] 32.2. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite; 32.7. Skema e bursave sociale në TBU; 13.18. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 23-24.

[86] 32.2. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite; 32.7. Skema e bursave sociale në TBU; 13.18. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 23-24.

| |
|---|
| Mbështetje për SME-të, organizatat jo-fitimprurëse dhe sektorin publik. **Fushata Promocionale për Praktikat e Mira të Biznesit:** Mbështetja e sipërmarrjes rinore dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME). Përmes këtyre iniciativave, TBU jo vetëm që ndihmon në përmirësimin e edukimit dhe zhvillimit profesional, por gjithashtu forcon lidhjen mes akademisë dhe komunitetit, duke nxitur inovacionin, sipërmarrjen dhe përgjegjësinë sociale në nivel kombëtar.[87] |
| **Standardi II.5 Institucioni siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik gjatë periudhës midis dy akreditimeve.**<br><br>Institucioni garanton qëndrueshmërinë afatgjatë të personelit akademik, duke ruajtur një strukturë stabël dhe të qëndrueshme të stafit gjatë periudhës midis dy akreditimeve. Kjo arrihet përmes politikave efektive të rekrutimit, zhvillimit profesional dhe mbështetjes institucionale, të cilat sigurojnë vazhdimësinë e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor. Përmes investimit në zhvillimin e karrierës dhe kushteve të favorshme të punës, institucioni krijon një mjedis që nxit angazhimin dhe përkushtimin afatgjatë të stafit akademik ndaj misionit dhe objektivave institucionale. Në përputhje me politikën për zhvillimin profesional të stafit akademik, **TBU ka krijuar një sistem të strukturuar të vlerësimit të stafit**, i cili synon të sigurojë cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe përfshirjes institucionale. Ky sistem **bazohet në një kulturë të vlerësimit të vazhdueshëm**, duke integruar standarde të qarta dhe instrumente të matshme për të monitoruar performancën dhe progresin profesional të pedagogëve.[88] Mekanizmat kryesorë të vlerësimit përfshijnë: **Vlerësimi i performancës në mësimdhënie**, përmes analizës së feedback-ut nga studentët, vëzhgimeve në klasë dhe vlerësimit nga kolegët. **Monitorimi i angazhimit në kërkimin shkencor**, duke marrë parasysh botimet akademike, pjesëmarrjen në konferenca dhe projektet e financuara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. **Integrimi i teknologjisë në procesin mësimor**, ku vlerësohet aftësia e stafit për të përdorur platforma digjitale dhe metoda inovative të të nxënit. **Pjesëmarrja dhe kontributi në zhvillimin institucional**, përfshirë mentorimin e studentëve, pjesëmarrjen në projekte ndërdisiplinore dhe bashkëpunimet me industrinë[89]. Këto mekanizma vlerësimi sigurojnë që stafi akademik të ketë një zhvillim të vazhdueshëm profesional, duke përmirësuar cilësinë e edukimit dhe duke rritur ndikimin e kërkimit shkencor në tregun e punës dhe shoqëri. Përmes një **qasjeje të balancuar midis matjes së performancës dhe mbështetjes për zhvillim profesional**, TBU garanton një mjedis akademik që promovon ekselencën dhe inovacionin[90] "Tirana Business University" (TBU), ka realizuar një plan veprimi për trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik me përfshirjen e stafit akademik të huaj dhe shqiptar nga diaspora për të rritur cilësinë arsimore dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar. Ky plan synon të përdorë aftësitë dhe perspektivat unike të akademikëve të huaj/diasporës për të pasuruar cilësinë |

[87] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.
[88] 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik.
[89] 16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu.
[90] 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët.

| |
|---|
| akademike të TBU dhe për të siguruar zhvillimin profesional të fakulteteve të saj, por gjithashtu forcon lidhjet me komunitetin akademik botëror, veçanërisht me diasporën shqiptare [91]. |
| **Standardi II.6 Institucioni vlerëson dhe mbështet personelin e vet në përmbushjen e detyrimeve vjetore-akademike e administrative.** |
| Duke u bazuar ne "POLITIKA PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË STAFIT AKADEMIK",[92] Institucioni vlerëson dhe mbështet personelin e tij në përmbushjen e detyrimeve vjetore akademike dhe administrative duke ofruar një mjedis pune që inkurajon zhvillimin profesional dhe përmirësimin e vazhdueshëm[93]. Përmes programeve të trajnimit, vlerësimit të rregullt të performancës dhe mbështetjes institucionale, stafi akademik dhe administrativ siguron përmbushjen efektive të përgjegjësive të tyre.[94] Institucioni promovon një qasje të bazuar në bashkëpunim dhe përmirësim të vazhdueshëm, duke krijuar mekanizma që ndihmojnë në menaxhimin e ngarkesës akademike dhe administrative, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe efikasitetin e shërbimeve administrative. Ky angazhim reflekton vizionin e institucionit për të ruajtur një strukturë stabël, të qëndrueshme dhe inovative, duke kontribuar në arritjen e objektivave akademike dhe institucionale. Ky dokument i cili u ndërtua pas vlerësimit dhe ekzaminimit të nevojave dhe detyrimeve të personelit të TBU-së, percjellë vlerë të shtuar, garanton dhe lejon zhvillimin e tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional, me qëllim që të jetë efektiv dhe t`u përgjigjet me sukses sfidave dhe detyrimeve aktuale dhe të reja gjatë viteve akademike[95]. Për sa i përket vlerësimit të stafit të TBU-së dhe NJSBC ka ndërtuar një Paketë të Instrumenteve për Matjen e Cilësisë[96]. Pjesë e së cilës përveç monitorimit që bëhet nga Pyetësori i studentit, ka dhe instrumente të tjerë si p.sh.: Formular vlerësimi i performancës së personelit akademik; Formular të kërkimit shkencor, etj[97]. Në këtë mënyrë, favorizohet "kultura e të mësuarit në mënyrë të vazhdueshme". |
| **Standardi II.7 Institucioni disponon dhe menaxhon pasuritë e paluajtshme dhe fokusohet në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.** |
| TBU nuk disponon pasuri të paluajtshme. Mjediset ku zhvillohet veprimtaria janë të marra me qira dhe mirëmbahen në vijimësi[98]. |
| **Standardi II.8 Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.** |

[91] 15. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmesakademik dhe administrativ të "TBU"; 15.1. Politika e BNJ në TBU; 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik; 16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët.

[92] 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik.

[93] 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët.

[94] 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët.

[95] 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik.

[96] 16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu.

[97] 16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu.

[98] 18.3.1. Kontratë Qeraje Godina e Re_TBU-UAT 13.12.2023; 18.1.1. Kontratë Qeraje 2021; 18.2.1. Kontratë Qeraje 2022.

TBU ne vitin akademik 2022-2023 ka zhvilluar veprimtarinë me seli në Rrugën e Kavajës, Pallati "Baja" (Ish-Parku), Tiranë[99].
Godina është e re, e ndërtuar vitet e fundit, me materiale cilësore brenda standardeve të kërkuara nga autoritetet përkatëse. Mjediset ku zhvillohet mësimi dhe zyrat janë të ndriçuara, me akustikë, me sistem individual për ngrohje dhe ftohje, dhe me lartësi mbi 3 m. Ambienti është i pajisur me sistem mbrojtës kundra zjarrit, me furnizim të pandërprerë me ujë, me sistem alternativ në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike nga rrjeti dhe me mjedise të shërbimit për nevoja personale në çdo kat. Në TBU janë ndërtuar 2 Rampa, një te hyrja e shkollës dhe tjetra te hyrja e ashensorit. Ashensori është funksional për lëvizjen nga njeri kat në tjetrin dhe është në përdorim vetëm të shkollës. Gjithashtu, në një tualet të shkollës janë instaluar pajisje mbajtëse/mbështetëse për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara. Në shkollë ndodhet gjithashtu një karrocë për përdorim në rast nevoje të personave me aftësi të kufizuara. Sipas raportit të grupit të ekspertëve të MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në mjediset ka një përfundim si më poshtë:
Standardet janë plotësuese për kapacitetin.[100]
Pas vitit akademik 2022-2023, TBU u transferua si seli në një godinë tjetër në një adresë të re: "Rruga e Rezervave të Shtetit, Lundër, Tiranë"[101]. Edhe nga raporti i fundit të MAS, mbi verifikimin e kapaciteteve në ambientet ka një përfundim si më poshtë:
Standardet janë plotësuese për kapacitetin.[102]
TBU ka siguruar mjedise, infrastrukturë të përshtatshme si dhe shfrytëzon hapësirën e vet infrastrukturore dhe lehtësitë logjistike për t'i ardhur në ndihmë punës e veprimtarisë akademike dhe shkencore si të PAE dhe PAK ashtu dhe të studentëve. TBU zotëron mjedise ku janë zhvilluar disa veprimtari si: konferenca shkencore, seminare, ceremoni të fillimit të çdo vitit akademik dhe të diplomimit, etj. TBU ka vënë në funksion të PAE, PAK dhe studentëve mjedise si: zyra, salla mbledhjesh, salla konferencash, bibliotekë, etj., për zhvillimin e veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore dhe administrative.[103]

**Standardi II.9 Institucioni siguron mjedise komode pune - mësimore - laboratorike të përshtatshme për personelin akademik dhe studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.**

TBU siguron mjedise të përshtatshme për personelin akademik, studentët dhe personat me aftësi të kufizuara. Duke përfshirë kapacitetet fizike (si: laboratorë, biblioteka dhe teknologjitë që përdoren për mësimdhënie) dhe kapacitetet pritëse, të cilat sigurojnë një mjedis cilësor për formimin profesional dhe shkencor të studentëve.
Kapacitetet fizike ofrojnë mjedise të përshtatshme dhe infrastrukturë moderne, duke plotësuar standardet e përcaktuara në Aneksin 1/B të vendimit nr. 418, dt.10.05.2017 në lidhje me

[99] 11.1. Raporti i MAS_mbi verifikimin e kapaciteteve në TBU 22-23; 11.1.1. VKM-nr.-418-date-10.5.2017.
[100] 11.Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024; 11.1.1. VKM-nr.-418-date-10.5.2017.
[101] 11.Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024; 11.1.1. VKM-nr.-418-date-10.5.2017.
[102] 11.Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024; 11.1.1. VKM-nr.-418-date-10.5.2017.

[103] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.

ambientet minimale të nevojshme për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë, sipas natyrës së programeve të studimit që ofrohen. Kapacitetet pritëse sigurojnë shërbime mbështetëse dhe mundësi praktike për studentët, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin akademik dhe profesional, duke plotësuar standardet e përcaktuara në Aneksin 1/C të vendimit nr. 418, dt.10.05.2017 [104].

Në TBU, çdo punonjës akademik dhe administrativ, zotëron mjetet e nevojshme teknologjike për kryerjen e detyrës: kompjutera desktop, laptopë, printer/skaner. Çdo pedagog me kohë të plotë ka vendin e tij të punës të mirë pajisur. Disa vende të tjera pune të pajisura me të gjitha mjetet janë në dispozicion të pedagogeve me kohë të pjesshme. Te gjitha pajisjet mirëmbahen rregullisht dhe zëvendësohen apo shtohen sa herë që është e nevojshme.[105]

TBU ka instaluar një bazë kompjuterike të fuqishme. Ne gjithë shkollën janë instaluar 80 desktop/laptop, të gjithë të lidhur në rrjet dhe me akses në internet. Numri i tyre është thuajse trefishi krahasuar me 6 vite më parë. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura secili me desktop, projektorë, akses ne internet me kabëll dhe mjete të tjera didaktike. Në sallën e bibliotekës së shkollës janë instaluar 34 kompjutera në dispozicion vetëm të studentëve[106].

Në të gjitha mjediset e TBU-së është e mundur lidhja e paisjeve kompjuterike me internetin nëpërmjet *wifi*. Kjo bën të mundur realizimin gjatë procesit mesimor të lidhjes me faqe të ndryshme web-i për ti ardhur në ndihmë stafit akademik të ilustrojnë me shembuj konkretë tematika të caktuara[107].

Në TBU ka ekzistuar një abonim vjetor në librarinë online EBSCO deri në dhjetor 2022. Aktualisht institucioni është në tratativa për të rinovuar këtë shërbim për vitin akademik 2024-2025 si dhe për tu angazhuar dhe në abonimin në Scopus Research database[108].

TBU ka integruar disa sisteme të rëndësishme IT për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe menaxhimit administrativ. Këto sisteme përfshijnë: një Sistem të Menaxhimit të Mësimit (LMS) të bazuar në Moodle, Office 365 për studentët dhe stafin akademik, dhe SharePoint për menaxhimin e skedarëve dhe informacionit dokumentar. Interneti sigurohet nga ISP-ja Tring Albania [109]. Integrimi i këtyre sistemeve IT në Universitetin TBU është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit dhe përmirësimit të procesit edukativ dhe administrativ. Këto sisteme jo vetëm që rrisin efikasitetin dhe produktivitetin, por gjithashtu përmirësojnë përvojën e përgjithshme të studentëve dhe stafit akademik. Përdorimi i Moodle, Office 365, SharePoint dhe një lidhje të besueshme interneti nga Tring Albania krijon një mjedis mësimor dhe administrativ që nxit inovacionin, bashkëpunimin dhe suksesin akademik. [110]

Në total, infrastruktura kompjuterike dhe rrjeti i avancuar i Universitetit TBU sigurojnë një mjedis të qëndrueshëm dhe efikas për të gjithë anëtarët e komunitetit universitar, duke përmbushur nevojat e tyre teknologjike dhe të sigurisë.

---

[104] 10. Marrëveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik; 10.1. Marrëveshja e MAS_TBU_ 2018 _ Përcaktimi i Personeli Akademik; 11. Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024; 11.1. Raporti i MAS_mbi verifikimin e kapaciteteve në TBU 22-23. 11.1.1. VKM-nr.-418-date-10.5.2017.

[105] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 6-8.

[106] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 6-8.

[107] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 6-8.

[108] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 13.

[109] 11. Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024; 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 5.

[110] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 6-8

**Standardi II.10 Për programet e studimit të fushave mjekësore, inxhinierike institucioni siguron laboratorë të standardeve të larta profesionale e shkencore.**

Në TBU studentët dhe stafi akademik kanë qasje në një gamë të gjerë të pajisjeve kompjuterike për të mbështetur nevojat e tyre akademike dhe administrative. Konkretisht, në TBU ka dy laboratorë kompjuterikë, i pari është i pajisur me 30 kompjuterë HP të fuqizuar nga procesori Intel Core i5 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit, ndërsa laboratori dytë është i pajisur me 60 kompjuterë Fujitsu të fuqizuar nga procesori Intel Core i3-9100 CPU @3.6 GhZ, 8 GB RAM dhe sistem operativ: Windows 11 Pro 64-bit si dhe 2 projektor të lidhur paralel Epson EB-W42. Këto pajisje të përditësuara ofrojnë performancë të lartë dhe stabilitet, duke u mundësuar përdoruesve të kryejnë detyra komplekse dhe të përdorin softuerë të avancuar pa vonesa.[111]

Gjithashtu, TBU disponon 10 salla të pajisura me nga një kompjuter HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit. Secila nga këto salla është gjithashtu e pajisur me një projektor ACER X1226AH DLP, duke lejuar prezantime dhe leksione interaktive me cilësi të lartë vizuale.[112]

Për pedagogët dhe stafin administrativ, TBU ka në dispozicion 20 njësi kompjuterike HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM, 64-bit, Windows 10 Pro, dhe 5 njësi me HP EliteDesk të pajisura me Intel Core i7 6700 CPU dhe 16 GB RAM. Këto pajisje të fuqishme sigurojnë që stafi të mund të kryejë detyrat e tyre me efikasitet të lartë dhe me mbështetje teknologjike të avancuar.[113]

**Standardi II.11 Institucioni siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive dhe argëtimi për personelin akademik dhe studentët e vet.**

TBU siguron mjedise të përshtatshme pushimi dhe argëtimi për stafin akademik dhe studentët e regjistruar në programet e studimit që ofron.[114] Në institucion ndodhen mjedise relaksuese, si për stafin akademik ashtu edhe për studentët.

**Standardi II.12 Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e infrastrukturës fizikë dhe angazhohet në përmirësimin e saj.**

TBU monitoron në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e infrastrukturës fizikë dhe angazhohet në përmirësimin e saj[115]. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programeve të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset mësimore si: klasa, laboratorë, studio zyrat e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete

[111] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
[112] 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike
[113] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
[114] 11. Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024,
[115] 11.2. Çertifikatë zjarri_TBU

elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat janë përmirësuar dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies - mësimnxënies.
Institucioni ka marrë edhe Certifikatën për Siguri nga Zjarri e lëshuar nga Drejtoria MZSH (Bashkia Tiranë) më datë 23/01/2024[116], për ushtrimin e aktivitetit dhe respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria B), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.[117]

**Standardi II.13 Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.**

Sekretaria mësimore është përgjegjëse për arkivimin e dokumenteve sipas rregullave të paracaktuara. Për ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike, çdo punonjës është i pajisur me kompjuter personal dhe në fund të çdo viti akademik të dhënat transferohen në një memorie digjitale të jashtme (hard disc) si dhe ruhen në Intranet. Statistikat prodhohen nga sekretaria mësimore. Ato përpunohen sipas formateve të kërkuara dhe i dorëzohen sipas kërkesës, BA, Rektoratit, Dekanatit, Ministrisë së Arsimit apo QSHA.[118] Dokumentacioni ruhet, mirëmbahet dhe është në dispozicion të tërë të interesuarve në version elektronik nga Zyra e IT-së dhe infrastrukturës tjetër në dispozicion. Pedagogët mbledhin, përpunojnë e administrojnë dokumentacionin e punës së përditshme të tyre si: esetë e studentëve, silabuset, provimet, etj. Përgjegjësit e departamenteve mbledhin, përpunojnë dhe administrojnë silabuset e lëndëve, procesverbalet e mbledhjeve, etj, ndërsa regjistrat e lëndëve dhe procesverbalet e provimeve administrohen nga sekretaret mësimore. Institucioni për nevoja të tij dhe të MAS ruan dhe administron të dhëna të detajuara për studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet, të çregjistruarit dhe të diplomuarit për program studimi. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve, nga pranimi në diplomim.
Dokumentacioni bazë që ka të bëjë me regjistrimin e studentëve dhe me regjistrimin e notave mbahet nga sekretaria mësimore në ruajtje të përhershme. Në Rregulloren për Sekretarinë Mësimore[119] dhe Statutin e TBU[120] janë të sanksionuara procedurat e përpunimit dhe ruajtjes së tyre.
Njësitë bazë, si përgjegjëse për programet e studimit qe ofrojnë kane te gjithë informacionin e nevojshëm qe ka lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtyre programeve. Regjistri i studentëve është nën përgjegjësinë e sekretarisë mësimore për plotësimin dhe ruajtjen. Ky dokumentacion së bashku me regjistrin e notave mbahen në ruajtje të përhershme.[121]

[116] 11.2. Çertifikatë zjarri_TBU.

[117] 11.2. Çertifikatë zjarri_TBU.

[118] 22.2. Rregullore e Arkivit; 21. Strategjia e Zhvillimit të IT; 21.1.Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU; 31. TBU - Rregullore e Sekretarisë.

[119] 31.TBU - Rregullore e Sekretarisë.

[120] 1. Statuti TBU.

[121] 22.2. Rregullore e Arkivit.

| |
|---|
| Punimet shkencore të stafit dhe studentëve ruhen në format letër (hard-copy) dhe/ose elektronikisht dhe janë të aksesueshme sipas rastit në intranet, në bibliotekë ose në arkivë.[122] |
| **Standardi II.14 Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional.**<br>Sekretaria, e cila shërben edhe si zyrë Protokolli, është përgjegjëse për shpërndarjen dhe komunikimin e vendimeve të mara nga strukturat përkatëse të TBU.[123] Sekretaria ndjek procedurën e ruajtjes afatgjatë të të dhënave të depozituara nga të gjitha njësitë dhe strukturat[124].<br>Në TBU është implementuar një sistem i integruar informacioni në shërbim të stafit (Intranet), i cili mundëson koordinimin mes palëve, koherencën në kohë reale, dhe siguron informacion strategjik për stafin dhe veçanërisht për vendim-marrësit[125].<br>Sistemi Pitagora, i zhvilluar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), ofron një zgjidhje të avancuar për menaxhimin e të dhënave akademike dhe administrative në TBU. Ai mundëson regjistrimin dhe administrimin e rezultateve të studentëve, përfshirë notat, mesataret dhe transkriptet akademike, duke automatizuar proceset e sekretarisë mësimore si regjistrimi i studentëve, planifikimi i provimeve dhe lëshimi i diplomave[126].<br>TBU publikon programet e ofruara, ofertën akademike, strukturën organizative të institucionit, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme, Strategjinë e Zhvillimit[127], Rregulloret e programeve te studimit, dhe shume rubrika të tjera në faqen e saj zyrtare të internetit www.tbu.edu.al.<br>Krahas sistemit intranet dhe website, Sekretaria Mësimore njofton rregullisht studentët dhe pedagogët mbi procesin mësimor, shpërndarjen e materialeve didaktike, aktivitetet e ndryshme që zhvillohen e deri te informacione të personalizuara.<br>TBU ka një politikë të qartë për publikimin e informacionit dhe privatësinë e tij[128]. TBU ka lançuar e po teston një sistem online interaktiv (Sistemi i Menaxhimit te Studentëve), që i shërben studentëve të aksesojnë notat, të komunikojnë me stafin, të lexojnë materiale mësimore, të informohen për ecurinë e pagesave, të marrin informacion lidhur me eventet e TBU-së apo njoftime të ndryshme, etj. Sistemi gjithashtu i shërben stafit akademik për të depozituar materiale ndihmëse e komunikuar me studentët dhe strukturat e tjera të TBU-së. Stafi drejtues i TBU dhe zyrat e tjera ndihmëse (Sekretari, Marketing, Financë) mund të monitorojnë aspekte të caktuara të lidhura me veprimtaritë respektive. Google Drive, Dropbox dhe Google Classroom janë gjithashtu aplikacione me të cilat pedagogë të caktuar ngarkojnë materialet e tyre lëndore dhe komunikojnë në mënyrë interaktive me studentët.[129] |

[122] 22.2. Rregullore e Arkivit.
[123] 31. TBU - Rregullore e Sekretarisë.
[124] 31. TBU - Rregullore e Sekretarisë; 22.2. Rregullore e Arkivit.
[125] 22.1. Politikat Institucionale të Publikimit të Informacionit.
[126] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.13.
[127] 21. Strategjia e Zhvillimit të IT.
[128] 22.1. 22.1. Politikat Institucionale të Publikimit të Informacionit.
[129] 21.1.Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.

| |
|---|
| **Standardi II.15 Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.**<br><br>Në TBU, çdo punonjës akademik dhe administrativ, zotëron mjetet e nevojshme teknologjike për kryerjen e detyrës: kompjutera desktop, laptopë, printer/skaner. Çdo pedagog me kohë të plotë ka vendin e tij të punës të mirëpajisur. Disa vende të tjera pune të pajisura me të gjitha mjetet janë në dispozicion të pedagogeve me kohë të pjesshme. Te gjitha paisjet mirëmbahen rregullisht dhe zëvendësohen apo shtohen sa herë që është e nevojshme.[130]<br>TBU ka instaluar një bazë kompjuterike të fuqishme. Në gjithë shkollën janë instaluar 135 desktop/laptop, të gjithë të lidhur në rrjet dhe me akses në internet.[131] Numri i tyre është thuajse trefishi krahasuar me 6 vite më parë. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura secili me desktop, projektorë, akses ne internet me kabëll dhe mjete të tjera didaktike [132]<br>Në të gjitha ambjentet e TBU është e mundur lidhja e paisjeve kompjuterike me internetin nëpërmjet wifi. Kjo bën të mundur realizimin gjatë procesit mesimor të lidhjes me faqe të ndryshme web-i për t'i ardhur në ndihmë stafit akademik të ilustrojnë me shembuj konkretë tematika të caktuara[133].<br>EBSCO është një mjet i rëndësishëm për studentët, pedagogët dhe studiuesit që kërkojnë burime të besueshme dhe të përditësuara për të mbështetur punën e tyre akademike dhe kërkimore. Platforma është e lehtë për t'u përdorur dhe siguron qasje të shpejtë dhe efikase në informacion cilësor. Në TBU ka ekzistuar një abonim vjetor në librarinë online EBSCO deri në dhjetor 2022. Aktualisht institucioni është në tratativa për të rinovuar këtë shërbim për vitin akademik 2024-2025 si dhe për tu angazhuar dhe në abonimin në Scopus Research database.[134] |
| **Standardi II.16 Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe transparente.**<br><br>TBU i shpërndan dhe përdore burimet financiare në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe në mënyrë transparente, në përputhje me rregullat dhe standardet e programit buxhetor dhe menaxhimit financiar [135]<br>Buxheti përgatitet sipas procesit dhe roleve të parashikuara në Statut, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit [136] dhe projeksionet realiste të të ardhurave. Financimi i deficitit është garantuar nga ortakët e TBU sh.p.k. Bordi i Administrimit është organ kolegjial vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë e TBU-së, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar ekonomik dhe të pronave të tij. Disa prej funksioneve kryesore të Bordit janë: garanton qëndrueshmërinë financiare të IAL-së, përmbushjen e misionit; miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit me propozimin e Senatit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre; përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarisë; mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit; cakton kriteret dhe procedurat për punësimin e administratës dhe personelit akademik; miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga |

[130] 21. Strategjia e Zhvillimit të IT.
[131] 21.1.Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5; 18.3.2. Procesverbal Inventari 29.12.2023.
[132] 21.1.Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5; 18.3.2. Procesverbal Inventari 29.12.2023.
[133] 21. Strategjia e Zhvillimit të IT.
[134] 21.1.Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 12-13.
[135] 19. Procedura e miratimit te buxhetit 2023 dhe plani buxhetor 24-27.
[136] 7. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.

administratori i TBU-së; përcakton kriteret dhe procedurat e dhënies së bursave për studentët; miraton rregulloren e funksionimit, dhe akteve të tjera të karakterit administrativ dhe financiar.[137] Bordi i Administrimit në bashkëpunim me Senatin akademik kanë hartuar një plan financiar afatgjatë për menaxhimin e buxhetit.[138]

**Standardi II.17 Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.**

Bordi i Administrimit (BA) i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme Ortakëve (APO) ndjek realizimin e planit financiar dhe është përgjegjës ndaj Asamblesë për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara. Një nga anëtarët e APO është edhe Kryetari i BA-së. Buxheti i aprovuar nga Bordi, sipas zërave u përcillet strukturave përkatëse. Veprimtaria ekonomike e TBU-së mbahet nga Zyra e Financës së TBU që nga Janari 2018 – dhe është audituar nga audituesi i pavarur [139].
TBU ka operuar me humbje financiare në vitet 2010-2015 dhe për herë të parë të ardhurat kanë mbuluar shpenzimet në vitin 2016. Humbja e akumuluar prej afërsisht 95 milionë lekë (ALL) është financuar tërësisht nga ortakët e TBU sh.p.k.[140] TBU nuk ka marrë hua nga banka apo palë të treta gjatë gjithë këtyre viteve. Të ardhurat nga pagesat e studentëve janë rritur progresivisht në shtatë vitet e fundit. Duke filluar nga viti 20-21[141] për veç planeve buxhetore njëvjeçare ka filluar hartimi i planeve afatmesme 5 vjeçare (me parë kanë qenë 3 vjeçare). Këto plane pasqyrojnë parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve, ku përveç zërave të tjerë të shpenzimeve jepen edhe ato për kërkimin shkencor, për secilin fakultet. Mbi këtë bazë TBU, duke marre parasysh edhe situatën e krijuar nga pandemia e Covid-19, do të operojë në vitet e ardhshme me të ardhura në rritje, duke garantuar vetëmjaftueshmërinë financiare, si për aktivitetin mësimor ashtu edhe për atë kërkimor-shkencor[142].
Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe legjislacionin financiar në fuqi në Republikën e Shqipërisë, TBU zbaton politikën financiare përmes strukturave të saj dhe personelit të ngarkuar për realizimin e menaxhimit financiar të institucionit që janë: Administratori i TBU-së dhe Zyra e Financës [143]. Autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit është Administratori që është edhe përfaqësues ligjor për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë [144]. Ai drejton veprimtarinë ekonomike, financiare e administrative, harton projekt-buxhetin vjetor, ndjek dhe përgjigjet për arkëtimin e tarifave të studimit dhe të ardhurave të tjera nga veprimtaria e TBU-së; përgjigjet për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shtetërore, për pagimin e taksave, tatimeve si dhe për detyrimet ndaj të tretëve; nënshkruan në

[137] 1. Statuti TBU (Neni 10); 7. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.
[138] 19. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27.
[139] 1. Statuti TBU; 18.1.2. TBU - Pasqyrat Financiare 2021; 18.1.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2021; 18.2.2. Pasqyrat Financiare 2022; 18.2.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2022; 18.3.3. Pasqyrat Financiare 2023; 18.3.4. Pasqyrat Financiare 2023 & Raporti Audituesit të pavarur.
[140] 18.1.2. TBU - Pasqyrat Financiare 2021; 18.1.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2021.
[141] 18.1.2. TBU - Pasqyrat Financiare 2021; 18.1.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2021; 19. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27.
[142] 18.3.3. TBU – Pasqyrat Financiare 2023; 18.3.4. TBU_Pasqyrat Financiare 2023 & Raporti Audituesit; 19. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27.
[143] 1. Statuti TBU (Nenet 10, 52,53).
[144] 1. Statuti TBU (Neni 10).

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

emër të TBU-së, kontratën e regjistrimit me studentët, për të cilët është miratuar regjistrimi [145]. Administratori i njësive kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të tyre. Për të siguruar vijimësinë normale të funksionimit të institucionit nga ana financiare, Bordi i Administrimit, në bashkëpunim me Senatin Akademik kanë hartuar një plan financiar afatmesëm për menaxhimin e TBU-së. Me propozim të Senatit, BA vendos përfundimisht për tarifat e studimit, llojet e bursave studentore dhe kriteret e përfitimit të tyre, pagat e personelit dhe çdo çështje tjetër financiare[146].
Fondet për kërkimin dhe studimet e ndryshme shkencore, për pajisjen e laboratorëve, për organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore, kur është e mundur, përcaktohen si zë më vete në buxhetin e TBU-së.
Gjithçka tjetër lidhur me veçoritë e zbatimit të rregullave të kontabilitetit e të administrimit të vlerave materiale e monetare të TBU-së, i nënshtrohet akteve ligjore e nënligjore që janë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.
Pagesa e taksave, tatimeve dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve janë përgjegjësi e TBU sh.p.k.[147]

**Standardi II.18 Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.**

Bazuar në LAL si dhe legjislacionin përkatës të RSH-së, TBU i nënshtrohet auditit financiar, që realizohet nga institucionet e parashikuara me ligj për këtë qëllim. Kontrolli realizohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe institucionet e caktuara shtetërore. Qëndrueshmëria financiare e TBU garantohet nga Bordi i Administrimit, që me propozim të Senatit Akademik[148] miraton buxhetin vjetor dhe atë afatgjatë të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Në zbatim të pikës 1 të nenit 116 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", veç auditit të brendshëm TBU i nënshtrohet edhe auditit të MAS[149]. Këto kontrolle janë periodike dhe të gjitha raportet që krijohen pas inspektimeve së bashku me rekomandimet përkatëse bëhen publike dhe diskutohen në mbledhjet të BA dhe me personelin e TBU-së.
Bordi i Administrimit miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e institucionit me dy të tretat e votave.[150] Institucioni realizon për llogari të tij veprimtari audituese, për të kontrolluar më lehtë ecurinë e vazhdimësinë në përputhje me rregullat, dhe standardet dhe dokumenton raportet financiare.[151]
Sipas legjislacionit në fuqi, bilanci i çdo viti dhe raporti i auditit i TBU-së janë të aksesueshme nga kushdo në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.

---

145 1. Statuti TBU (Nenet 10,52,53).
146 1. Statuti TBU (Neni 53).
147 1. Statuti TBU (Neni 53).
148 1. Statuti TBU (Nenet 10, 52,53).
149 18.2.3. TBU_Raport i audituesit te pavarur 2022.
150 18.1.2. TBU - Pasqyrat Financiare 2021; 18.1.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2021; 18.2.2. Pasqyrat Financiare 2022; 18.2.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2022; 18.3.3. Pasqyrat Financiare 2023; 18.3.4. Pasqyrat Financiare 2023 & Raporti Audituesit të pavarur.
151 18.1.2. TBU - Pasqyrat Financiare 2021; 18.1.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2021; 18.2.2. Pasqyrat Financiare 2022; 18.2.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2022; 18.3.3. Pasqyrat Financiare 2023; 18.3.4. Pasqyrat Financiare 2023 & Raporti Audituesit të pavarur.

TBU harton pasqyra e raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, që përfshihen në plan buxhetin e institucionit[152]

**Standardi II.19 Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.**

Bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është pjesë e strategjisë afatgjatë të zhvillimit të institucionit, veçanërisht e lidhur me qëllimin nr.4 strategjik, si një institucion që mëson nga eksperiencat më të përparuara dhe i zbaton ato në veprimtarinë e saj.
Bashkëpunimi brenda vendit, në nivel akademik, ka synuar mbrojtjen e interesave të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë jo-publik. TBU ka marrë pjesë aktive në takimet e organizuara nga një grup institucionesh të arsimit të lartë jo-publik, veçanërisht për të kontribuar në strategjinë e arsimit të lartë të qeverisë dhe ligjin 80/2015. TBU ka bashkëpunuar me institucionet arsimore jopublike në kuadër të pjesëmarrjes dhe kontributit në konferencat shkencore që ato organizojnë. Ky bashkëpunim synon shkëmbimin e njohurive akademike, forcimin e rrjeteve kërkimore dhe promovimin e zhvillimit shkencor në fusha me interes të përbashkët. Në këtë kuadër, TBU është e hapur në përfshirjen e stafit akademik dhe kërkuesve shkencorë në panele, referime shkencore dhe botime të përbashkëta, duke kontribuar kështu në cilësinë dhe ndikimin e aktiviteteve akademike[153].
TBU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete brenda vendit. Për më tepër, është pjesë e Konferencës së Rektorëve, si një organ që bashkon rektorët e universiteteve publike dhe jopublike në Shqipëri, me qëllim koordinimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në vend[154].
TBU është angazhuar në bashkëpunimin me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus dhe jo vetëm, me qëllim promovimin e mobilitetit akademik, shkëmbimit të njohurive dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta kërkimore. Ndërmjet marrëveshjeve ndërinstitucionale mbështet mobilitetin e studentëve, pedagogëve dhe stafit administrativ, duke siguruar njohjen e ndërsjellë të krediteve dhe përfitimin nga praktikat më të mira akademike. Gjithashtu, TBU është e hapur për partneritete strategjike që përfshijnë programe të përbashkëta studimore dhe bashkëpunim në projekte kërkimore, duke kontribuar kështu në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar[155]
TBU ka forcuar bashkëpunimin me organizatat e biznesit, me qëllim krijimin e mundësive për praktika profesionale dhe punësimin e studentëve. Ky bashkëpunim synon të lidhë teorinë me praktikën, duke u mundësuar studentëve përvojë reale në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive

[152] 18.3.3. Pasqyrat Financiare 2023; 18.3.4. Pasqyrat Financiare 2023 & Raporti Audituesit të pavarur;19. Procedura e miratimit te buxhetit 2023 dhe plani buxhetor; 24-27.
[153] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU.
[154] https://unitir.edu.al/zgjedhjet-e-reja-ne-konferencen-e-rektoreve/?utm_source=chatgpt.com
[155] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 20. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 20.1. Rregullore për shkëmbimet studentore; 20.1.1. IIA_TBU_Staffordshire_University_2017; 20.1.2. IIA_TBU_Staffordshire_University_2018; 20.1.3. Inter-Institutional Agreement_Bielefeld; 20.1.4. ICCM Agreement; 20.1.5. MoU_UniCusano TBU; 20.1.6. WSB - TBU - MoU – 2024; 20.1.7. MoU Obuda; 20.1.8. MoU Italy; 20.1.9. MoU IGS- TBU; 20.2. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve.

të nevojshme për karrierën e tyre[156]. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve TBU synon krijimin e marrëdhënieve afatgjata dhe të qëndrueshme me organizatat e biznesit[157].

**Standardi II.20 Institucioni bashkëpunon me institucionet të tjera në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore/artistike dhe praktikave profesionale.**

TBU për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore dhe praktikave profesionale, vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione të ndryshme[158]. TBU ka një histori të shkëlqyer bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Falë mbështetjes së Ministrisë, TBU promovon dhe realizon me sukses konkurset e përvitshme të Sipërmarrësve të së nesërmes me maturantët e shkollave të mesme në mbarë vendin[159]. Në dokumentet e TBU [160], pasqyrohet informacion i përgjithshëm mbi këto konkurse për vitin aktual akademik. Rektorati, Fakultetet dhe njësitë bazë, punojnë në mënyrë të sistematike për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, e cila është e planifikuar dhe ndiqet në nivel: Institucional; Fakulteti dhe njësie bazë, Individual. TBU bashkëpunon me shumë Institucione të ndryshme për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve. Me qëllim finalizimin e studimeve në "TBU", studentët janë të detyruar të kryejnë praktika mësimore, dhe këto institucione bashkëpunuese kanë një rëndësi të veçantë[161] Kryesisht këto marrëveshje kanë shërbyer për të angazhuar praktikantët për këtë program studimi, si edhe për t`i orientuar ata drejt tregut të punës si dhe përmes realizimit të praktikave të studentëve, internship-eve në kompani dhe institucione të ndryshme si një përgatitje e karakterit praktik në lidhje me tendencat e tregut të punës në vend e më gjerë krahas formimit akademiko-teorik që studentët marrin gjatë viteve të studimit në auditorët e TBU[162]

Me qëllim realizimin e plotë të përvojës akademike dhe jetës akademike në përgjithësi, TBU bashkëpunon ngushtë me kompani private, përfshirë Balfin Group dhe Neptun për të siguruar burime dhe paisje teknologjike moderne (infrastruktura teknologjike); Banka Raiffeisen, Banka Credins, Televizionin Scan, Agna Grup dhe shumë biznese të tjera për financimin dhe mbështetjen profesionale për organizimin e konkurseve me maturantët; Headhunter, Globe TIK

---

[156] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.

[157] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 34.5. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).

[158] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve.

[159] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.

[160] 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve.

[161] 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi

[162] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi

| |
|---|
| & Language Education, ASSET, EiPass, Rosseta Stone, etj. për trajnime profesionale ose nxitjen e sipërmarrjes për studentët, si dhe shumë shembuj të tjerë bashkëpunimi.[163] |
| **Standardi II.21 Institucioni ndjek politika favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.**<br><br>TBU ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve në nivel ndërkombëtar, duke synuar rritjen e shkëmbimit të njohurive, përvojave akademike dhe aftësive profesionale. Në këtë kuadër, mbështet dhe promovon pjesëmarrjen në programe mobiliteti, si: Erasmus dhe partneritete dypalëshe me universitete dhe qendra kërkimore ndërkombëtare. Kjo politikë synon jo vetëm zgjerimin e mundësive akademike për studentët dhe pedagogët, por edhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.<br>Gjithashtu, TBU është e hapur për partneritete strategjike që përfshijnë programe të përbashkëta studimore dhe bashkëpunim në projekte kërkimore, duke kontribuar kështu në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar[164]<br>TBU gjithashtu ka organizuar leksione të hapura apo seminare me profesionistë dhe akademik të huaj. Këto aktivitete ofrojnë një platformë të rëndësishme për diskutime akademike, shkëmbim idesh dhe zhvillim profesional, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor[165]. |
| **Standardi II.22 Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.**<br><br>TBU, e profilizuar në ofrimin e edukimit në fushën e biznesit dhe IT, ka prioritet të saj ndjekjen e zhvillimeve të reja në ekonominë dhe tregun vendas si dhe atë rajonal e global, njëherazi ofertat akademike të IAL-ve shqiptare dhe të huaja. Objektivat e TBU, shprehur në shkallën e punësimit të studentëve apo kuotat e planifikuara për regjistrim, janë bazuar në analizat e thelluara të kryera nga stafi i TBU [166].<br>TBU është një institucion që vlerëson vazhdimisht *feedback*-un dhe kontributin e studentëve të mëparshëm në përmirësimin e përvojës dhe ofrimit të shërbimit që TBU ofron. Në këtë kontekst, TBU kryen anketime të vazhdueshme përndjekjen e *alumni*-ve, me qëllim për të marrë perspektivën dhe eksperiencën e ish-studentëve të saj pas përfundimit të studimeve. Kjo praktikë |

[163] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi

[164] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 20. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 20.1. Rregullore për shkëmbimet studentore; 20.1.1. IIA_TBU_Staffordshire_University_2017; 20.1.2. IIA_TBU_Staffordshire_University_2018; 20.1.3. Inter-Institutional Agreement_Bielefeld; 20.1.4. ICCM Agreement; 20.1.5. MoU_UniCusano_TBU; 20.1.6. WSB - TBU - MoU – 2024; 20.1.7. MoU Obuda; 20.1.8. MoU Italy; 20.1.9. MoU IGS- TBU; 20.2. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve

[165] 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët

[166] 29.1. Studimi i tregut të punës.



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

e vazhdueshme është thelbësore për TBU për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe për të siguruar që ofrimi i edukimit në TBU reflekton nevojat dhe sfidat aktuale të tregut të punës[167].
Njohja dhe vlerësimi realist i zhvillimeve aktuale dhe në perspektivë në mjedisin rrethues, ndihmohet dhe lehtësohet nga disa faktorë të tjerë siç janë: stafi akademik me eksperiencë të gjatë në sektorin privat, kompani, banka, zyra profesionale dhe institucione publike; studentët që zhvillojnë praktika të gjata dhe punësohen në kompani, Alumni në karrierë; marrëdhëniet e vijueshme të bashkëpunimit dhe konsultimit me institucione dhe organizata private dhe shtetërore brenda dhe jashtë vendi (përmes projekteve Erasmus)[168]
Kryerja e një numri të madh aktivitetesh (seminare, leksione te hapura, biseda me personalitete, vizita studimore, projekte të përbashkëta me aktorë të tregut) gjithashtu është një burim të dhënash dhe idesh për njohje me realizëm të zhvillimeve aktuale dhe të perspektivës në shërbim të përshtatjes së vazhdueshme të objektivave strategjike dhe operimit të TBU.
Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës është struktura kyçe që mundëson një lidhje shumë të mirë të studentëve të çdo programi studimi me kërkesat e biznesit dhe tregut të punës në kohë reale. Kjo zyrë ka lidhje direkte me të gjithë partnerët e TBU që kërkojnë dhe marrin punonjës të rinj bazuar në një proces konkurrues punësimi. Kjo zyrë komunikon në mënyrë të përditshme me partnerët e biznesit, ku këta të fundit paraqesin kërkesat e tyre për vende vakante, dhe këto kërkesa ju shpërndahen studentëve sipas programeve dhe profileve të tyre në kohë reale[169].
Gjithashtu, TBU ka qënë institut partner me "The World Economic Forum's Centre for the New Economy and Society" për hartimin e "The Global Competitiveness Report" për vitet 2019 dhe 2020. Këto raporte kanë në brendësi të tyre analiza të sondazheve edhe të Opinioneve Ekzekutive (The Executive Opinion Survey: The Voice of the Business Community), ku përveç të tjerash bizneset pyeten edhe për hendekun e aftësive të punësimit (*skills gap*). Indikatorët që nxirren nga ky sondazh bëhen pjesë e Indeksit te Konkurueshmërisë Globale (Global Competitivness Index) që është pjesë e "The Global Competitiveness Report". Ky index është përllogaritur edhe për Shqipërinë[170] Siç mund të shihet nga këto raporte, TBU ka kontribuar si partner në hartimin e tyre, duke pasuruar informacionin për tregun e punës e trendet e tij jo vetëm lokal por edhe më gjerë rajonal e global dhe i ka përdor këto njohuri në përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit.

---

[167] 29.1. Studimi i tregut të punës; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.

[168] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 20. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 20.1. Rregullore për shkëmbimet studentore; 20.1.1. IIA_TBU_Staffordshire_University_2017; 20.1.2. IIA_TBU_Staffordshire_University_2018; 20.1.3. Inter-Institutional Agreement_Bielefeld; 20.1.4. ICCM Agreement; 20.1.5. MoU_UniCusano_TBU; 20.1.6. WSB - TBU - MoU – 2024; 20.1.7. MoU Obuda; 20.1.8. MoU Italy; 20.1.9. MoU IGS- TBU; 20.2. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.

[169] 34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.

[170] https://www3.weforum.org/docs/WEF_TheGlobalCompetitivenessReport2019.pdf;http://www3.wforum.org /docs/WEF_TheGlobalCompetitivenessReport2020.pdf.

TBU është në korrent të kërkesave të tregut të punës në mënyrë të përditshme dhe kjo është shumë e rëndësishme në kohë ku dinamika e tregut të punës është e lartë dhe kërkon fleksibël, përshtatëshmëri dhe aftësi multiple.

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

TBU ka arritur të plotësojë të gjitha standardet akademike për sa i përket fushës së dytë "Burimet dhe Partneriteti", në dispozicion të realizimit të veprimtarisë akademike të TBU-së. Në rekrutimin e personelit, TBU ndjek prej vitesh tashmë një praktikë të konsoliduar dhe transparente, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e institucionit duke u mbështetur tërësisht në arritjet individuale dhe profesionalizmin e kandidatëve duke respektuar kërkesat e vendit të punës. TBU ka bërë përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e stafit mësimdhënës, me organizimin e disa aktiviteteve për këtë qëllim. TBU ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ gëzojnë trajtim dhe vlerësim maksimal sipas legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kontributeve të secilit. Aspekte të trajtimit të veçantë, si dhe përfitime të tjera të personelit akademik përcaktohen nga BA, dhe Kriteret e alokimit të fondit për kërkimin shkencor. TBU ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij dhe fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Duke u bazuar në "Strategjinë e Zhvillimit 2024-2029"[171], e hartuar dhe ndërtuar pas vlerësimit dhe ekzaminimit të nevojave dhe detyrimeve të personelit të TBU-së nëpërmjet këtij dokumenti, TBU përcjell vlerë të shtuar, garanton dhe lejon zhvillimin e tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional, me qëllim që të jetë efektiv dhe t`i përgjigjet me sukses sfidave dhe detyrimeve aktuale dhe të reja gjatë viteve akademike. Plani strategjik ka si qëllim të koordinojë përpjekjet e TBU, ndaj sfidave në fushën e zhvillimit personal, trajnimit dhe edukimit të vazhdueshëm për personelin e TBU. Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë, ndër të tjera, nëpërmjet vlerësimit të personelit bëhet sipas parimeve të transparencës, objektivitetit, procesit të rregullt ligjore, mbi baza jo diskriminuese, etj. Menaxhimi i burimeve njerëzore bëhet në përputhje me aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi dhe për çdo anëtar të personelit mbahen të dhëna të plota dhe të sigurta. është i fokusuar në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, e cila është e përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore. Institucioni siguron mjedise komode pune, mësimore/laboratorike të përshtatshme për personelin akademik dhe studentët. TBU siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive dhe argëtimi për personelin akademik dhe studentët e vet. Menaxhimi financiar behet në përputhje me kuadrin dhe procedurat ligjore të përcaktuara dhe "TBU" ndjek politika financiare transparente. Për të mbështetur dhe lehtësuar funksionimin e procedurave akademike, administrative dhe digjitalizimin e të dhënave, TBU ka ngritur struktura përgjegjëse për menaxhimin e tyre si edhe publikon çdo informacion apo dokumentacion në kuadër të informimit, funksionimit, mbarëvajtjes dhe transparencës së gjithë aktivitetit të institucionit. Çdo student i TBU dhe çdo anëtar i stafit akademik në IAL ka akses në sistemin e komunikimit të brendshëm elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. Për arkivimin dhe mbajtjen e dokumentacionit zyrtar dhe akademik të TBU-së, respektohen dispozitat e parashikuara në legjislacionin përkatës në Republikën e Shqipërisë.

[171] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare plotëson të tëra standardet e kërkuara. TBU respekton standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit. Pasqyrat financiare të TBU-së të paraqitura në këtë raport përgjatë viteve akademike përmbajnë transparencë të plotë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave e shpenzimeve. TBU ka realizuar dhe plotësuar infrastrukturore dhe lehtësitë logjistike për t'i ardhur në ndihmë veprimtarisë kërkimore, akademike dhe shkencore në IAL. TBU ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar duke bashkëpunuar me institucionet të tjera në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore/artistike dhe praktikave profesionale dhe duke favorizuar mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve. TBU integron në mënyrë pro aktive dhe të mirë menduar planin didaktik më atë praktik, duke mbajture gjithmonë në konsideratë tregun e punës dhe kërkesat e tij. Në përgjigje të këtyre sfidave të reja, TBU në mënyrë periodike harton studime tregu, për përgatitjen e studentëve, në mënyrë që përballja me tregun konkurrues global të punës të jetë më e kollajtë. TBU bashkëpunon me institucionet të tjera në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore dhe praktikave profesionale. Standardet e **Fushës së vlerësimit: "Burimet dhe Partneriteti" janë përmbushur plotësisht.**

## III – PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI

| |
|---|
| **Standardi III.1 Institucioni ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit dhe kërkesat e tregut.** |
| TBU është një institucion që përgatit profesionistë në fushat e administrim biznesit dhe teknologjisë së informacionit në kontekstin e zhvillimit të tregut global. Përmes ofrimit të programeve të studimit të përshtatura me nevojat e tregut dhe përmes partneritetit me industrinë dhe komunitetin e biznesit, TBU synon të edukojë një brez të ri profesionistësh, të cilët do të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e një tregu global. Kjo përputhet me nevojat e zhvillimit të vazhdueshëm të ekonomisë shqiptare dhe me kërkesat e një shoqërie moderne, të integruar në tregun ndërkombëtar.[172]<br>Programet e studimit synojnë një ofertë akademike të pasur dhe gjithëpërfshirëse të pajisur me njohuri teorike dhe shprehi praktike te përparuara që i bën ata të aftë të kuptojnë kërkesat, kushtet dhe zhvillimet e tregut specifik ku konkurron biznesi e mjedisit ekonomik ligjor dhe social, si dhe të aftë të zgjidhin probleme komplekse dhe të pa parashikueshme në profilin për të cilin studiojnë.[173]<br>Programet në TBU përgatisin studentët me aftësi praktike që kërkohen nga punëdhënësit si dhe përputhen me vlerat dhe objektivat afatgjatë të institucionit. Studimi i dinamikës së tregut të punës është tashmë thelbësor për përcaktimin e saktë të strategjisë së zhvillimit të programeve të studimit në të gjitha nivelet. Nevoja për këtë studim është për shkak të ndryshimeve strukturore në tregun e punës në Shqipëri, të cilat reflektojnë ndryshime në strukturën e ekonomisë, modernizimin, rritjen e lidhjeve ekonomike ndërkombëtare, zhvillimin e marrëdhënieve sociale dhe ndërkombëtarizimin e marrëdhënieve të punës.[174]<br>Me riorganizmin institucional, TBU ka përcaktuar dy fushat prioritare, mbi të cilat ofron programet e studimit. Programet e studimit në fushën e Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni (IT) ofrojnë njohuri dhe aftësi të thelluara për menaxhimin e organizatave dhe zhvillimin e teknologjive moderne, duke shprehur qartë profilin dhe prioritetin e TBU-së. Për më tepër, në përputhje me Statutin[175] (Neni 8) programet e TBU-së janë të pasuruara dhe mbështeten fuqimisht mbi kryerjen e praktikës ose internship-eve dhe metoda të tjera që harmonizojnë formimin e njëkohshëm teorik dhe praktik dhe përshpejtojnë punësimin në profil të studentëve. |

---

[172] 7 TBU Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.

[173] 26.3.1. Broshure Bachelor "Administrim Biznesi" me 3 Profile; 26.3.2. Broshure Master Profesional 60 ECTS "Administrim Biznesi" Profili Menaxhim -Fin-Kon; 26.3.3. Broshure Master Profesional i Avancuar 120 ECTS "Administrim Biznesi" Profili Menaxhim; 26.3.4. Broshure Master Profesional i Avancuar 120 ECTS "Administrim Biznesi" Profili Fin-Kon; 26.3.5. Broshure Master Profesional i Avancuar 120 ECTS "Administrim Biznesi" Profili "E Drejte Biznesi"; 26.3.6. Broshure Master i Shkencave "Administrim Biznesi"; 26.3.7. Broshure Bachelor "Inxhineiri Software"; 26.3.8. Broshure Bachelor "Inxhinieri Kompjuterike"; 26.3.9. Broshure Bachelor "Informatike Ekonomike"; 26.3.10. Broshure Master i Shkencave "Informatike Ekonomike"; 26.3.11.Broshure Master i Shkencave "Inxhinieri Software".

[174] 29.1. Studimi i tregut të punës.

[175] 1.Statuti TBU.

Programet e studimit në Administrim Biznesi formojnë profesionistë të aftë në menaxhim, financa, marketing dhe sipërmarrje, duke i përgatitur për role udhëheqëse dhe strategjike në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Ndërsa programet e studimit në Teknologjinë e Informacionit formojnë profesionistë të specializuar në zhvillimin softuerik, sigurinë kibernetike, analizën e të dhënave dhe menaxhimin e sistemeve informatike, duke i përgatitur për karriera në inovacion dhe transformim digjital.

Programet e studimit të ofruara nga TBU janë organizuar në mënyrë të tillë që harmonizojnë të gjithë komponentët e tyre, lëndët bazë, lëndët profilizuese, karakterizuese, lëndët me zgjedhje, teorinë me praktikën. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizatat partnere më fushën e bizneset dhe të IT si dhe studimi i tregut të punës ndihmon në përmirësimin në vijimësi të këtyre programeve[176]. Programet e studimit të ofruara në TBU janë:

1. Bachelor në Administrim Biznesi (me tre profile, Menaxhim, Kontabilitet - Finance dhe Marketing) 180 ECTS;
2. Bachelor në Informatikë Ekonomike 180 ECTS
3. Bachelor në Inxhinieri Software 180 ECTS
4. Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike 180 ECTS
5. Master Profesional në Administrim Biznesi (me dy profile: Menaxhim dhe Kontabilitet Finance), 60 ECTS;
6. Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar (me tri profile: Menaxhim, Kontabilitet -Financë dhe E Drejtë Biznesi);
7. Master i Shkencave në Administrim Biznesi 120 ECTS;
8. Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike 120 ECTS
9. Master i Shkencave në Inxhinieri Software 120 ECTS

TBU ka një staf të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushat përkatëse, duke plotësuar kushtin e përcaktuar në marrëveshjen e lidhur me MAS për përcaktimin e numrit të personelit me kohe të plotë[177].

Me qëllim maksimizimin e përfitimit të dijeve dhe shprehive të një studenti të caktuar krahasimisht dijeve të fituara prej tij në studimet e mëparshme (Bachelor ose Master) dhe/ ose me qëllim përputhjen sa më të përshtatshme të studimeve me angazhimet e tij aktuale apo të perspektivës, struktura e programit përkatës që ndjek një student mund të përshtatet individualisht e rast për rast[178].

Programet e studimeve në TBU ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të saj, duke siguruar që ato të jenë të lidhura ngushtë me objektivat afatgjata dhe prioritetet e TBU. Kjo do të thotë që dizenjimi i programeve akademike është i orientuar për të përmbushur kërkesat e

[176] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

[177] 10. Marrëveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik.

[178] 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 12.

tregut të punës, zhvillimet teknologjike dhe sociale, si dhe për të kontribuar në rritjen e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor. Strategjia e zhvillimit reflektohet në krijimin dhe përshtatjen e programeve, duke siguruar që ato të ofrojnë mundësi të shkëlqyera për zhvillim profesional dhe personal të studentëve, ndërkohë që mbështet edhe avancimin e misionit të TBU-së.
TBU ofron edukim të një standardi të lartë në fushën e Administrim - Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, duke kultivuar mendësi sipërmarrëse dhe kulturë inovacioni. Nëpërmjet programeve akademike bashkëkohore, kombinimit të mësimit me përvojat praktike, si dhe partneritetit me Komunitetin e Biznesit dhe atë akademik, TBU i ofron studentëve një mjedis sfidues dhe mbështetës, që integron studimet me praktikat profesionale dhe përmbush standardet ndërkombëtare të edukimit. Kjo realizohet përmes një kurrikule bashkëkohore dhe kombinimit efikas të punës së profesoratit, komunitetit të biznesit dhe përvojës vendase e të huaj. Për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut në përgjithësi dhe veçanërisht kërkesave të ekonomisë shqiptare, programet e ofruara orientohen nga kërkesa e tregut në veçanti dhe grupeve të interesit në përgjithësi[179].
Qëllimi i harmonizimit të kurrikulave me nevojat e tregut të punës përfshin krijimin e lidhjeve të forta midis institucioneve arsimore dhe komunitetit të biznesit. Kjo përfshin aktivizimin e rrjetit "TBU ALUMNI" për të mbledhur *feedback* nga të diplomuarit dhe identifikimin e mundësive për rritje profesionale dhe intelektuale përmes studimit të kërkesave të tregut. Për më tepër, është e rëndësishme të ofrohen mundësi të përshtatura për studentët për të ndryshuar kurset dhe planin e studimit, duke rritur fleksibilitetin dhe duke siguruar që ata të jenë të përgatitur për sfidat e punës pas diplomimit. Në këtë kontekst, objektivi është gjithashtu rritja e cilësisë së arsimit përmes një bilanci të mirëfilltë midis cilësisë dhe kostos, duke mundësuar që universiteti të mbetet konkurrues dhe të sigurojë një përvojë të vlefshme arsimore për studentët. Pjesë e kësaj strategjie është edhe fokusimi në sinergjinë me komunitetin e biznesit, veçanërisht me kompanitë e Balfin Group, për të garantuar që studentët të jenë të përgatitur për nevojat reale të tregut të punës dhe të mund të adaptohen me shpejtësi[180].
Objektivat e strategjisë kanë në fokus rritjen e cilësisë të studenteve, mundësi punësimi dhe karrierë të suksesshme. Strategjia ka përcaktuar dhe drejtimet dhe mënyrat kryesore të arritjes së këtyre objektivave të cilat janë reflektuar në elementët përkatës të programeve, lëndëve dhe metodave mësimore, të objektivave të arritshme nga studentët, si dhe diplomat që lëshohen bashkë me elementët që pasurohen në suplementin e diplomës[181].

[179] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29.
[180] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29.
[181] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

**Standardi III.2 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.**

TBU ofron programe studimi që synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.

Programet e studimeve ne TBU ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke siguruar që ato të përmbushin kërkesat e arsimit të lartë në nivel lokal dhe global. TBU ka gjithmonë në fokus përshtatjen e kurrikulave te saj për të përmbushur standardet dhe politikat e arsimit kombëtar, si dhe për të garantuar që studentët të kenë njohuri dhe aftësi që janë të kërkuara në tregun ndërkombëtar të punës[182].

TBU e ka hartuar politikën e saj në linjë me politikat kombëtare sidomos duke u fokusuar në punësimin e të rinjve dhe nxitjen e sipërmarrjes, kreativitetit dhe inovacionit.

Një ndër qëllimet e strategjisë është rritja e dimensionit të ndërkombëtarizimit në fushën e edukimit, i cili përfshin zhvillimin e mundësive që studentët të kenë një përvojë edukative globale. Kjo arrihet përmes krijimit të kurseve në gjuhën angleze, që mundësojnë integrimin e studentëve ndërkombëtarë dhe ofrojnë mundësi studimi për ata që duan të marrin pjesë në arsimin ndërkombëtar. Po ashtu, jetësimi i programeve "Study Tour" dhe shkollave verore ofron mundësi për t'u njohur me sisteme edukative të tjera dhe për të pasuruar përvojën kulturore dhe akademike. Mbështetja e programeve me diploma të dyfishta dhe krijimi i partneriteteve me universitete të Perëndimit siguron mundësi për zhvillimin profesional të studentëve dhe rrit konkurrencën e tyre në tregun e punës ndërkombëtar[183].

Mbështetur në objektivat kombëtarë si psh: përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe aftësive profesionale, rritjen e mundësive për punësim dhe zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. si dhe objektivave ndërkombëtarë si psh: integrimi në tregje globale dhe përgatitjen e studentëve për sfidat dhe mundësitë që ofron globalizimi, harmonizimi me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, nxitjen e bashkëpunimit dhe mobilitetit, janë hartuar rregulloret e programeve të studimit në TBU.

Në rregulloren e programit të studimit [184] përcaktohen qëllimi, kriteret specifike të pranimit të studentëve, struktura e programit dhe planit mësimor, kreditet dhe çdo çështje tjetër që nuk rregullohet nga Statuti. Rregullorja e secilit program hartohet nga Dekani i Fakultetit përkatës, në bashkëpunim me përgjegjësit e departamenteve dhe miratohet nga Senati.[185] Miratimi i planeve mësimore për programet e studimit ne TBU bëhet në fillim të çdo viti akademik, duke vijuar më pas me zbatimin e tij[186]

---

182 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29.

183 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29.

184 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

185 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU.

186 13.12. Procesi i vendimmarrjes_planet_mësimore 24-25.

**Standardi III.3 Programet kanë objektiva të përcaktuar qartë dhe rezultatet e tyre të të nxënit përputhen me nivelin e profilin kualifikimit që ofrojnë.**

Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për rezultatet e tyre të të nxënit dhe përputhen me nivelin e profilin kualifikimit që ofrojnë, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin e programit. Programet janë të organizuara në lëndë/module, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në bazë të tij. Programet e studimit kanë të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës mësimore/profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Organizimi i studimeve është në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018, (i ndryshuar)[187].

Programet e studimit synojnë formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh dhe u japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi. Studenti të jetë i aftë të përshtatet në tregun e punës, duke zënë pozicion pune me ambicie për zhvillimin e karrierës. Studimet japin mundësinë e synimit të pozicioneve të larta në strukturat organizative të subjekteve private apo publike, atje ku kërkohet udhëheqje, drejtim, zbatim dhe vendimmarrje.[188]

Programet e Studimit kanë të përcaktuar kreditet, orët përkatëse, nga të cilat orë studimi në auditor dhe orë studimi individual. Konkretisht programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi, është program i ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe me 180 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Programi i studimit është parashikuar të realizohet në 4,500 orë, nga të cilat me shume se 50% janë orë individuale pune të studentit[189] Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në strukturën akademike të miratuar nga Senati Akademik në fillim të çdo viti akademik.[190]

Gjithashtu një tjetër program studimi, programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi, për të dy profilet është program i ciklit të dytë me kohëzgjatje normale 1 vit akademik dhe me 60 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Programi është parashikuar të realizohet në 1,500 orë, procesi mësimor është organizuar në 1 vit akademik, ku 50% e orëve janë punë individuale. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe deri në 4 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti kryen praktikë profesionale ose pune në profilin e tij të studimeve me jo më pak se 5 javë.[191]

Programi i Studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar për të tre profilet është program i ciklit të dytë me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike dhe me 120

[187] 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.

[188] 35. Raporti Vjetor TBU 23-24; 35.1. Raporti Vjetor TBU 20-21; 35.2. Raporti Vjetor TBU 21-22; 35.3. Raporti Vjetor TBU 22-23.

[189] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi";13.12. Procesi i vendimmarrjes_planet_mësimore 24-25.

[190] _. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software 13.23. Vendim për strukturën akademike 24-25.

[191] 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS;13.12. Procesi i vendimmarrjes_planet_mësimore 24-25; 13.23. Vendim për strukturën akademike 24-25.

kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Programi mësimor është parashikuar të realizohet në 3,000 orë, procesi mësimor është organizuar në 2 vite akademike ku 50% janë ore individuale pune. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe deri në 4 javë të parashikuara për sezonet normale të provimeve. Studenti kryen praktikë profesionale ose pune në profilin e tij të studimeve me jo më pak se 6 javë. Koha e struktura e fillimit, mbarimit, sezonet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati Akademik në fillim të çdo viti akademik[192]

Duhet theksuar se edhe në rregulloret e tjera të programeve të studimit si: Master i Shkencave në Administrim Biznesi 120 ETC, Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike 120 ETCS, Master i Shkencave në Inxhinieri Software 120 ECTS janë të parashikuar : kohezgjatja, kreditet, koha e fillimit dhe e mbarimit etj siç e kemi thënë dhe në programet e lartpërmendur.[193]

Programet e studimeve janë të strukturuara në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, me objektiva të përcaktuara qartë, duke siguruar që studentët të kenë një drejtim të qartë në procesin e tyre akademik dhe profesional. Objektivat e secilit program studimi të ofruar nga TBU jane të përcaktuara qartë në Nenin 3 dhe 6 të rregullores të secilit program studimi[194].

Të gjitha strukturat e TBU angazhohen në çdo fillim viti akademik që në takimet e para me studentët për t'i sqaruar ata me strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit si edhe kohëzgjatjen e tij. Studentët gjithashtu njihen edhe me stafin akademik që do të japin lëndët specifike të atij viti, nëpërmjet një prezantimi të shkurtër të vet pedagogëve. Përmbajtja semestrale e lëndëve që do të zhvillojnë si edhe orari ju komunikohen të gjithë studentëve me e-mail nga sekretaria mësimore, ndërsa informacionin specifik dhe komunikimin me pedagogun për secilën lëndë e gjejnë në Sistemin e Menaxhimit të Mësimit LMS[195]. Konkretisht Tirana Business University (TBU) ka zbatuar një sistem të avancuar dhe efikas të informimit për studentët, duke përdorur platforma të ndryshme teknologjike. Përmes Sistemit të Menaxhimit të Mësimit (LMS) të lartpërmendur të bazuar në Moodle, studentët kanë akses të vazhdueshëm në materialet e kurseve, mund të marrin pjesë në diskutime, të dorëzojnë detyra dhe të ndjekin progresin e tyre akademik në mënyrë të strukturuar.[196] Përveç kësaj, përdorimi i Office 365 dhe SharePoint mundëson një komunikim dhe bashkëpunim efektiv midis

---

[192] 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 13.12. Procesi i vendimmarrjes_planet_mësimore 24-25; 13.23. Vendim për strukturën akademike 24-25.

[193] 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software; 13.12. Procesi i vendimmarrjes_planet_mësimore 24-25; 13.23. Vendim për strukturën akademike 24 - 25.

[194] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

[195] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.2-3.

[196] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.3-3.

studentëve dhe stafit akademik, duke ofruar një hapësirë të centralizuar për dokumentet dhe informacionin. Theksojmë se infrastruktura e internetit dhe pajisjet kompjuterike moderne në TBU sigurojnë një përvojë të qëndrueshme dhe të aksesueshme për të gjithë përdoruesit, duke rritur ndjeshëm efikasitetin e mësimdhënies dhe menaxhimit akademik.[197]
Krahas sqarimeve mbi aksesueshmërinë në përmbajtjen e programeve dhe elementëve përbërës apo kriteret e pranimit dhe objektivat e programeve dhënë në standartet pararendëse, studentët në fillim të çdo lënde informohen nga pedagogu përkatës mbi programin e lëndës në lidhje me: temat që do të kryhen, metoda që do të ndiqet, objektivat për t'u arritur, dobinë e lëndës, lektorët e ftuar, si dhe kriteret dhe metodën e vlerësimit.

**Standardi III.4 Institucioni përcakton qartë dhe ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja.**

Hapja e programeve të reja mbështetet në nenin 30 dhe 35 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën së Shqipërisë, vendimit nr. 41 datë 4.01.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendimit nr. 418, datë 10.05. 2017 të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë ose degëve të tyre"[198].
Kërkesa për nisjen e procedurës për hapjen e një programi të ri të studimit, riorganizimin apo mbylljen e tij, buron nga departamenti përgjegjës për programin e studimit. Propozimi shqyrtohet në Dekanat, e më pas, kalon për miratim në Senatin Akademik të TBU-së, pasi është konsultuar paraprakisht me Zyrën e Kurrikulave. Njëkohësisht, departamenti përkatës konsultohet edhe me partnerë të ndryshëm në tregun e punës.[199]
TBU mbështet fuqimisht zhvillimin dhe zbatimin e ndryshimeve dhe inovacionit kurrikular. Qëllimi i TBU është të ndjekë politika dhe procese që inkurajojnë zhvillimin e ideve të reja dhe mbështesin programet aktuale.
Propozimi për programe të reja behet duke patur parasysh njëkohësisht kërkesat e tregut si dhe misionin dhe statutin e institucionit. Programi të jetë në përputhje me fushën e kualifikimit të njësisë bazë dhe kryesore. Programi të respektojë parimet e organizimit të kurrikulës të miratuara në legjislacionin në fuqi dhe në aktet rregulluese të TBU. Programi të jetë diskutuar gjerësisht me grupet e interesit, studentët, pedagogët dhe specialistë të fushës dhe komunitetin e biznesit. Programi të jetë në përputhje me formën e programeve mësimore të ofruar aktualisht në TBU. Programi të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm për t'u mbështetur me financime nga institucioni. Programi të mbështetet në pikat e forta kërkimore ekzistuese.[200]
Propozimin për krijimin e një programi të ri e bën njësia/njësitë bazë akademike përgjegjëse për ofrimin e programit pas një analize të detajuar të tregut të punës. Në analizën e tregut të punës argumentohen arsyet e nevojës për hapjen e këtij programi studimi. Pjesë e analizës është

---

[197] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.2-5.
[198] 40. Ligj_80-2015; VKM-nr.-41-date-24.1.2018; VKM Nr. 418_10.05.2017_Për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e IAL.
[199] 23.2. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU.
[200] 23.1. Politika për propozimin e programeve të reja.

| |
|---|
| edhe mundësia e ofrimit të këtij programi nga njësia bazë, përputhja me fushën e ekspertizës së njësisë bazë dhe të asaj kryesore, kapacitetet akademike dhe nevojat e institucionit. Propozimi miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe dërgohet për diskutim e miratim në Senatin Akademik. Pas miratimit në Senat, fillon puna për hartimin e programit (apo programeve) të ri që do të ofrohet. Njësia e Zhvillimit Kurrikular orienton, mbështet dhe konsulton procesin e hartimit të programit të ri të studimit dhe certifikon formën përfundimtare të tij. Hapat e procesit të aplikimit për hapjen e një programi të ri dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet janë specifikuar në udhëzimin Nr. 1 datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në rastin e programit të ri dhe të ristrukturuar, pas miratimit nga Senati Akademik, dosja i përcillet Rektorit i cili ia përcjell MASR për miratim. Në rastin e programit të ndryshuar në masën 20%, vlen miratimi nga Senati Akademik, me kushtin që të informohet MASR 6 muaj para fillimit të përdorimit. Hartimi i programeve të reja të studimit, ristrukturimi dhe përmirësimi i tyre bëhet në përputhje me Statutin e TBU-së, kriteret e vlerësimit të programeve të përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë të TBU-së.[201] |
| **Standardi III.5 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.**<br><br>TBU ofron programe studimi që mbështeten dhe realizohen duke përdorur burimet dhe infrastrukturën e tij aktuale. Kjo përfshin faktorë të tillë si kapacitetet mësimore (si numri i pedagogëve të kualifikuar, përvoja dhe specializimi i stafit akademik), mundësitë infrastrukturore (si laboratorë, biblioteka dhe teknologjitë që përdoren për mësimdhënie), si dhe mundësitë financiare për të mbështetur zhvillimin e këtyre programeve. Programet ruajnë një balancë midis kërkesave akademike dhe mundësive të institucionit për t'u ofruar studentëve një edukim cilësor dhe të qëndrueshëm.<br>TBU ka një staf të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushat përkatëse, duke plotësuar kushtin e përcaktuar në marrëveshjen e lidhur me MASR për përcaktimin e numrit të personelit me kohe të plotë. Të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë kanë 5 anëtarë me kohë të plotë në përbërjen e tyre nga të cilët të paktën 2 kanë gradë shkencore apo titull akademik. Te gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit kanë 4 anëtarë me kohë të plotë në përbërjen e tyre nga të cilët të paktën 2 kanë gradë shkencore apo titull akademik[202].<br>Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programeve të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Gjithashtu, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, personeli akademik në TBU, pjesë e procesit të mësimdhënies, disponon kualifikimin e nivelit pasardhës në raport me ciklin që ligjëron[203], duke siguruar kështu një nivel të duhur ekspertize dhe kompetence në fushën përkatëse. Raporti pedagogë me kohë të plotë/studentë është 1:18 në nivel të TBU-së, ndërsa sipas fakulteteve është 1:9 për Fakultetin e Biznesit dhe Drejtësisë dhe 1:20 për Fakultetin e Teknologjisë të Informacionit[204] |

[201] 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.
[202] 10. Marrëveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik.
[203] 40. Ligj_80-2015.
[204] 13.13.1. Vendim për strukturën e personelit akademik 24-25.

| |
|---|
| Në TBU respektohen kriteret ligjore të titujve dhe gradave të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme), sipas departamenteve dhe sipas cikleve të studimit. Pjesa më e madhe e stafit akademik kanë kryer studime universitare dhe/ose pasuniversitare jashtë vendit në universitete europiane apo amerikane. Në veçanti pedagogët e TBU-së, jo vetëm ata me kohë të pjesshme por edhe ata me kohë të plotë dallohen për eksperiencën e gjatë dhe të pasur praktike, dhe lidhjet e përditshme që kanë me bizneset, zyrat juridike, institucionet dhe rrethet profesionale si dhe që kanë kryer kualifikime dhe/ose trajnime pasuniversitare apo janë të pajisur me certifikata profesionale[205].<br>Kapacitetet fizike ofrojnë ambiente të përshtatshme dhe infrastrukturë moderne duke plotësuar standardet e përcaktuara në Aneksin 1/B të vendimit nr. 418, dt.10.05.2017 në lidhje me ambientet minimale të nevojshme për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë, sipas natyrës së programeve të studimit që ofrohen. Kapacitetet pritëse sigurojnë shërbime mbështetëse dhe mundësi praktike për studentët, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin akademik dhe profesional, duke plotësuar standardet e përcaktuara në Aneksin 1/C të vendimit nr. 418, dt.10.05.2017 [206]. |
| **Standardi III.6 Programet e studimit janë të organizuar në cikle studimi.**<br>Programet e studimit në TBU janë të strukturuara sipas cikleve të arsimit të lartë, në përputhje me Kornizën Kombëtare dhe Evropiane të Kualifikimeve[207].<br>• Cikli i parë (Bachelor) – Programet e këtij cikli kanë një kohëzgjatje tre vite dhe synojnë të pajisin studentët me njohuritë bazë dhe aftësitë e nevojshme për punësim ose vazhdimin e studimeve në ciklet më të larta.<br>• Cikli i dytë (Master Profesional) – Programet e këtij cikli kanë një kohëzgjatje një dhe dy vite, dhe ofrojnë njohuri të thelluara në një fushë specifike, duke përfshirë komponentë kërkimorë ose praktikë.<br>• Cikli i dytë (Master i Shkencave) – Programet e këtij cikli zgjasin një dy vite dhe ofrojnë njohuri të thelluara në një fushë specifike, duke përfshirë komponentë kërkimorë.<br>Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi paraqiten janë: A) Lëndë bazë; B) Lëndë karakterizuese; C) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese; D) Lëndë |

[205] 13.11. Vendim për miratimin e planit lëndor semestral (sem.2) 24-25; 13.13. Vendim për miratimin e personelit akademik njësive bazë - PAE & PAK 24-25.

[206] 10. Marrëveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik; 10.1. Marrëveshja e MAS_TBU 2018 Përcaktimi i Personeli Akademik; 11. Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024; 11.1. Raporti i MAS_mbi verifikimin e kapaciteteve në TBU 22-23; 11.1.1. VKM-nr.-418-date-10.5.2017.

[207] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

plotësuese, ku përfshihen edhe praktikat profesionale; E) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.
Për çdo veprimtari formuese përgatitet syllabusi i saj, i cili përcakton qëllimin, tematikën, orët mësimore, leksionet dhe seminaret, metodën e vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar dhe çështje të tjera sipas metodikave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë[208].
Për cikle leksionesh/module brenda lëndëve të programit, ftohen edhe ekspertë, personalitete të njohur të fushës. TBU pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, brenda afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar[209].

**Standardi III.7 Programet e studimeve nga cikli në cikël hartohen me qëllim mirë orientimin dhe përftimin gradual të njohurive nga studentët.**

Programet në TBU janë të strukturuara në mënyrë që të sigurojnë një zhvillim të pandërprerë dhe të logjikshëm të njohurive dhe aftësive që studentët do të fitojnë në secilin cikël të studimeve, përkatësisht në ciklin e parë (Bachelor) dhe ciklin e dytë (Master). Për të arritur këtë, programet janë të përshtatshme dhe të përditësuara, duke pasur parasysh nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe të ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike në mënyrë të balancuar. Studimi i tregut të punës dhe konsultimi me ekspertë nga bota e biznesit, është thelbësor për përcaktimin e saktë të strategjisë së zhvillimit të programeve të studimit në të gjitha nivelet. Nevoja për këtë studim është për shkak të ndryshimeve strukturore në tregun e punës në Shqipëri, të cilat reflektojnë ndryshime në strukturën e ekonomisë, modernizimin, rritjen e lidhjeve ekonomike ndërkombëtare, zhvillimin e marrëdhënieve sociale dhe ndërkombëtarizimin e marrëdhënieve të punës.[210]
Programet e studimeve janë hartuar në mënyrë që të lejojnë dhe ndihmojnë studentët të orientohen me lehtësi dhe të përfitojnë në mënyrë graduale njohuri në fushat e tyre të studimit. Programet e studimit kane rregulloren e tyre ku në çdo program përcaktohet organizimi i tij.[211]
Qëllimi, misioni i TBU si dhe fokusi është që të ofrojë programe që i përgjigjen nevojave të tregut, kërkimeve shkencore, këshillimeve profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike dhe ku përfitimi gjatë viteve akademike të vijë gradualisht, të jenë të përshtatura

[208] VKM-2018-01-24-41_përditësuar - Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL.
[209] 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 25.1. Kontrolli i dijes dhe procedura e diplomimit (Shkëputur nga Rreg. e Instucionit); 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët.
[210] 29.1. Studimi i tregut të punës; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.
[211] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

plotësisht me standardet botërore dhe kërkesat e shoqërisë, ku studentëve do t'u ofrojë edukim cilësor, hulumtues dhe inovativ, të përgatisë studentë konkurrues në tregun e punës [212].

**Standardet III.8 Institucioni ofron programe të të nxënit gjate gjithë jetës.**

TBU, krahas programeve të studimit, organizon trajnime dhe aktiviteteve të tjera që ndihmojnë zhvillimin e aftësive të reja si për stafin dhe për studentët[213]. Implementimi i programeve të trajnimit synon përditësimin e njohurive dhe aftësive didaktike dhe kërkimore të stafit. Konkretisht organizimi i *workshop*-eve, seminareve dhe trajnimeve me fokus në metodat mësimore të reja dhe aplikimin e tyre praktike.[214] Këto aktivitete të trajnimit dhe kualifikimit profesional kanë specifika të veçanta në disiplina të ndryshme brenda fokusit të vet kryesor.
Institucioni punon në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar gjithashtu një organizim dhe dokumentim të programeve të studimit që ofron por edhe të aktiviteteve të tjera. Dokumentacioni ruhet në departament, si dhe arkivohet në format elektronik dhe *hardcopy* pranë sekretarisë mësimore. TBU ka konsoliduar proceset për zhvillimin e programeve të studimit sipas standardeve në përputhje me kapacitetet infrastrukturore dhe njerëzore si dhe të trajnimeve të ndryshme. Bashkërendimi i këtyre kapaciteteve në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave te programeve bëhet nëpërmjet hartimit, dokumentimit dhe publikimit të veprimtarive akademike të cilat miratohen rregullisht në Senat çdo fillim viti akademik.[215]Senati akademik në zbatim të Statutit merr në shqyrtim çdo propozim të paraqitur nga nivelet më të ulëta të strukturave akademike, lidhur me programet mësimore dhe kërkimin shkencor, hapjen, ndryshimin ose mbylljen e tyre. Senati garanton cilësinë e brendshme të TBU-së përmes vlerësimit të aktivitetit mësimor-kërkimor të personelit akademik dhe sigurimit të kushteve për përmirësimin e tyre[216].
Kërkimi shkencor në TBU organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" duke dalluar midis kërkimit bazë dhe kërkimit të aplikuar. Kërkimi shkencor bazë që synon të

---

[212] 29.1. Studimi i tregut të punës; 1. Statuti TBU; 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29.
[213] 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët
[214] 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik;17.Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët.
[215]2. Rregullore e Senatit Akademik; 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 3.1. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë 3.2. Rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit; 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software; 4.5.1. Plan pune dhe aktivitete DBF 2023-2024; 4.5.2. Raporti vjetor i DBF 2023-2024; 4.5.3. Plan pune dhe aktivitete DBF 2024-2025; 5.2.1. Plan pune dhe aktivitete DD 2024-2025; 5.2.2. Raporti Vjetor i DD 2023-2024; 5.3.1. Plan pune dhe aktivitete DIS 2023-2024; 5.3.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024; 5.3.3. Plan pune dhe aktivitete DIS 2024-2025; 5.4.1. Plan pune dhe aktivitete DIE 2023-2024; 5.4.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 5.4.3. Plan pune dhe aktivitete DIE 2024-2025; 5.5.1. Plan pune dhe aktivitete DIK 2023-2024; 5.5.2. Raporti vjetor i DIK 2023-2024; 5.5.3. Plan pune dhe aktivitete DIK 2024-2025
[216] 2. Rregullore e Senatit Akademik.

përmirësojë teoritë dhe të kuptuarit përkundrejt kërkimit të aplikuar që synon në zgjidhjen e problemeve të së përditshmes, rezultatet e së cilit kanë efekt të menjëhershëm dhe praktik.[217] Bërja realitet e të nxënit gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit është një ndër objektivat e ardhshëm të TBU, pasi ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri mundëson programet e studimeve të formimit të vazhduar[218].

**Standardi III.9 Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësisë dhe realizohen në bashkëpunimin me aktorë të fushës.**

Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e TBU[219]. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademik të njësisë. Programet e studimeve të ofruara nga TBU mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësisë dhe realizohen në bashkëpunimin me aktorët e fushave të studimit[220]. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, TBU vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.[221] TBU konsideron që marrëdhënia me partnerët e jashtëm është thelbësore, si për praktikat e mësimdhënies, po ashtu edhe për pozicionet afatgjata të punës. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, TBU përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. TBU ndërgjegjëson studentët për menaxhimin e karrierës edhe me anë të trajnimeve, seminareve, diskutimeve, etj. lidhur me zhvillimin e karrierës dhe mundësive për punësim dhe zhvillim profesional[222].

---

[217] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29; 33.2. Indikatorët e matjes së performances; 33.3. Politika për grantet e punës kërkimore dhe shkencore

[218] 40.Ligj_80-2015, Neni 81.

[219] 1. Statuti TBU.

[220] 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 3.1. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë 3.2. Rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit; 4.1. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD); 4.2. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë (FBD); 4.3. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI); 4.4. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike (FTI); 4.5. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike (FTI); 29.1. Studimi i tregut të punës; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.

[221] 29.1. Studimi i tregut të punës; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 34.1.Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2.Memorandum TIP_TBU_Subjekt.

[222] 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU34.4.1. Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj; 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët 38.3. Ditët informuese në TBU.

**Standardi III.10 Programet e studimeve monitorohen në mënyrë periodike.**

Institucioni ka organizuar struktura dhe njësi që monitorojnë dhe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, si dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me Fakultetet dhe Departamentet aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. NJSBC vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore, harton relacione dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është një strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit[223]. Plani i punës së kësaj njësie bëhet në funksion të arritjes së objektivave bazë të funksionimit të saj. Kjo njësi ka si mision të planifikojë, drejtojë, organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi.[224]. Kjo njësi luan një rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës së cilësisë që ndikon të arrijë dhe ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese. Organizimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e NJSBC-së përcaktohen në Statutin e TBU-së dhe në Rregulloren e NJSBC të TBU-së[225] Në kuadrin e vlerësimit të brendshëm, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Cilësisë të TBU-së si dhe komisionet e fakulteteve përkatëse. Këto komisione janë një organizëm i përhershëm që aktivizohen sa herë ndërmerren veprimtari vlerësimi. Këto komisione kanë për detyrë garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit në TBU. Organizimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen në Statutin e TBU-së [226].

Komisionet e përhershme të cilësisë në TBU në mbështetje të planit hartojnë raportin e vlerësimit të cilësisë duke evidentuar problematikat që ekzistojnë në procesin akademik dhe institucional, me qëllim zgjidhjen e tyre në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë[227].

Raporti vjetor i monitorimit analizon cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të realizuar në të gjitha njësitë bazë. TBU organizon në vazhdimësi takime, të formave të ndryshme si trajnime, seminare apo workshop-e që janë në përputhje me nevojat e studentëve dhe merr pjesë në aktivitete të ngjashme të organizuara nga institucione apo organizata të tjera si dhe mban kontakte të pandërprera me institucione bashkëpunuese, si dhe me studentet e

[223] 1. Statuti TBU; 24.1. Rregullore NJSBC.
[224] 24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025.
[225] 1. Statuti TBU; 24.1. Rregullore NJSBC.
[226] 1. Statuti TBU; 24.1. Rregullore NJSBC; 24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024; 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024; 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024; 24.5.1. Plan pune i KC TBU 24-25; 24.5.2. Plan pune i KC FBD 24-25; 24.5.3. Plan pune i KC FTI 24-25.
[227] Raport i KC TBU 2023-2024; 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024; 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024; 24.5.1. Plan pune i KC TBU 24-25; 24.5.2. Plan pune i KC FBD 24-25; 24.5.3. Plan pune i KC FTI 24-25.

| |
|---|
| diplomuar dhe aktualë që ndjekin këtë program studimi. TBU angazhohet maksimalisht për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij.[228]<br>Komisioni i cilësisë në TBU, në mbështetje të planit harton raportin e vlerësimit të cilësisë, duke evidentuar problematikat që ekzistojnë në procesin akademik dhe institucional, me qëllim zgjidhjen e tyre në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë[229]. |
| **Standardi III.11 Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.**<br><br>Programet e studimeve i nënshtrohen një procesi të vazhdueshëm përmirësimi për të rritur cilësinë e tyre, duke u përshtatur me zhvillimet akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Ky proces përfshin përditësimin e kurrikulave, integrimin e metodave inovative të mësimdhënies, përafrimin me standardet ndërkombëtare dhe sigurimin e vlerësimit periodik nga institucionet përkatëse. Përfshirja e studentëve dhe palëve të interesuara luan një rol kyç në sigurimin e një arsimi cilësor dhe konkurrues.<br>Harmonizimi i kurrikulave me nevojat e tregut të punës përmirëson cilësinë duke krijuar një ndërlidhje më të fortë midis institucionit akademik dhe sektorit privat. Lidhja institucionale me komunitetin e biznesit siguron që programet e studimit të jenë të azhurnuara dhe të përshtatura me kërkesat e tregut, duke përfshirë projekte kërkimore të aplikuara që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve praktike[230]. Aktivizimi i rrjetit "TBU ALUMNI" mundëson marrjen e *feedback*-ut nga të diplomuarit, duke ndihmuar në përmirësimin e kurrikulave, në përputhje me përvojat dhe sfidat që ata hasin në tregun e punës[231]. Gjithashtu, studimi i vazhdueshëm i dinamikave të tregut dhe kërkesave për zhvillim profesional siguron që institucionet arsimore të ofrojnë njohuri dhe aftësi të përditësuara[232].<br>Optimizimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet një balance midis cilësisë dhe kostos e bën institucionin më konkurrues dhe tërheqës për studentët. Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë me komunitetin e biznesit, veçanërisht me kompani të rëndësishme si Balfin Group, siguron që studentët të jenë të përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe të kenë mundësi të integrohen më |

[228] 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët
[228] 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik;17.Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 34.1.Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2.Memorandum TIP_TBU_Subjekt; . Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29.

[230] Aneksi 7. TBU - Strategjia e Zhvillimit 2024-2029.
[231] 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 34.1.Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2.Memorandum TIP_TBU_Subjekt.
[232] 29.1. Studimi i tregut të punës.

| |
|---|
| lehtë në sektorin profesional. Këto masa kontribuojnë në krijimin e një kurrikule më të orientuar drejt praktikës dhe zhvillimit të karrierës[233].<br>Një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kurrikulave luan Zyra e Kurrikulës në TBU, e cila koordinon punën me departamentet për zhvillimin e kurrikulave ekzistuese, në harmoni dhe përputhje me kërkesat e tregut të punës legjislacionit në fuqi. Zyra e Kurrikulave në TBU bashkë me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) nëpërmjet analizave periodike, vlerësimeve të brendshme dhe bashkëpunimit me studentët, pedagogët dhe aktorët e tregut, sigurojnë që programet e studimit të ofrojnë njohuri bashkëkohore dhe aftësi të aplikueshme në tregun e punës[234]. |
| **Standardi III.12 Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.**<br><br>Institucioni ndjek një politikë të qartë dhe gjithëpërfshirëse për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke u fokusuar në përshtatjen e programeve akademike me zhvillimet më të fundit në fushën e arsimit dhe kërkesat e tregut të punës. Përditësimi i kurrikulave siguron që studentët të pajisen me njohuri dhe aftësi praktike të nevojshme për tregun e punës, ndërsa aplikimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si qasjet ndërvepruese, përdorimi i teknologjisë dhe mësimi i bazuar në projekte, rrit efektivitetin e procesit mësimor. Një tjetër element i rëndësishëm është vlerësimi i rregullt i stafit akademik, duke siguruar që pedagogët të ndjekin trajnimet e nevojshme për të përmirësuar metodat e tyre të mësimdhënies dhe për të përdorur teknika inovative në klasë.[235]<br>Për të siguruar një mësimdhënie të cilësisë së lartë, institucioni inkurajon përfshirjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, duke marrë feedback të vazhdueshëm mbi përvojën e tyre akademike. Gjithashtu, krijimi i një infrastrukture moderne dhe sigurimi i resurseve të duhura janë faktorë kyç për mbështetjen e një mjedisi efektiv të të nxënit. Bashkëpunimi me institucione të tjera akademike dhe partnerë nga industria forcon lidhjen midis teorisë dhe praktikës, duke u mundësuar studentëve të përfitojnë nga eksperienca reale në sektorë të ndryshëm profesionalë. Në këtë mënyrë, politika e institucionit synon jo vetëm të |

[233] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29. ;29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 34.1.Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2.Memorandum TIP_TBU_Subjekt.

[234] 22.1. Politika për propozimin e programeve të reja; 22.2. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU; 24.1. Rregullore NJSBC.

[235] 22. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; 22.1. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik; 16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; 17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët; 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët; 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.

rrisë cilësinë e mësimdhënies, por edhe të përgatisë studentët për një treg pune gjithnjë e më konkurrues[236].
Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies, është detyrë e disa strukturave në institucion si departamentet, NJSBC etj. TBU realizon vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit nëpërmjet instrumenteve matës si psh pyetesoret. TBU vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik. Pedagogu vlerësohet nga departamenti dhe dekanati. TBU vlerëson stafin e tij duke evidentuar arritjet në analizat vjetore në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni. Ky vlerësim me se shumti adresohet ne përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.Kjo mënyrë rrit efektivitetin e procesit mësimor.[237]
NJSBC pergatit raportin e cila mbështetet në standardet dhe kriteret për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme sipas bazës ligjore në fuqi, ndërsa hartimi i planit të punës bëhet në funksion të arritjes së objektivave bazë të funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë[238]

**Standardi III.13 Programet e studimeve të shpallura zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional dhe kombëtar.**

TBU funksionon si një sistem akademik i organizuar tërësisht në baza akademike të njohura sipas modelit të shprehur në parimet e Deklaratës së Bolonjës së Ministrave të Arsimit të Europës. Programet e studimit janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Orientimi konceptual i programeve të studimit promovon një qasje të mirë-përcaktuar didaktike dhe hulumtuese, dhe të bazuar në hulumtime të tregut. Programet e studimit modelohen sipas objektivave të kualifikimit. Këto përfshijnë aspekte të ndërlidhura dhe ndër-disiplinore, si dhe përvetësimin e shkathtësive dhe kompetencave disiplinore, metodologjike dhe të përgjithshme. Programet e studimit pasqyrojnë çështje të praktikës mësimore. Programet i ekspozojnë studentët sa më shumë që të jetë e mundur ndaj realitetit të jetës ekonomike, ndaj përvojave të të qenit anëtar i komunitetit, praktikave të menaxhimit, etj.
Fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. TBU ofron një gamë të gjerë programesh në nivele të ndryshme studimi, si programe Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional. Programet e ofruara janë të licencuara, akredituara dhe ri akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

---

[236] 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2.Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 24.2.Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024; 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024; 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024; 24.5.1. Plan pune i KC TBU 24-25; 24.5.2. Plan pune i KC FBD 24-25; 24.5.3. Plan pune i KC FTI 24-25; 24.6. Njoftim për studentët për zhvillimin e pyetësorit; 24.6.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve; 24.7. Raporti i Fokus Grupeve 23-24.
[237] 24.6.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve; 24.7.Raporti i Fokus Grupeve 23-24; 16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu; Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024; 24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024; 24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024.
[238] Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025.

Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Përbërja strukturore dhe organizative e TBU është: pjesa akademike, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike, Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë, dhe pjesa administrative, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese administrative si dhe njësitë e shërbimit[239]
Autoritetet drejtuese akademike janë: rektori i institucionit, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë (përgjegjësi i departamentit/ qendrës kërkimore-shkencore). Autoritetet drejtuese administrative [240]Bordi i Administrimit si organi më i lartë kolegjial administrativ përmbush disa përgjegjësi lidhur më vlerësimin e brendshëm dhe sigurimin e cilësisë, si: garanton mbështetjen e nevojshme financiare dhe logjistike për të realizuar veprimtaritë e monitorimit dhe të vlerësimit në kuadrin e sigurimit të cilësisë; miraton buxhetin për veprimtaritë e vlerësimit të TBU-së; ka përgjegjësinë për auditimin e brendshëm financiarë miraton raportin vjetor të auditimit të brendshëm; është përgjegjës për caktimin e kritereve dhe të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet rregullatore të TBU-së.[241]
Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe me statutin e TBU hartohet Rregullorja e TBU, rregulloret e njësive, rregulloret e organizimit dhe funksionimit të organeve drejtuese dhe organeve akademike, rregulloret mësimore si dhe akte normative të tjera.[242]
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programet e studimit përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore.
Programet e studimit u përkasin fushave të rëndësishme të jetës së vendit dhe janë ndërtuar në përputhje me studime të mirëfillta të ekonomisë së tregut në vend dhe më gjerë.

**Standardi III.14 Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.**

Mësimdhënia dhe nxënia e transmetimi i dijeve e i njohurive nëpërmjet komponentëve të ndryshëm mësimorë (leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura) janë forma të përcaktuara në rregulloren e programit

[239] 1.Statuti TBU; 1.1. Organigrama e re me vulën e MAS;3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU.
[240] 1.Statuti TBU; 1.1. Organigrama e re me vulën e MAS; 2. Rregullore e Senatit Akademik;3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 3.1. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë; 3.2. Rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit; 3.3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ; 4.1. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD); 4.2. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë (FBD); 4.3. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI); 4.4. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike (FTI); 4.5. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike (FTI).
[241] 1.Statuti TBU; 18.1.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2021; 18.2.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2022; 18.3.4. Pasqyrat Financiare 2023 & Raporti Audituesit të pavarur; 19. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27.
[242] 1.Statuti TBU; 2. Rregullore e Senatit Akademik; 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 3.1. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë; 3.2. Rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit; 3.3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ; 4.1. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD); 4.2. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë (FBD); 4.3. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI); 4.4. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike (FTI); 4.5. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike (FTI)8. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale.



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

përkatës. Personeli akademik i përfshirë në zbatimin e programeve të studimeve përdor një gamë të gjerë formash të mësimdhënies, vëmendje e veçantë i kushtohet pjesës praktike, për të rritur aftësitë praktike të studentëve.[243]

Aplikimi në praktikë i njohurive dhe aftësive të fituara nga kurset teorike sigurohet përmes një kombinimi të praktikave profesionale, internship-eve dhe projekteve të bazuara në situata reale, duke u dhënë studentëve mundësinë të zbatojnë njohuritë e fituara në kurset teorike në një mjedis pune[244]. Laboratorët, simulimet dhe përdorimi i software-ve specifike ndihmojnë në zhvillimin e aftësive praktike dhe krijimin e eksperiencës së drejtpërdrejtë me instrumentet e fushës së tyre të studimit[245]. Për studentët e fushave ekonomike dhe teknologjike, inkubatorët e biznesit dhe mbështetja për start-up-e ofrojnë hapësira për inovacion dhe sipërmarrje, duke i ndihmuar ata të eksperimentojnë me idetë e tyre dhe të përgatiten për sfidat e tregut[246].

Pjesëmarrja në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe angazhimi në projekte kërkimore dhe inovative, ndihmon studentët të aplikojnë njohuritë e tyre në situata konkrete dhe të përfitojnë nga përvoja praktike. Për më tepër, organizimi i trajnimeve dhe *workshop*-eve nga ekspertë të industrisë u mundëson atyre të njihen me sfidat aktuale të sektorit përkatës dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për tregun e punës. Programet e mentorimit dhe këshillimit nga profesorët dhe profesionistët e fushës sigurojnë mbështetje individuale për studentët, duke i ndihmuar ata të përshtaten me kërkesat e profesionit të tyre dhe të ndërtojnë një bazë të fortë për karrierën e ardhshme.[247]

Përmes këtyre iniciativave, TBU jo vetëm që ndihmon në përmirësimin e edukimit dhe zhvillimit profesional, por gjithashtu forcon lidhjen mes akademisë dhe komunitetit, duke nxitur inovacionin, sipërmarrjen dhe përgjegjësinë sociale në nivel kombëtar.[248]

**Standardi III.15 Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përftimin e kompetencave.**

Programet ne TBU zhvillohen në mënyrë që të përfshijnë aktivisht studentët në përftimin e kompetencave. Leksionet u lënë studentëve hapësirë të përfshihen, të reflektojnë dhe të mendojnë dhe kjo është procedure që zbatohet nga stafi. Megjithatë, elementet e metodologjive

---

[243] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software; 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.

[244] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 34.5. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse); 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët; 35. Raporti Vjetor TBU 23-24.

[245] 21. Strategjia e Zhvillimit të IT; 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU; 21.2. Udhëzues për përdorimin e strukturës së TI deri në Dhjetor 23; 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët.

[246] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU; 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët ; 35. Raporti Vjetor TBU 23-24.

[247] 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët ; 35. Raporti Vjetor TBU 23-24.

[248] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

interaktive janë të pranishme ose më evidente, veçanërisht gjatë organizimit të seminareve. Programet shoqërohen me udhëzues dhe dokumente të tjera në ndihmë të studentëve[249]
Procesi i të nxënit në TBU është i strukturuar për të siguruar përfshirjen aktive të studentëve në zhvillimin e kompetencave dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. TBU ka për qëllim të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës të formojë shkencëtarë të rinj përmes punës kërkimore – shkencore të nivelit bashkëkohorë të realizojë kualifikime shkencore të stafit akademik në fushat e shkencave të mirëfillta teorike dhe shkencave të zbatuara të tërheqë specialistët më të mirë, të krijojë kushte, të nxisë dhe inkurajojë rritjen e aftësive akademike dhe të kontributit të tyre, të kryejë studime shkencore për të zhvilluar dije të qëndrueshme si dhe për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit.[250]
TBU është i vetëdijshëm se cilësia, përmirësimi i vazhdueshëm dhe përmbushja e pritshmërive është një parakusht për zhvillimin dhe ekzistencën afatgjatë të tij. Në këtë kontekst, TBU ka përcaktuar objektivin strategjik "që të gjitha standardet e cilësisë të përmbushen përmes sigurimit të cilësisë dhe proceseve të përmirësimit". Ky objektiv përmbushet përmes përputhjes me Kodin e Cilësisë, me Standardet Europiane të Cilësisë në Arsimin e Lartë, me standardet ISO 9001:2015, përmes një angazhimi për një kulturë të cilësisë në mësimdhënie dhe mësim nxënie në të gjithë TBU e përkufizon sigurimin e cilësisë së të mësuarit dhe mësimdhënies si një proces të planifikuar dhe të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi dhe përmirësimi për të përcaktuar nëse misioni i TBU-së është realizuar dhe nëse standardet e cilësisë janë plotësuar, si një instrument që shton vlerë duke nxitur një cilësi të lartë të veprimtarisë së institucionit dhe të programeve të studimit që ofron[251].
Metodat dhe strategjitë e mësimdhënies janë të dizajnuara për të inkurajuar studentët të aplikojnë njohuritë teorike në situata reale dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për profesionin e tyre të ardhshëm. Në kuadër të kurrikulës dhe metodologjive të përdorura, procesi i të nxënit përfshin zhvillimin e projekteve dhe zgjidhjen e problemeve praktike, duke i mundësuar studentëve të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë që kanë fituar për të adresuar sfida konkrete dhe të rëndësishme në fushat e studimit. Po ashtu, punën në grup, që ndihmon në forcimin e bashkëpunimit dhe aftësive sociale, duke nxitur diskutime dhe shkëmbim ideje mes studentëve.

**Standardi III.16 Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.**

Programet e studimeve janë të strukturuara për të pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës, duke kombinuar teorinë me praktikën. Ato synojnë të zhvillojnë

[249] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Administrim Biznesi”; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi” 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në“Administrim Biznesi i Avancuar” 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software; 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; . Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).
[250] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.
[251] 23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies.

| |
|---|
| kompetenca profesionale dhe ndërdisiplinore, duke rritur punësimin e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut vendas dhe ndërkombëtar[252].<br><br>Studentëve, si të ciklit të parë dhe të dytë, u mundësohet kryerja e praktikës mësimore në institucione apo organizata të ndryshme me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.[253] Në këto institucione ata njihen me format dhe teknologjitë më të fundit dhe bashkëkohore, me qëllim përfitimin sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale që lidhen me fushën në të cilën studiojnë. |
| **Standardi III.17 Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe të huaj.**<br><br>Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë, duke krijuar mundësi për shkëmbimin e tyre, pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe promovimin e bashkëpunimit mes institucioneve akademike. Kjo nxitje e mobilitetit ka për qëllim jo vetëm zgjerimin e horizonteve akademike të studentëve, por edhe përmirësimin e aftësive të tyre profesionale dhe ndërkulturore, duke i mundësuar atyre të përfitojnë përvoja të reja dhe të thellojnë njohuritë e tyre në fushat përkatëse. Përmes marrëveshjeve me universitete dhe institucione të tjera në Evropë dhe jashtë saj, studentët mund të ndjekin studime të avancuara, të zhvillojnë kërkime të përbashkëta dhe të krijojnë lidhje profesionale që do t'i ndihmojnë ata në zhvillimin e karrierës së tyre ndërkombëtare. Ky proces gjithashtu kontribuon në njohjen dhe rritjen e vlerës së arsimit shqiptar në nivel global.<br>Programet e studimeve ofrohen në përputhje me Procesin e Bolonjës në cikle të njëpasnjëshme sipas sistemit Bachelor dhe Master (Profesional dhe Shkencor). Një elementë kyç në këtë proces është Sistemi Europian i Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), i cili lehtëson lëvizshmërinë e studentëve brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar kalimin nga një universitet në tjetrin dhe njohjen e kualifikimeve akademike. Gjithashtu, studentët kanë më shumë mundësi për studime dhe punësim në tregun evropian dhe më gjerë, duke i bërë programet akademike më konkurruese dhe të përshtatura me kërkesat e kohës.<br>Zyra e Projekteve dhe Ndërkombëtarizimit është përgjegjëse për aplikimin, zbatimin, koordinimin dhe monitorimin e të gjithë mobiliteteve të studentëve dhe stafit. Ndërmjet TBU-së dhe institucionit partner (Programme Country) nënshkruhet një marrëveshje e cila përcakton |

[252] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

[253] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 34.5. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse); 34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore.

numrin e shkëmbimeve dhe fushat e studimeve për studentët /ekspertizës për stafin. Pjesë e shkëmbimeve mund të jenë studentët e programeve të ciklit të parë (BA) dhe ciklit të dytë (MP/MSH) të studimit. [254] Për t'u bërë pjesë e programit Erasmus +, studentët e ciklit Bachelor duhet të kenë përfunduar patjetër vitin e parë të studimeve, ndërsa studentët Master mund të kryejnë shkëmbim që në semestrin e parë të programit të studimit [255].
TBU është angazhuar në bashkëpunimin me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus+ dhe jo vetëm, me qëllim promovimin e mobilitetit akademik, shkëmbimit të njohurive dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta kërkimore. Ndërmjet marrëveshjeve ndërinstitucionale mbështet mobilitetin e studentëve, pedagogëve dhe stafit administrativ, duke siguruar njohjen e ndërsjellë të krediteve dhe përfitimin nga praktikat më të mira akademike. Gjithashtu, TBU është e hapur për partneritete strategjike që përfshijnë programe të përbashkëta studimore dhe bashkëpunim në projekte kërkimore, duke kontribuar kështu në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.[256]

**Standarde III.18 Institucionet pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.**

Të gjitha rregulloret disiplinojnë procesin mësimor dhe aktivitetin kërkimor formal të programeve te studimit dhe janë te miratuara ne Senatin Akademik te TBU. Ne këto rregullore përcaktohen detyrimet që kanë studentët dhe stafi akademik mësimdhënës e mbështetës për realizimin e standardeve të programeve të studimit dhe përfundimin e studimeve, deri në pajisjen me diplomën përkatëse[257].
Programet realizohen me 60 kredite ECTS dhe 120 kredite (ECTS) për Master Profesional dhe dhe 120 kredite (ECTS) për Master i Shkencave, ku përfshihen edhe kreditet për provimin e formimit/temën e diplomës. Zgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik për Master profesional dhe 2 (dy) vite akademike për Master Profesional (120 ECTS) dhe Master i Shkencave. Studentët e këtyre programeve studimi duhet të japin edhe provimin e gjuhës së

[254] 20. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 20.1. Rregullore për shkëmbimet studentore; 20.2. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve.
[255] 20.2. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve
[256] 20. Rregullore për shkëmbimin e stafit; 20.1. Rregullore për shkëmbimet studentore; 20.1.1. IIA_TBU_Staffordshire_University_2017; 20.1.2. IIA_TBU_Staffordshire_University_2018; 20.1.3. Inter-Institutional Agreement_Bielefeld; 20.1.4. ICCM Agreement; 20.1.5. MoU_UniCusano_TBU; 20.1.6. WSB - TBU - MoU – 2024 20.1.7. MoU Obuda; 20.1.8. MoU Italy; 20.1.9. MoU IGS- TBU; 20.2. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.
[257] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

huaj, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.[258]
Në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional" në fushën e arsimit të kryer. Lëshimi i diplomave për ciklin e dytë bëhet në përputhje me përcaktimet ligjore dhe statutore.[259]
Diplomimi për programet e ciklit të parë të studimeve sipas LAL bëhet nëpërmjet një provimi të përgjithshëm përfundimtar ose përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome (mikrotezë). Studentët që fitojnë të drejtën të diplomohen duke përgatitur dhe mbrojtur një teme diplome, si rregull duhet të kenë notën mesatare mbi 7 (shtatë). Diplomimi për programet e ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional" sipas LAL bëhet nëpërmjet një provimi përfundimtar formimi, ose përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome në fushën e arsimimit të kryer. Diplomimi për programet e ciklit të dytë të studimeve "Master Shkencor" sipas L-AL bëhet nëpërmjet përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome në fushën e arsimimit të kryer.

---

[258] 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

[259] 27.1.4. Miratimi i formës së diplomës MP AB MEN 60; 27.1.4.1. Suplement MP MEN 60; 27.1.5.Miratimi i formës së diplomës MP KF 60; 27.1.5.1. Suplement MPKF60; 27.1.6. Miratimi i formës së diplomës MP AVANC.MEN 120; 27.1.6.1. Suplement MP 120 MEN; 27.1.7.Miratimi i formës së diplomës MPAVANCUAR KF; 27.1.7.1.Suplement MPKF 120; 27.1.8. Miratimi i formës së diplomës MP AVANC.MIX 120; 27.1.8.1.Suplement MP MIX 120; 27.1.9.Miratimi i formës së diplomës MSH AB ; 27.1.9.1.Suplement MSHAB; 27.2.4.1.TBU - FBD - MP60 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Kontabilitet Financë; 27.2.5.TBU - FBD - MP60 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës – Profili Menaxhim; 27.2.5.1.TBU - FBD - MP60 Administrim - Biznesi -- Suplementi i propozuar i ri i diplomës – Profili Menaxhim; 27.2.6.TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili E drejte biznesi; 27.2.6.1.TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili E drejte biznesi; 27.2.7.TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Kontabilitet Financë; 27.2.7.1.TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Kontabilitet Financë; 27.2.8.TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Menaxhim; 27.2.8.1.TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Menaxhim; 27.2.9.TBU - FBD - MSH Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës ; 27.2.9.1.TBU - FBD - MSH Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës; ; 27.2.13.TBU - FTI- MSH - Inxhinieri Softuerike - Forma e propozuar e diplomës; 27.2.13.1.TBU - FTI - MSH Inxhinieri Softuerike - Suplementi i propozuar i diplomës; 27.2.14.TBU - FTI – MSH Informatikë Ekonomike - Forma e propozuar e diplomës; 27.2.14.1. TBU - FTI - MSH Informatkë Ekonomike - Suplementi i propozuar i diplomës.

Punimi i diplomës përgatitet në përputhje me Udhëzimin për Përgatitjen e Temës së Diplomës.[260]

**Standardi III.19 Institucioni siguron laboratorë të dedikuar në mbështetje të programeve të studimit dhe kërkimi shkencor/artistik.**

Programet e studimit janë në përputhje me misionin e TBU-së, kapacitet infrastrukturore, akademike e logjistike që TBU disponon.
Auditorët, sallat dhe mjediset e tjera ofrojnë te gjithë komoditetin e nevojshëm për studim, pune shkencore dhe individuale, si për studentet dhe stafin akademik. TBU, ka një infrastrukture specifike të prekshme dhe shumë funksionale në varësi të përmbajtjes së programeve të studimeve.
Në TBU, studentët dhe stafi akademik kanë qasje në një gamë të gjerë të pajisjeve kompjuterike për të mbështetur nevojat e tyre akademike dhe administrative. Konkretisht, në TBU ka dy laboratorë kompjuterik, i pari është i pajisur me 30 kompjuterë HP të fuqizuar nga procesori Intel Core i5 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit, ndërsa laboratori dytë është i pajisur me 60 kompjuterë Fujitsu të fuqizuar nga procesori Intel Core i3-9100 CPU @3.6 GhZ, 8 GB RAM dhe sistem operativ: Windows 11 Pro 64-bit si dhe 2 projektor të lidhur paralel Epson EB-W42. Këto pajisje të përditësuara ofrojnë performancë të lartë dhe stabilitet, duke u mundësuar përdoruesve të kryejnë detyra komplekse dhe të përdorin softuerë të avancuar pa vonesa.[261]
Gjithashtu, TBU disponon 10 salla të pajisura me nga një kompjuter HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit. Secila nga këto salla është gjithashtu e pajisur me një projektor ACER X1226AH DLP, duke lejuar prezantime dhe leksione interaktive me cilësi të lartë vizuale.[262]
Për pedagogët dhe stafin administrativ, TBU ka në dispozicion 20 njësi kompjuterike HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM, 64-bit, Windows 10 Pro, dhe 5 njësi me HP

[260] 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 27.1.1.Miratimi i formës së diplomës Ba AB MEN; 27.1.1.1.Suplement Ba AB MEN; 27.1.2.Miratimi i formës së diplomës Ba AB FINKON; 27.1.2.1.Suplement Ba AB FINKON; 27.1.3.Miratimi i formës së diplomës Ba AB MKG; 27.2.1. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Menaxhim; 27.2.1.1. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i Diplomës - Profili Menaxhim; 27.2.2.TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës- Profili Kontabilitet Financë; 27.2.2.1.TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës Profili Kontabilitet Financë; 27.2.3. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Marketing; 27.2.3.1. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Marketing; 27.2.10.TBU - FTI - Ba Inxhinieri Softuerike - Forma e propozuar e diplomës; 27.2.10.1. TBU - FTI - Ba Inxhinieri Softuerike - Suplementi i propozuar i diplomës; 27.2.11.TBU - FTI - Ba Inxhinieri Kompjuterike - Forma e propozuar e diplomës; 27.2.11.1.TBU - FTI – Ba Inxhinieri Kompluterike - Suplementi i propozuar i diplomës; 27.2.12. TBU - FTI - Ba Informatikë Ekonomike - Forma e propozuar e diplomës; 27.2.12.1. TBU - FTI - Ba Informatikë Ekonomike - Suplementi i propozuar i diplomës.
[261] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.
[262] 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike.

| |
|---|
| EliteDesk të pajisura me Intel Core i7 6700 CPU dhe 16 GB RAM. Këto pajisje të fuqishme sigurojnë që stafi të mund të kryejë detyrat e tyre me efikasitet të lartë dhe me mbështetje teknologjike të avancuar.[263] |
| **Standardi III.20 Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit.**<br><br>TBU garanton sigurimin dhe funksionalitetin e infrastrukturës laboratorike dhe shërbimeve mbështetëse për programet e studimit, duke krijuar një mjedis optimal për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Institucioni ofron pajisje moderne laboratorike dhe lehtëson kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve, si brenda mjediseve të institucionit ashtu edhe jashtë tij, në përputhje me temat e praktikave profesionale dhe fushën e studimit.[264]<br>Në kuadër të këtij angazhimi, TBU siguron staf ndihmës akademik të kualifikuar për mbështetjen e studentëve gjatë orëve laboratorike, duke garantuar një proces mësimor efektiv dhe të sigurt.[265] Gjithashtu, institucioni merr masa të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e laboratorëve dhe mjediseve të tjera didaktike, duke i përshtatur ato sipas nevojave specifike të programeve të studimit dhe standardeve akademike.<br>Kjo qasje synon të ofrojë një përvojë mësimore të orientuar drejt praktikës dhe kërkimit shkencor, duke i përgatitur studentët me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për tregun e punës dhe sfidat profesionale.[266] |
| **Standardi III.21 Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe.**<br><br>Biblioteka eshte e domosdoshme te ruaj specifikat qe kërkohen në përdorimin e literaturës që përbën fondin e saj. Ajo përmban ne fondin e saj literaturë nga fusha e së drejtës, ekonomisë, IT dhe shkencave shoqërore me qëllim që të plotësojë kërkesat e studentëve për seicilin program studimi.[267] Biblioteka është njësi ndihmëse e institucionit dhe ushtron aktivitetin e saj, brenda hapësirës së TBU. Ajo është në shërbim të procesit mësimor, edukativ, formimit profesional dhe veprimtarisë shkencore të përdoruesve të saj. Biblioteka është në katin I dhe është e shtrirë në një sipërfaqe të mjaftueshme dhe lehtësisht e aksesueshme nga studentët. Biblioteka është e pajisur me fond te caktuar, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme sipas natyrës e specifikës së programeve të studimit. Biblioteka vendos në shërbim të përdoruesve materiale në përshtatje me kërkesat akademike, shkencore për studentët, personelin mësimdhënës akademik dhe administrativ (libra,fjalor,internet).[268] |

[263] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.
[264] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU; 11.Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024.
[265] 16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik.
[266] 29.1. Studimi i tregut të punës.
[267] 37. Rregullore e Bibliotekës; 37.1. Database Biblioteka 23-24.
[268] 37. Rregullore e Bibliotekës; 37.1. Database Biblioteka 23-24.

Në TBU ka ekzistuar një abonim vjetor në librarinë online EBSCO deri në dhjetor 2022. Aktualisht institucioni është në tratativa për të rinovuar këtë shërbim për vitin akademik 2024-2025 si dhe për tu angazhuar dhe në abonimin në Scopus Research database[269].
Salla e bibliotekës në TBU u vjen në ndihmë studentëve jo vetëm për studim, por edhe për fotokopje ose printime të materialeve të ndryshme si detyra kursi, leksione etj. Biblioteka është pasuruar edhe me revista shkencore në fushën e drejtësisë.[270] Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulat mësimore është proces i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave. [271]Biblioteka gjithashtu ka një punonjës të ngarkuar për menaxhimin e saj.

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

Në TBU programet e studimit organizohen për të përmbushur standardet kombëtare të cilësisë, duke respektuar në formë dhe përmbajtje kërkesat që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.
TBU siguron organizimin dhe dokumentimin efikas të planeve mësimore për programet e studimeve.
Mënyra e organizimit të studimeve të ofruara nga TBU dhe dokumentimi mësimor në formë të shkruar janë të përcaktuara qartë në Statutin dhe Rregullore të TBU-së. Ndërkohe rregulloret e njësive bazë të TBU sigurojnë zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit. TBU ofron programe studimi që përkojnë me vizionin, misionin dhe objektivat institucionalë. Kurrikulat dhe programet mësimore të lëndëve/moduleve ndjekin një model të standardizuar, që përfshin kreditet ECTS, objektivat e të nxënit, ngarkesën e punës së studentëve, tipologjinë, literaturën dhe vlerësimin. Dokumentimi efikas i çdo programi studimi sigurohet nëpërmjet dosjes së programit të studimit që përmban të gjithë formacionin e nevojshëm (informacion për institucionin. programin e studimit, strukturat akademike përgjegjëse dhe të tjera bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit të studimit, personelin akademik për realizimin e programit planin mësimor, infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve/moduleve, rregulloren e programit të studimeve dhe suplementin e diplomës).
Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për rezultatet e tyre të të nxënit dhe përputhen me nivelin e profilin kualifikimit që ofrojnë, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin e programit.
Ne TBU praktikat profesionale të përfshira në programet studimore përkatëse synojnë aftësimin sa më të plotë praktik të studentëve krahas formimit teorik të tyre dhe punësimin sa më të hershëm të studentit. TBU garanton zhvillimin e praktikave studimore nga viti i parë i programit Bachelor deri në vitin e fundit të programit Master, duke mundësuar harmonizimin mes spirales në ngjitje vit-pas-viti të formimit teorik me spiralen në ngjitje vit-pas-viti të aftësimit praktik.

[269] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 13.
[270] 37. Rregullore e Bibliotekës.
[271] 37. Rregullore e Bibliotekës; 37.2. TBU - Procedura e Blerjes se Literatures ne Tirana Business University College.

TBU pajis studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Programet e studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun e punës.
Në TBU Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësisë dhe realizohen në bashkëpunimin me aktorë të fushës. Njëkohësisht, TBU siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.
Në TBU programet e studimit analizohen për të vlerësuar performancën e tyre, duke nxjerrë dhe përfundimet përkatëse, dhe në bazë të përfundimeve që vijnë nga indikatorë të brendshëm dhe të jashtëm, propozohen dhe ndryshimet. Institucioni ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit dhe kërkesat e tregut.
Standardet **e Fushës së vlerësimit: "Programet e Studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi" janë përmbushur plotësisht.**

# IV- AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI

| |
|---|
| **Standardi IV.1 Institucioni përcakton fushat parësore të aktiviteteve kërkimore, shkencore/artistike.**<br><br>Strategjia e Kërkimit në ekspertizën e stafit akademik dhe në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e profilit kërkimor shkencor të universitetit[272].<br>TBU ka për qëllim të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës të formojë shkencëtarë të rinj përmes punës kërkimore – shkencore të nivelit bashkëkohor të realizojë kualifikime shkencore të stafit akademik në fushat e shkencave të mirëfillta teorike dhe shkencave të zbatuara të tërheqë specialistët më të mirë, të krijojë kushte, të nxisë dhe inkurajojë rritjen e aftësive akademike dhe të kontributit të tyre, të kryejë studime shkencore për të zhvilluar dije të qëndrueshme si dhe për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit[273].<br>Fokusi dhe shtylla kryesore për arritjen e këtyre qëllimeve është stafi akademik dhe administrativ i TBU-së, studentët e dy cikleve të studimit, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të brendshëm e të jashtëm të cilët kërkimin shkencor e shohin si përgjegjshmëri, kontribut dhe nevojë për zhvillimin shoqëror e social.[274]<br>TBU dhe strukturat përkatëse të saj, përkatësisht njësitë kryesore (Fakultetet), dhe njësitë bazë (Departamentet) si dhe Qendra Kërkimore (Qendra për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike), në kuadër të Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2024-2029[275] kanë përcaktuar fushën e biznesit (edhe si administrim edhe si e drejtë) si dhe teknologjinë e informacionit si prioritete të veprimtarisë së tyre për kërkim-zhvillim.<br>Përmes ofrimit të programeve të studimit të përshtatura me nevojat e tregut dhe përmes partneritetit me industrinë dhe komunitetin e biznesit, TBU synon të edukojë një brez të ri profesionistësh të cilët do të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e një tregu global. Kjo përputhet me nevojat e zhvillimit të vazhdueshëm të ekonomisë shqiptare dhe me kërkesat e një shoqërie moderne të integruar në tregun ndërkombëtar. TBU synon të kthehet në një institucion ku zhvillohen studime cilësore dhe kërkime intensive dhe ku mësimdhënia dhe kërkimi janë të lidhura pazgjidhshmërisht. Për të arritur sa më sipër, TBU ka hartuar një kornizë |

[272] 1.Statuti TBU; 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 7.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29; 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29.

[273] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.

[274] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29; 33.2.Indikatorët e matjes së performances; 33.3. Politika për grantet e punës kërkimore dhe shkencore; 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni).

[275] Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29; 3.3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ.

strategjike me një sërë objektivash[276]. Gjithashtu, në aktivitetet e organizuara nxitet ekspozimi i gjetjeve dhe ideve si dhe debati akademik.[277]

**Standardi IV.2 Institucioni zbaton prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor.**

Në përputhje me Statutin e TBU[278], Fakulteti i Biznesi dhe Drejtësisë është i përbërë nga tri departamente lëndore (Departamenti i Biznesit dhe Financës, Departamenti i Drejtësisë, si dhe Qendra për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike (me poshtë mund t'i referohemi edhe si Qendra Kërkimore, QKSEJ)). Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit është i përberë nga tri departamente lëndore (Departamenti i Informatikës Ekonomike, Departamenti i Inxhinierisë Software dhe Departamenti i Inxhinierisë Komjuterike). Roli i departamenteve dhe drejtuesve të departamenteve përcaktohet në Statut dhe Rregulloren e Institucionit[279].
Senati Akademik me vendimin përkatës[280], ka miratuar Strategjinë e re të Kërkimit Shkencor 2024-2029[281]. Në ketë strategji përcaktohet qartë që kërkimi shkencor përveçse iniciativë individuale e çdo anëtari të stafit akademik të TBU, është gjithashtu nismë e TBU-së si institucion e cila realizohet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë dhe koordinim të punës së stafit akademik, njësive bazë dhe Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike.[282]
Strategjia e Kërkimit Shkencor 2024-2029 mbështetet në Statutin e TBU-së, Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2024-2029, në ligjin 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" në ekspertizën e stafit akademik dhe në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e profilit kërkimor shkencor të universitetit. Parimet dhe kërkesat e Kodit Etik te Kërkimit Shkencor janë pjese e gjithë aktivitetit të kërkimit shkencor pranë TBU-së.[283]
TBU ka për qëllim të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës të formojë shkencëtarë të rinj përmes punës kërkimore – shkencore të nivelit bashkëkohorë të realizojë kualifikime shkencore të stafit akademik në fushat e shkencave të mirëfillta teorike dhe shkencave të zbatuara të tërheqë specialistët më të mirë, të krijojë kushte, të nxisë dhe inkurajojë rritjen e aftësive akademike dhe të kontributit të tyre, të kryejë studime shkencore për të zhvilluar dije të qëndrueshme si dhe për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit.[284]

[276] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29; 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni); 33.5. Raporti Vjetor për Realizimin e Planit të Punës për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU.

[277] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 35. Raporti Vjetor TBU 23-24, Pika 4, fq. 22; 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni).

[278] 1. Statuti TBU; 1.1. Organigrama e re me vulën e MAS.

[279] 1. Statuti TBU; 1.1. Organigrama e re me vulën e MAS; 3.Rregullore e Kolegjit Universitar TBU.

[280] 13.2. Vendim Senati për miratimin e Strategjisë të Zhvillimit & Strategjisë të Kërkimit 2024.

[281] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.

[282] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29; 33.4.1. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.4.2. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 24-25.

[283] 1.Statuti TBU; 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 23.3.Kodi Etik i Kërkimit Shkencor në TBU.

[284] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.

Fokusi dhe shtylla kryesore për arritjen e këtyre qëllimeve është stafi akademik dhe administrativ i TBU-së, studentët e dy cikleve të studimit, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të brendshëm e të jashtëm të cilët kërkimin shkencor e shohin si përgjegjshmëri, kontribut dhe nevojë për zhvillimin shoqëror e social.[285]
TBU ka krijuar një eksperiencë mjaft të mirë me funksionimin harmonik të departamenteve lëndore, të cilat janë përgjegjëse dhe zhvillojnë të gjitha rolet e përcaktuara në Statut dhe sipas legjislacionit në fuqi e në përputhje me këtë standard. Drejtuesi i departamentit është një i parë mes të barabartëve në raport me lirinë akademike por edhe një koordinues, monitorues i kryerjes së detyrave nga stafi i departamentit, propozues dhe vendimmarrës. Në departament janë aktiv jo vetëm pedagogët me kohë të plotë por edhe ata me kohë të pjesshme, dhe të gjithë së bashku kooperojnë për zhvillimin në tërësinë e vet të fushës së departamentit dhe bashkëveprojnë me departamentet e tjerë[286]. Departamentet hartojnë planin e punës para fillimit të çdo viti akademik, ku pjese e rëndësishme e tij është edhe kërkimi shkencor. Në mbyllje te çdo viti akademik çdo njësi bazë përgatit edhe raportin vjetor ku detajohen realizimet e çdo njësie[287]. Departamenti mban rregullisht një bazë të dhënash për secilin anëtar të tij në lidhje me kërkimin shkencor, e cila përditësohet në mënyre të vijueshme dhe raportohet pranë QKSEJ e cila përgatit dhe raportimin vjetor të punës kërkimore shkencore individuale të stafit të TBU[288].
Për sa i përket Qendrës Kërkimore, roli i saj ka konsistuar gjatë këtyre viteve në lehtësimin e kërkimit individual shkencor të stafit pedagogjik, në organizimin e aktiviteteve shkencore (konferenca, seminare)[289], si edhe ne bashkëpunim me departamentet për te aplikuar për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.[290] Kjo qendër harton një plan për kërkimin shkencor përpara fillimit te çdo viti akademik dhe në mbyllje të tij përgatit një raport për kërkimin shkencor[291].
Pranë TBU operon edhe Zyra e Projekteve për Kërkim & Zhvillim, e cila ndihmon në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të kolegjit, duke i ofruar shërbim dhe mbështetje administratës

[285] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29; 33.8.Parimet e Organizimit të Zyrës së Projekteve për Kërkim & Zhvillim; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.
[286] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni).
[287] 4.5.1. Plan pune dhe aktivitete DBF 2023-2024; 4.5.2. Raporti vjetor i DBF 2023-2024; 4.5.3. Plan pune dhe aktivitete DBF 2024-2025; 5.2.1. Plan pune dhe aktivitete DD 2024-2025; 5.2.2. Raporti Vjetor i DD 2023-2024; 5.3.1. Plan pune dhe aktivitete DIS 2023-2024; 5.3.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024; 5.3.3. Plan pune dhe aktivitete DIS 2024-2025; 5.4.1. Plan pune dhe aktivitete DIE 2023-2024; 5.4.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 5.4.3. Plan pune dhe aktivitete DIE 2024-2025; 5.5.1. Plan pune dhe aktivitete DIK 2023-2024; 5.5.2. Raporti vjetor i DIK 2023-2024; 5.5.3. Plan pune dhe aktivitete DIK 2024-2025.
[288] 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni).
[289] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 38.1. Aktivitete akademike për pedagogët.
[290] 33.8.Parimet e Organizimit të Zyrës së Projekteve për Kërkim & Zhvillim; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.
[291] 33.4.1. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.4.2. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 24-25; 33.5. Raporti Vjetor për Realizimin e Planit të Punës për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24.

së Universitetit, fakulteteve, dhe stafit për të siguruar dhe për të menaxhuar financim të jashtëm për aktivitete të kolegjit[292].
Gjithashtu janë ndërtuar indikatorët e performancës[293] së punës kërkimore shkencore në TBU, të cilët janë një sistem i ndërtuar me qëllim matjen në mënyrë objektive të punës kërkimore dhe shkencore, si dhe punës në shërbim të zhvillimit të institucionit apo të sektorit të arsimit të lartë në tërësi.
TBU ka miratuar një politike për grantet individuale për Kërkuesin Shkencor, për të mbështetur realizimin e punës së tij kërkimore shkencore. Politika për grantet e punës kërkimore dhe shkencore, ka për qëllim të orientojë përafërsisht pedagogun në planifikimin dhe zbatimin e punës së tij vjetore ose të ciklit kontraktual me TBU, edhe në funksion të kualifikimit shkencor të tij, në funksion të rritjes së cilësisë së performancës së tij si pedagog sa i përket mësimdhënies, kualifikimit shkencor për gradën dhe titullin e mëtejshëm, kërkimin dhe zhvillimin, në përputhje me modalitetet kontraktuale që ka kontrata e pedagogut të brendshëm në TBU.[294]
Gjatë vitit akademik 2023-2024 është realizuar riorganizimi i Qendrës për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike, QKSEJ, dhe angazhimi i saj, në bashkëpunim me Zyrën e Projekteve, lidhur me tërheqjen në partneritete të IAL-ve dhe organizatave të huaja dhe shqiptare, në kuadër të pjesëmarrjes në projekte të ndryshme[295], si dhe aplikimin për projekte në AKKSHI (ku personeli akademik i TBU-së ka aplikuar për katër projekte, nga të cilat kanë rezultuar fitues dhe ka marrë financim për dy projekte), COST dhe Erasmus+ (TBU ka arritur të sigurojë pjesëmarrjen në projektin "Dualba" - Dual Education, të financuar nga Komisioni Europian).
Gjithashtu, TBU ka organizuar shumë aktivitete shkencore (seminare, simpoziume, ligjërime, tavolina të rrumbullakëta, workshop-e, leksione të hapura) të cilat janë të evidentuara në Raportet Vjetore të Institucionit si dhe në faqen e web-it[296]. Në traditën disa-vjeçare të TBU është edhe organizimi i takimeve për të prezantuar arritje të caktuara, nga personalitete të jetës akademike shqiptare dhe të huaj, në lidhje me studimet e tyre kërkimore-shkencore në fusha të caktuara dhe veçanërisht ato që kanë një lidhje të drejtpërdrejte me biznesin dhe teknologjinë e informacionit.
TBU ka promovuar dhe nxitur personelin e saj akademik që të marrë pjesë në aktivitete dhe konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Punimet e personelit akademik të TBU janë publikuar në revista shkencore ndërkombëtare[297].

[292] 33.8. Parimet e Organizimit të Zyrës së Projekteve për Kërkim & Zhvillim; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.
[293] 33.2. Indikatorët e matjes së performances.
[294] 33.3. Politika për grantet e punës kërkimore dhe shkencore.
[295] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 3.3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ;33.8.Parimet e Organizimit të Zyrës së Projekteve për Kërkim & Zhvillim; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve; 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 35. Raporti Vjetor TBU 23-24.
[296] 33.4.1. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.4.2. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 24-25; 33.5. Raporti Vjetor për Realizimin e Planit të Punës për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24;33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni); 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 35. Raporti Vjetor TBU 23-24.
[297] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni).

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

**Standardi IV.3 Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin e veprimtarive kërkimore / artistike dhe shkencore.**

Strategjia e Kërkimit Shkencor 2024-2029, është hartuar mbi parimin se TBU ka sukses si universitet kur individët kanë sukses në karrierën e tyre, se TBU njeh shumëllojshmërinë e kontributeve që janë bërë për kërkime dhe që vlerëson cilësinë e asaj që bëjmë mbi sasinë e saj. Këto vlera do të ndihmojnë TBU që kërkimi të vazhdojë të bëjë një ndryshim në njohuritë dhe jetën e njerëzve. Strategjia e Kërkimit Shkencor 2024 –2029 ka një mesazh të thjeshtë: "Duke punuar në ekip, duke ndërtuar mbi idetë e njëri-tjetrit dhe duke e bërë TBU-në një vend të mirë për të zhvilluar një karrierë, kërkimi ynë transformon jetët dhe jep kontribut pozitiv në komunitet".[298]

Ashtu sikurse është përcaktuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2024-2929[299], TBU inkurajon dhe mbështet çdo iniciativë për kërkimin shkencor individuale apo në nivel institucioni. Qendra për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike[300] merr një rol parësor në mirë orientimin e kërkimit shkencor në bashkëveprim me departamentet[301] të cilat duhet të udhëheqin punën kërkimore në fushat përkatëse, me theks kërkimin shkencor aplikativ dhe/ose njohjen, analizimin dhe parashikimin e fenomeneve që ndodhin apo pritet të ndodhin në mjedisin ekomomik, social, institucional e ligjor në Shqipëri. Në piken 7 të Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2024-2029[302] dhe në dokumentin Politika e Granteve[303] përcaktohet qartë mbështetja, përfshi atë financiare, që TBU bën për inkurajimin e kërkimit shkencor. Në vijim një nga pikat e forta për TBU konsiderohet Investimet kapitale në infrastrukturën kërkimore.[304]

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit Shkencor në TBU është i aksesueshëm dhe mund të rishikohet sipas nevojës, me të dhëna nga të gjithë anëtarët e komunitetit të universitetit, duke përfshirë studentët, fakultetin, stafin administrativ dhe bashkëpunëtorët. Pjesëmarrja aktive e të gjithë komunitetit universitar është thelbësore për zbatimin me sukses të strategjisë. Kjo kërkon një përkushtim të vazhdueshëm për monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë për të siguruar efektivitetin dhe rëndësinë e saj të vazhdueshme.[305]

Në dt. 21.11.2024, TBU organizoi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Technology & Business Update: "Technology Disruption: Challenges and Opportunities for Adding Value to National Economy, Business & Society"", si konferenca e parë mbas riorganizimit dhe krijimit

[298] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.
[299] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.
[300] 3.3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ.
[301] 4.5.1. Plan pune dhe aktivitete DBF 2023-2024; 4.5.2. Raporti vjetor i DBF 2023-2024; 4.5.3. Plan pune dhe aktivitete DBF 2024-2025; 5.2.1. Plan pune dhe aktivitete DD 2024-2025; 5.2.2. Raporti Vjetor i DD 2023-2024; 5.3.1. Plan pune dhe aktivitete DIS 2023-2024; 5.3.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024; 5.3.3. Plan pune dhe aktivitete DIS 2024-2025; 5.4.1. Plan pune dhe aktivitete DIE 2023-2024; 5.4.2. Raporti vjetor i DIE 2023-2024; 5.4.3. Plan pune dhe aktivitete DIE 2024-2025; 5.5.1. Plan pune dhe aktivitete DIK 2023-2024; 5.5.2. Raporti vjetor i DIK 2023-2024; 5.5.3. Plan pune dhe aktivitete DIK 2024-2025; 33.4.1. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.4.2. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 24-25; 33.5. Raporti Vjetor për Realizimin e Planit të Punës për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24.
[302] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.
[303] 33.3. Politika për grantet e punës kërkimore dhe shkencore.
[304] 33.8.Parimet e Organizimit të Zyrës së Projekteve për Kërkim & Zhvillim; 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve.
[305] 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29.

të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, ku morën pjesë pedagogë kërkues shkencorë prane TBU si dhe nga institucione të tjera të arsimit të larte por jo vetëm, specialistë dhe drejtues nga bota e biznesit, studentë apo ish studentë të TBU. Kjo konferencë do të vijojë të zhvillohen në menyrë periodike një herë në vit, ku do të theksohet njohja e saj në arenën ndërkombëtare sipas klasifikimeve dhe indekseve përkatëse.[306]

TBU planifikon në vijim hapjen dhe botimi e revistës së parë shkencore nga TBU[307]. Kjo revistë synohet të jetë një nga shtyllat kryesore për publikimin e kërkimit shkencor të stafit të brendshëm akademik të TBU-së, por edhe nga kërkues dhe akademikë të tjerë shqiptarë dhe të huaj, duke u bazuar gjithashtu në një sistem "peer review" për të garantuar cilësinë e publikimeve të saj. Do bëhen përpjekje gradualisht në kohë edhe për indeksimin e saj nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në bazë të kritereve ligjore në fuqi, si edhe në databazë të rëndësishme ndërkombëtare për të rritur ndikimin e saj.

Duke pasur parasysh mbështetjen e grupeve dhe projekteve kërkimore shkencore të reja, stafi akademik dhe studentët janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime, të cilat kanë rezultuar në botimin e artikujve dhe në pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme[308]. Pjesëmarrja në konferenca dhe botimet nga stafi akademik i TBU-së ilustrohet ne programin e konferencës dhe broshurën përkatëse[309]. TBU vlerëson si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore, qofshin këto brenda apo jashtë vendit. Në këtë kuadër, TBU ka bashkëpunime me institucione kombëtare dhe shkolla të larta jashtë Shqipërisë.[310]

Qendra për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike (QKSEJ), në përputhje me Strategjinë e Kërkimit Shkencor të TBU-së, si dhe bazuar në Planin e Punës për vitin akademik 2023-2024, u angazhua në veprimtaritë e mëposhtme, që lidhen me punën kërkimore-shkencore[311]:

- Në kuadër të projekteve të Programit të Kërkimit dhe Zhvillimit, të financuara nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), personeli akademik i TBU-së ka aplikuar për katër projekte, nga të cilat kanë rezultuar fituese dhe kanë marrë financim dy projekte, me temë: "Kërkimi për Zhvillimin e Investimeve Strategjike të Turizmit në Rajonin e Vlorës" dhe "Rritja e Kapaciteteve për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Tiranë".
- Në kuadër të thirrjeve të programit COST Action, tri anëtarë të stafit të TBU aplikuan për të qenë partner në thirrjen e COST të titulluar "Academic Migration: Challenges and Limitations on Achieving EU Goal in Inclusion", por nuk u shpallën fitues.

[306] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU.
[307] 33.4.2. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 24-25.
[308] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU; 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni).
[309] 33.7.1. Program of TBU Conference; 33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU.
[310] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.
[311] 33.4.1. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.5. Raporti Vjetor për Realizimin e Planit të Punës për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU; 33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29.

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

- Në Dhjetor 2023, TBU nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me Albanian-American Development Foundation për përfshirjen në programin READ. Të gjithë anëtarët e stafit akademik të TBU-së mund të aplikojnë për financim të projekteve në kuadër të programit Research Expertise from Albanian Diaspora (READ), si edhe të përfitojnë nga mundësitë e bashkëpunimit me shkollarët e suksesshëm të Diasporës shqiptare në funksion të zhvillimit të kërkimit shkencor, bashkë mësim-dhënies, zhvillimit të kurrikulave, bashkë-udhëheqjen e doktoraturave.
- Në kuadër të angazhimit të TBU-së për t'u përfshirë në rrjetin Central European Exchange Program for University Studies (CEEPUS), TBU ka ndërmarrë hapa për lehtësimin e përfshirjen në këtë program që bën të mundur dhënien e granteve për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve, dhe promovon bashkëpunimin midis universiteteve partnere në vendet përkatëse.
- TBU ka arritur të sigurojë pjesëmarrjen në një projekt të financuar nga Komisioni Europian, Dual Education, e cila shtrihet në një periudhë 4 vjeçare dhe që synon rritjen e kompetencave të të diplomuarve të arsimit të lartë në Shqipëri. Projekti fokusohet në zhvillimin e një modeli të përgjithshëm të edukimit të dyfishtë (në marrëdhënien Universitet-Biznes) dhe krijimin e një kuadri ligjor dhe strategjik për zbatimin e tij. Ky projekt udhëhiqet nga Universiteti Novi Sad në Serbi, dhe TBU është një nga universitetet partnere përfituese nga ai.
- Në lidhje me Konferencën Shkencore Ndërkombëtare që u organizua nga TBU u mundësua ngritja e grupit të punës për organizimin e konferencës (në gjuhën angleze), Komiteti Shkencor i Konferencës, u përgatit broshura me të gjitha detajet për organizimin e kësaj konference.
- Në kuadër të lidhjes së partneriteteve në kuadër të programit Erasmus+ me universitete partnere në vende të BE-së, janë nënshkruar Memorandume Bashkëpunimi (MoU-s) me Universitin Niccolò Cusano (Rome, Itali), Universitin e Salentos (Lecce, Italy), dhe WSB University (Poloni). Gjithashtu, Qëndra për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike në bashkëpunim edhe me Zyrën e Projekteve të TBU-së, ka vendosur partneritete edhe me dy organizata ndërkombëtare - Placement in Portugal dhe ICCC Malaysia – në funksion të organizimit apo pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, si edhe rritjes së ekspozimit ndërkombëtar të Universitetit[312].
- QKSEJ mundësoi hartimin dhe miratimin e dokumentit tip për Indikatorët e Matjes së Performancës Kërkimore-Shkencore. Ky dokument strategjik për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor të TBU-së do të bëjë të mundur nxitjen e punës kërkimore-shkencore nga stafi i brendshëm i TBU-së, si edhe vlerësimin mbi baza objektive të saj për çdo anëtar të personelit akademik.

---

[312] 20.1.5. MoU_UniCusano_TBU; 20.1.6. WSB - TBU - MoU – 2024 20.1.7. MoU Obuda; 20.1.8. MoU Italy; 20.1.9. MoU IGS- TBU.

**Standardi IV.4 Institucioni dhe njësitë përgjegjëse për kërkimin shkencor/ artistik dhe inovacionin vlerësojnë performancën e tyre në nivel institucional.**

Indikatorët e matjes së performancës së punës kërkimore shkencore në TBU janë një sistem i ndërtuar me qëllim matjen në mënyrë objektive të punës kërkimore dhe shkencore, si dhe punës në shërbim të zhvillimit të institucionit apo të sektorit të arsimit të lartë në tërësi[313].
- TBU me përqendrimin në dy fakultete, synon një nivel më të lartë efikasiteti dhe efektiviteti në administratën dhe menaxhimin e përgjithshëm të institucionit.
- Përgjigjet ndaj sfidave dhe mundësive që ofrojnë këto fusha specializimi do të ndihmojnë në krijimin e një profili unik dhe një reputacioni të dallueshëm për TBU-në në skenën e arsimit të lartë.[384]

**Standardi IV.17 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.**

Kodi Etik i Kërkimit Shkencor në TBU[385] është një dokument që synon të përcaktojë një kuadër të përgjithshëm mbi udhëzimet dhe përgjegjësitë e qarta për cilindo që kryen kërkim shkencor në ose për TBU-në, për të siguruar që ata janë në gjendje të përmbushin përgjegjësitë e tyre, sipas standardeve etike, ligjore dhe profesionale. Kodi përcakton detyrimet për studiuesit dhe kërkuesit shkencorë në dhe për TBU-në, të jenë të vetëdijshëm për politikat që rregullojnë kërkimin shkencor në TBU dhe të zbatojnë kërkesat institucionale dhe rregullatore.

Në rregulloren e QKSEJ[386] përcaktohen rregullat bazë të funksionimit dhe operimit, si dhe detyrat e përgjegjësitë e saj, ndërmjet të tjerash (shiko kryesisht pika f) dhe g)): a) Bashkërendon

---

383 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.
384 33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU.
385 23.3. Kodi Etik i Kërkimit Shkencor në TBU.
386 3.3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ.



TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

planin e punës kërkimore me departamentet e fakulteteve; b) Organizon veprimtari shkencore dhe ose në bashkëpunim me universitete të tjera vendase ose të huaja; c) Zhvillon konferenca, simpoziume, forume shkencore, tryeza diskutimesh universitare, ndëruniversitare dhe ndërkombëtare; d) Tërheq dhe aktivizon në veprimtarinë shkencore dhe botuese studentët me të mirë të fakulteteve, përgatit për studentët module suplementare dhe veprimtari të tjera të ngjashme; e) Boton dhe publikon, përveç teksteve mësimore, edhe përmbledhje studimesh, referatesh, kumtesash, etj.; f) Çdo përgjegjësi dhe ose kompetence tjetër e parashikuar në këtë statut ose në akte të tjera rregullatore, (nënkupton edhe përgjegjësitë që rrjedhin apo kërkohet në bazë të ligjit për garantimin e pronësisë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor); g) Çdo përgjegjësi dhe ose kompetencë që njihet vetëm drejtuesit të qendrës kërkimore-shkencore nga Ligji për Arsimin e Lartë në fuqi, të aplikueshme në rastin e institucioneve jo publike të arsimit të lartë (nënkupton edhe ato përgjegjësi në funksion të mbrojtjes se pronësisë intelektuale).

TBU, nëpërmjet QKSEJ evidenton punën kërkimore shkencore të stafit dhe ruan informacionin individual me qëllime raportimi, matje performance si dhe për ndjekje të pronësisë intelektuale në përputhje me legjislacionin në fuqi (TBU disponon të dhëna të sakta të punimeve shkencore individuale)[387].

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

TBU ka përcaktuar qartë fushat prioritare të kërkimit shkencor në përputhje me strategjitë e tij të zhvillimit dhe kërkimit, si dhe në bashkëpunim me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktivitetet kërkimore të TBU-së janë fokusuar në fushat e biznesit, administratës, të drejtës dhe teknologjisë së informacionit, duke synuar përgatitjen e specialistëve dhe shkencëtarëve të rinj që përmbushin kërkesat e tregut të punës. Strategjia e kërkimit shkencor mbështetet në angazhimin e stafit akademik dhe administrativ, si dhe studentëve, dhe inkurajon një qasje aktive ndaj studimeve shkencore për zhvillimin e vendit dhe përmirësimin e profileve akademike.

TBU ka realizuar një integrim të suksesshëm të strategjisë së tij të kërkimit shkencor duke ndjekur prioritetet e përcaktuara në statut dhe duke siguruar një bashkëpunim të ngushtë mes departamenteve, QKSEJ dhe Zyrës së Projekteve dhe Ndërkombëtarizimit (ZPN). Duke i kushtuar një vëmendje të madhe zhvillimit të kërkimit shkencor dhe aktiviteteve të tij, TBU ka krijuar një kornizë të strukturuar për të mbështetur dhe inkurajuar angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore, si dhe ka siguruar financim dhe mbështetje administrative për realizimin e këtyre aktiviteteve.

---

[387] 3. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ 33.4.1. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.4.2. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 24-25; 33.5. Raporti Vjetor për Realizimin e Planit të Punës për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24; 33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni); 23.3.Kodi Etik i Kërkimit Shkencor në TBU.

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

TBU ka arritur të përmbushë standardet e kërkuara për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe mbështetjen e aktiviteteve kërkimore përmes një strategjie të qartë dhe të strukturuar. Duke u mbështetur në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2024-2029, TBU ka siguruar një infrastrukturë të fortë kërkimore dhe ka krijuar mundësi financimi për projekte kërkimore, siç dëshmohet nga aplikimet dhe fitimet e projekteve nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI). Po ashtu, universiteti ka një angazhim të dukshëm për bashkëpunim ndërkombëtar, përmes marrëveshjeve me institucione të njohura ndërkombëtare dhe pjesëmarrjes në projekte financuar nga Komisioni Europian dhe iniciativat e Erasmus+.

TBU ka arritur standardin e vlerësimit të performancës kërkimore dhe shkencore përmes një sistemi të strukturuar dhe objektiv, i cili integron disa qëllime të rëndësishme për zhvillimin e kërkimit dhe përmirësimin e cilësisë së tij. Përdorimi i indikatorëve të matjes së performancës në TBU ka mundësuar monitorimin e përparimit në fushat e kërkimit individual, projekteve kërkimore, bashkëpunimeve me partnerë të jashtëm dhe ekspertizës në sektorin profesional jashtë universitetit. Ky sistem bën të mundur orientimin dhe rritjen e cilësisë së performancës së pedagogëve, duke kontribuar në përmbushjen e detyrimeve shkencore dhe duke nxitur zhvillimin e kërkimit shkencor në përputhje me objektivat strategjikë të TBU. TBU ka implementuar një sistem të tillë që nxit zhvillimin e përhershëm të stafit akademik dhe kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, duke siguruar përmbushjen e standardeve të kërkuara.

TBU ka arritur standardin e garantimit të pronësisë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, duke zbatuar një kuadër të qartë dhe të strukturuar për menaxhimin e kësaj pronësie. Kodi Etik në Kërkimin Shkencor dhe rregullorja e Qendrës për Kërkime dhe Studime Ekonomike e Juridike (QKSEJ) përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat e studiuesve dhe kërkuesve shkencorë, duke siguruar që ata të përmbushin kërkesat ligjore, etike dhe profesionale. TBU ka krijuar kushte për mbrojtjen e pronësisë intelektuale përmes organizimit të aktiviteteve shkencore, përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore, dhe publikimit të rezultateve shkencore. Rregullat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në rregulloret e institucionit, si dhe angazhimi i tij për zhvillimin e kërkimit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, sigurojnë mbrojtjen dhe përdorimin e pronësisë intelektuale për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe financiar të universitetit, duke kontribuar në arritjen e këtij standardi.

TBU ka arritur standardin e kanalizimit të veprimtarive të kërkimit shkencor në nivel departamenti, duke zbatuar strategjinë dhe rregulloren e Qendrës për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike (QKSEJ). Çdo departament në TBU harton dhe implementon një plan të detajuar për kërkimin shkencor, i cili është në përputhje me vizionin dhe misionin e kërkimit shkencor të institucionit. Departamentet monitorojnë dhe vlerësojnë përparimin e kërkimit shkencor të pedagogëve përmes një sistemi raportimi dhe vlerësimi të performancës. Ky proces siguron një angazhim të madh të stafit në kërkimin shkencor, duke mbështetur krijimin e një mjedisi akademik që promovon lirinë akademike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Përmes respektimit të etikës dhe përdorimit të indikatorëve të matjes së performancës, TBU ka arritur të krijojë një sistem të mirë organizuar dhe të efektshëm për vlerësimin dhe nxitjen e kërkimit shkencor, duke kontribuar kështu në zhvillimin e tij kombëtar dhe rajonal.

TBU ka arritur të vendosë objektiva të qarta dhe të matshme për njësitë dhe grupet kërkimore, si dhe për personelin akademik. Korniza e Kërkimit Strategjik dhe objektivat e vendosura në

nivel departamenti janë në përputhje me vizionin e TBU për të promovuar kërkimin shkencor cilësor dhe të qëndrueshëm, duke siguruar lidhje efektive me shoqërinë dhe biznesin. Përdorimi i indikatorëve të matjes së performancës dhe respektimi i etikës shkencore ka siguruar që këto objektiva të realizohen në përputhje me standardet institucionale dhe ndërkombëtare.

TBU ka krijuar një strukturë të fortë dhe efektive për veprimtaritë e kërkimit shkencor, duke përfshirë QKSEJ. Strategjia kërkimore për periudhën 2024–2029 promovon gjithë përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë, duke mbështetur kërkimin shkencor dhe zhvillimin e aftësive profesionale. TBU ka garantuar një mjedis të përshtatshëm për angazhimin e të gjithë personelit dhe studentëve, duke siguruar mbështetje logjistike dhe mundësi për pjesëmarrje aktive në projekte kërkimore.

TBU ka krijuar një strukturë të konsoliduar dhe efektive për veprimtaritë kërkimore shkencore përmes QKSEJ, e cila koordinon dhe mbështet kërkimin në nivel institucional. TBU siguron që rezultatet e kërkimit shkencor të bëhen të njohura përmes raporteve vjetore, që pasqyrojnë kontributet e stafit dhe studentëve në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit. Angazhimi i departamenteve dhe raportimi i ecurisë së aktiviteteve kërkimore janë pjesë e një procesi të strukturuar dhe të mirë përcaktuar që siguron transparencë dhe përfshirje të gjithë komunitetit akademik.

TBU ka krijuar një kuadër të qartë dhe të strukturuar për ruajtjen e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, duke përfshirë një Kod Etike që rregullon sjelljen e papranueshme dhe masat disiplinore për shkelje. TBU mbështet integritetin e kërkimit shkencor duke organizuar trajnime dhe seminare për staf akademik dhe kërkues, si dhe përdor mekanizma dhe mjete që ndihmojnë në shmangien e konflikteve të interesit. Aktivitetet e organizuara, si seminari mbi përdorimin etik të mjeteve të inteligjencës artificiale në kërkimin shkencor, janë pjesë e angazhimit të TBU-së për të garantuar cilësinë e punimeve shkencore dhe ruajtjen e standardeve etike.

TBU angazhon dhe mbështet stafin akademik në kërkimin shkencor, duke e konsideruar atë si një pjesë thelbësore të zhvillimit profesional dhe akademik. Procesi i punësimit dhe vlerësimit të pedagogëve përfshin kriteret e kërkimit shkencor, ndërsa raportimi vjetor dhe ndjekja nga departamentet sigurojnë vijimësinë e angazhimit në këtë fushë. Për më tepër, TBU ka vendosur indikatorë të matjes së performancës në kërkim, duke e integruar atë në vlerësimin e përgjithshëm akademik dhe profesional të stafit.

TBU ka zgjeruar ndjeshëm rrjetëzimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar përmes programeve si Erasmus dhe marrëveshjeve akademike, duke forcuar reputacionin dhe pozicionimin e tij në nivel global. Institucioni ka promovuar kërkimin shkencor përmes platformave digjitale, konferencave dhe publikimeve, duke rritur aksesin dhe ndikimin e punimeve të stafit akademik. Përmes partneriteteve me universitete dhe qendra kërkimore brenda dhe jashtë vendit, TBU vijon të zhvillojë dhe mbështesë kërkimin, duke rritur vizibilitetin dhe ndikimin e tij në komunitetin akademik dhe atë të biznesit.

TBU ka ndërmarrë nisma për të forcuar bashkëpunimin akademik me diasporën dhe institucionet ndërkombëtare, duke nënshkruar marrëveshje strategjike si programi READ dhe CEEPUS. Këto iniciativa ofrojnë mundësi për financim projektesh, zhvillim kurrikulash dhe mobilitet akademik

për stafin dhe studentët. Ndërkohë, TBU po vijon punën për të zgjeruar marrëveshjet e shkëmbimit dhe për të lehtësuar mobilitetin në vitet e ardhshme.

TBU ka ndërtuar një bazë të fortë për mobilitetin akademik dhe studentor përmes partneriteteve strategjike dhe nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të angazhimit për ndërkombëtarizim, institucioni ka krijuar mundësi për shkëmbime akademike dhe programe të përbashkëta, duke përfituar edhe nga mbështetja e Balfin Group. Edhe pse gjatë vitit akademik 2023-2024 mobiliteti nuk u realizua për shkak të procesit të riorganizimit, TBU vijon të punojë për zgjerimin e bashkëpunimeve dhe lehtësimin e mundësive të mobilitetit në të ardhmen.

TBU ka një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme për kërkimin shkencor, duke mbështetur projekte kërkimore, zhvillimin e kapaciteteve akademike dhe bashkëpunimet ndërkombëtare. Institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë, si: organizimi i konferencave shkencore, nxitja e publikimeve akademike dhe aplikimi për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, duke integruar kërkimin me mësimdhënien dhe zhvillimin institucional. Përmes këtyre nismave dhe mekanizmave të matjes së performancës kërkimore, TBU siguron rritjen e ndikimit dhe vijueshmërinë në fushën e kërkimit shkencor.

TBU ka zhvilluar një mjedis kërkimor aktiv, duke organizuar konferenca dhe botuar studime shkencore, ndërsa siguron respektimin e pronësisë intelektuale. Si pjesë e Balfin Group, institucioni ka forcuar lidhjet me industrinë, ka përfituar mbështetje financiare dhe ka harmonizuar programet akademike me kërkesat e tregut të punës. Përmes ristrukturimit në dy fakultete kryesore, TBU ka rritur efikasitetin dhe ka krijuar një profil unik në fushën e arsimit të lartë.

TBU ka krijuar një kuadër të qartë etik dhe rregullator për kërkimin shkencor, duke siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale të arritjeve akademike. Përmes QKSEJ, institucioni koordinon dhe mbështet veprimtarinë kërkimore, duke garantuar standardet profesionale dhe ligjore. Gjithashtu, TBU dokumenton dhe monitoron kontributet shkencore të stafit për qëllime raportimi dhe matjeje të performancës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Standardet e **Fushës së vlerësimit: "Aktiviteti Shkencor / Artistik dhe Inovacioni" janë përmbushur plotësisht.**

## V – STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| |
|---|
| **Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve.** |
| Aplikimet për studimet Bachelor dhe Master në TBU bëhen brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ndërsa përzgjedhja e kandidatëve bazohet në kritere të përgjithshme dhe të posaçme për çdo program. Kriteret e përgjithshme përcaktohen nga ligji, ndërsa ato të posaçmet vendosen në rregulloren përkatëse ose nga Senati Akademik. TBU mund të kufizojë numrin e studentëve të pranuar, duke shpallur fitues ata që plotësojnë kriteret e kërkuara dhe renditen më mirë.[388] Departamenti është përgjegjës për përcaktimin e numrit të studentëve që do të pranohen në secilin program. Përveç kësaj, departamenti përcakton kriteret e pranimit për çdo program studimi dhe kryen përzgjedhjen e studentëve fitues.[389] Lista përfundimtare e kandidatëve të pranuar miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore, në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregulloren përkatëse. Kandidati i përzgjedhur fiton statusin e studentit vetëm pasi të regjistrohet brenda afatit në Sekretarinë Mësimore, duke dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm dhe duke shlyer tarifën e regjistrimit. Studentët nga universitete të tjera mund të transferohen në TBU vetëm nëse përmbushin kriteret përkatëse të përcaktuara nga rregullorja. Çdo person që ka përfunduar maturën shtetërore dhe plotëson kriterin e notës mesatare mund të aplikojë për studime në Fakultetin e Biznesit dhe Drejtësisë dhe në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit të TBU-së.[390] Ky institucion pranon si studentë shqiptarë ashtu edhe të huaj, përfshirë ata që ndjekin studimet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare. Studentët që kanë përfunduar një program studimi në ciklin e parë kanë mundësinë të ndjekin një tjetër program brenda të njëjtit cikël ose në një fushë të afërt, në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloret akademike të institucionit. Procesi i aplikimit për një program të dytë zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga institucionet përkatëse të arsimit të lartë.<br>Për studimet e ciklit të dytë, aplikantët duhet të kenë përfunduar një program të ciklit të parë dhe të plotësojnë kriteret akademike të miratuara nga Senati Akademik. Pranimi në programet e studimeve të ciklit të dytë është i hapur për aplikantë vendas dhe ndërkombëtarë që kanë përfunduar studimet e tyre të nivelit të parë në institucione të akredituara nga autoritetet përkatëse të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit. Kandidatët që kanë |

[388] 3.3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 30. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU); 13.17. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ba AB-IE-IS-IK.

[389] 4.1. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD); 4.2. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë (FBD); 4.3. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI); 4.4. Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike (FTI); 4.5. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike (FTI); 30.Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU); 13.17.Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ba AB-IE-IS-IK.

[390] 3. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 3.1. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë; 30.Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU); 13.17. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ba AB-IE-IS-IK.



TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

përfunduar studimet jashtë vendit duhet të ndjekin procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të diplomës pranë institucioneve përgjegjëse. Kriteret e pranimit propozohen nga struktura akademike përgjegjëse për programin dhe miratohen nga organet drejtuese përpara fillimit të vitit akademik. Përzgjedhja e studentëve bazohet në parimet e transparencës, barazisë dhe meritokracisë, duke u vlerësuar tërësisht treguesit akademikë dhe profesionalë të secilit kandidat.

TBU ofron gjithashtu mundësi transferimi të studentëve midis programeve të tij, ose nga/drejt institucioneve të tjera të arsimit të lartë, duke njohur kreditet e fituara sipas rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi.

Rregullorja e çdo programi studimi është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë. Ajo bazohet në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë akademike dhe kërkimore brenda një programi studimi, si dhe në dispozitat e statutit dhe rregullores së institucionit përkatës. Përveç kësaj, rregullorja reflekton praktikat e vendosura në zhvillimin e studimeve universitare, duke siguruar cilësi dhe përputhshmëri me standardet arsimore. [391]

Institucioni ka zbatuar një strategji të gjerë marketingu për të promovuar programet e tij të studimit, duke përdorur një qasje të shumëfishtë për të arritur një audiencë të gjerë dhe të synuar. Një nga metodat kryesore është marketingu digjital, ku informacionet dhe aktivitetet promovohen në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale si LinkedIn, Facebook, Instagram dhe YouTube. Përveç kësaj, institucionit është i pranishëm në media dhe portale të njohura për të rritur shikueshmërinë dhe angazhimin e audiencës. Institucioni investon gjithashtu në evente dhe aktivitete promovuese, trajnime dhe aktivitete formuese etj., duke siguruar një prezencë të qëndrueshme dhe të fuqishme në tregun arsimor, duke tërhequr vazhdimisht studentë të rinj.[392]

**Standardi V.2 Institucioni u ofron mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre.**

Institucioni ka ngritur Komisionin e Marrëdhënieve me Studentët (KMS) për të siguruar një mbështetje të vazhdueshme dhe efektive për studentët në nivel institucional dhe atë të fakulteteve. Ky komision është përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve që synojnë përmirësimin e përvojës akademike dhe profesionale të studentëve, duke u ofruar atyre një platformë për komunikim të hapur dhe përfaqësim efektiv.[393]

---

[391] 26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"; 26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS; 26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS; 26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; 26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike; 26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software; 26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike; 26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software.

[392] 12.Politika e Marketingut për Programet e Studimit; https://tbu.edu.al/.

[393] 1.Statuti TBU; 1.1. Organigrama e re me vulën e MAS; 32.4.1.Plan i KMS 23-24 TBU; Relacion i KMS 23-24 TBU; 32.4.3.Plan i KMS 24-25 TBU; 32.4.4. Plan i KMS 23-24 FTI; 32.4.5. Relacion i KMS 23-24 FTI; 32.4.6. Plan i KMS 24-25 FTI; 32.4.7. Plan i KMS 23-24 FBD; 32.4.8. Relacion i KMS 23-24 FBD;32.4.9.Plan i KMS 24-25 FBD.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, KMS ka organizuar një sërë mbledhjesh dhe takimesh me përfaqësues studentorë për të adresuar çështjet e ngritura, për të ofruar këshillim dhe për të garantuar përfshirjen aktive të studentëve në jetën akademike dhe sociale. Përmes këtyre strukturave, studentët kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në sesione informuese, diskutime mbi përmirësimin e shërbimeve dhe aktivitete që nxisin angazhimin e tyre në fusha të ndryshme.

Gjithashtu, komisioni ka mbikëqyrur respektimin e Kodit të Etikës dhe ka organizuar vlerësime të vazhdueshme për të siguruar një mjedis akademik të përshtatshëm. Përveç kësaj, janë zhvilluar edhe aktivitete për nxitjen e punësimit dhe sipërmarrjes, duke krijuar mundësi për studentët që të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike dhe të ndërtojnë një rrjet profesional. Në këtë kuadër, KMS ka bashkëpunuar ngushtë me Zyrën e Karrierës dhe Çështjeve Studentore për të mbështetur studentët në orientimin e tyre profesional dhe për të lehtësuar kalimin e tyre në tregun e punës.[394]

Në përfundim të vitit akademik, KMS ka realizuar një vlerësim të objektivave të arritura, duke analizuar ndikimin e aktiviteteve të zhvilluara dhe duke marrë në konsideratë sugjerimet e studentëve për të përmirësuar më tej angazhimin dhe shërbimet e ofruara. Ky angazhim i vazhdueshëm synon të garantojë një përvojë të pasur akademike dhe profesionale për të gjithë studentët e institucionit.

Gjithashtu Zyra e Çështjeve Studentore në TBU ka për synim të ndihmojë studentët të zhvillojnë potencialin e tyre profesional dhe të përgatiten sa më mirë për tregun e punës. Përmes këshillimit dhe mbështetjes së vazhdueshme, kjo zyrë u ofron studentëve mundësi për punësim, ndërtimin e rrjeteve profesionale dhe përfshirjen në aktivitete që forcojnë aftësitë e tyre. [395] TBU është i angazhuar në ofrimin e një mbështetjeje të gjithanshme për studentët, duke iu mundësuar atyre zhvillim akademik dhe profesional. Këshillimi dhe orientimi profesional ndihmojnë studentët në përgatitjen për karrierën e tyre, ndërsa ndërlidhja me tregun e punës realizohet përmes krijimit të kontakteve me punëdhënësit dhe organizimit të praktikave profesionale[396]. Gjithashtu, trajnime dhe *workshop*-e organizohen rregullisht për të zhvilluar aftësi të reja dhe për të rritur nivelin e kompetencës profesionale. Takimet dhe eventet e hapura u japin mundësinë studentëve të komunikojnë me profesionistë të fushave të ndryshme dhe të përfitojnë nga përvoja e tyre, ndërsa rrjeti Alumni mundëson ndarjen e eksperiencave dhe krijimin e bashkëpunimeve mes të diplomuarve dhe studentëve aktualë[397]. Panairi i Karrierës shërben si një platformë e rëndësishme ku studentët njihen me mundësitë e punësimit, praktikave dhe bursave. Në bashkëpunim me sektorin e Burimeve Njerëzore të Grupit Balfin dhe partnerë të tjerë, Zyra

---

[394] 32.4.1.Plan i KMS 23-24 TBU; Relacion i KMS 23-24 TBU; 32.4.3.Plan i KMS 24-25 TBU; 32.4.4. Plan i KMS 23-24 FTI; 32.4.5. Relacion i KMS 23-24 FTI; 32.4.6. Plan i KMS 24-25 FTI; 32.4.7. Plan i KMS 23-24 FBD; 32.4.8. Relacion i KMS 23-24 FBD;32.4.9.Plan i KMS 24-25 FBD; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.4.1. Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj.

[395] 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.4.1. Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj.

[396] 36.Rrregullore e Këshillimit Akademik; 36.1. Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI.

[397] 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët ; 38.3. Ditët informuese në TBU; https://tbu.edu.al/tbu-post/.

e Çështjeve Studentore u lehtëson studentëve aksesin në mundësi konkrete për punësim dhe zhvillim profesional, duke i ndihmuar të bëhen më konkurrues në tregun e punës[398].

**Standardi V.3 Institucioni përdor sistem efikas informimi për studentët.**

TBU përdor një sistem efikas informimi për studentët dhe kandidatët potencialë, duke kombinuar strategji të avancuara të marketingut dhe komunikimit. Universiteti siguron akses të gjerë në informacion përmes platformave digjitale, medias tradicionale, eventeve dhe aktiviteteve të dedikuara.[399]
Përmes kanaleve zyrtare në media sociale, si Facebook, Instagram, LinkedIn dhe YouTube, TBU publikon rregullisht lajme dhe njoftime të rëndësishme, duke ofruar përmbajtje të strukturuar dhe vizualisht tërheqëse. Një strategji e integruar e marketingut dixhital dhe partneritetet me media dhe portale të njohura ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për programet e studimit dhe mundësitë e ofruara.[400]
Një aspekt tjetër kyç i strategjisë së informimit është angazhimi i drejtpërdrejtë përmes eventeve dhe aktiviteteve formuese. Universiteti organizon konkurse kombëtare për maturantët, si "Sipërmarrësit e së Nesërmes" dhe "TECHnovators", që jo vetëm orientojnë të rinjtë drejt karrierave në biznes dhe teknologji, por edhe ofrojnë bursa studimi për talentet më të spikatura. Gjithashtu, TBU është pjesë e aktiviteteve të këshillimit të karrierës dhe panaireve, si: WORK&STUDY, ku studentët mund të marrin informacion të drejtpërdrejtë mbi mundësitë e studimit dhe punësimit[401].
Në mbështetje të informimit të studentëve, TBU zhvillon trajnime të dedikuara nga pedagogë me eksperiencë në fusha si komunikimi, inteligjenca artificiale dhe sipërmarrja. Këto aktivitete ndihmojnë maturantët dhe studentët e rinj të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të njihen më nga afër me universitetin. Përmes partneriteteve me mbi 150 kompani, universiteti jo vetëm që informon studentët mbi ofertën akademike, por edhe u siguron atyre mundësi reale për zhvillim profesional.
TBU ka zbatuar një sistem të avancuar dhe efikas të informimit për studentët, duke përdorur platforma të ndryshme teknologjike. Përmes Sistemit të Menaxhimit të Mësimit (LMS) të bazuar në Moodle, studentët kanë akses të vazhdueshëm në materialet e kurseve, mund të marrin pjesë në diskutime, të dorëzojnë detyra dhe të ndjekin progresin e tyre akademik në mënyrë të strukturuar.[402] Përveç kësaj, përdorimi i Office 365 dhe SharePoint mundëson një komunikim dhe bashkëpunim efektiv midis studentëve dhe stafit akademik, duke ofruar një

[398] 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.5.Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse); 35.Raporti Vjetor TBU 23-24; https://tbu.edu.al/zhvillohet-ne-tbu-panairi-i-karrieres-qindra-studente-takojne-boten-e-biznesit/.

[399] 12.Politika e Marketingut për Programet e Studimit; 38.3. Ditët informuese në TBU; https://tbu.edu.al/

[400] Aneks 12. Politika e Marketingut per Programet e Studimit.

[401] 34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.4.1. Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj; https://tbu.edu.al/zhvillohet-ne-tbu-panairi-i-karrieres-qindra-studente-takojne-boten-e-biznesit/ ; https://tbu.edu.al/studentet/#klube-konkurse.

[402] 21.1.Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.

| |
|---|
| hapësirë të centralizuar për dokumentet dhe informacionin. Gjithashtu, infrastruktura e internetit dhe pajisjet kompjuterike moderne sigurojnë një përvojë të qëndrueshme dhe të aksesueshme për të gjithë përdoruesit, duke rritur ndjeshëm efikasitetin e mësimdhënies dhe menaxhimit akademik.[403]<br>Përmes këtyre mekanizmave, TBU siguron që studentët të kenë gjithmonë informacion të përditësuar, të saktë dhe të lehtë për t'u aksesuar. |
| **Standardi V.4 Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.**<br><br>Institucioni inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në jetën institucionale përmes Këshillit Studentor të TBU-së (KSTBU), duke marrë pjesë në komisionet e përhershme dhe në Senatin Akademik[404]. Këto struktura ofrojnë një platformë demokratike ku studentët mund të shprehin shqetësimet dhe nevojat e tyre, të angazhohen në proceset vendimmarrëse dhe të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit akademik dhe social.<br>NJSBC ka për qëllim përmirësimin e cilësisë në institucionin arsimor, përmes aplikimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe përputhjes me standardet e kërkuara nga ligji dhe udhëzimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Një ndër objektivat kryesore është edhe angazhimi i studentëve në proceset e menaxhimit të cilësisë, duke përfshirë ata si pjesëmarrës aktivë në zhvillimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të ndryshme që lidhen me cilësinë e arsimit të ofruar.[405]<br>NJSBC ka një strukturë që përfshin përfaqësues të studentëve, të cilët janë të ftuar të kontribuojnë në proceset e vlerësimit dhe menaxhimit të cilësisë. Pjesëmarrësit e studentëve janë të rëndësishëm për të reflektuar nevojat dhe kërkesat e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit arsimor. Ky angazhim është thelbësor për krijimin e një ambienti ku komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet studentëve dhe stafit akademik mundësojnë një zhvillim më të mirë të institucioneve të arsimit të lartë. Po ashtu, proceset e sigurimit të cilësisë janë të dizajnuara në mënyrë që të përfshijnë të gjithë aktorët e përfshirë, përfshirë studentët, si një element kyç për arritjen e objektivave të institucionit. Kjo qasje synon krijimin e një kulture të cilësisë që përfshin të gjithë palët e interesuara dhe e ndihmon institucionin të përmbushë kërkesat e shoqërisë dhe tregut të punës. Kjo pjesëmarrje aktive e studentëve është një aspekt i rëndësishëm që ndihmon në përmirësimin e përvojës së tyre akademike dhe, në të njëjtën kohë, kontribuon në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe programeve të arsimit të lartë.<br>Roli i një studenti si anëtar i NjSBC është thelbësor, pasi ai përfaqëson zërin dhe interesat e komunitetit studentor në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. |

[403] 21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU.

[404] 32.3. Rregullore e Këshillit Studentor; 32.3.1. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25; 32.3.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25;13.3.Procedura e zgjedhjes të Senatit; 13.7. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 13.8.1. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë TBU_ 24; 13.8.2. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FBD_ 24; 13.8.3. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FTI_ 24; 13.9.1. Procedura e përzgjedhjes së KMS_TBU_24; 13.9.2.Procedura e përzgjedhjes së KMS_FBD_24; 13.9.3. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FTI_24; 13.10. Përzgjedhja e Komisionit të Etikës.

[405] 13.7. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 24.1.Rregullore NJSBC.

Studenti kontribuon në diskutimet dhe analizat që lidhen me metodat pedagogjike, efektivitetin e kurrikulave dhe shërbimet mbështetëse, duke dhënë sugjerime konkrete për përmirësime. Përmes këtij angazhimi, studenti ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e politikave të cilësisë dhe në krijimin e një mjedisi akademik më efikas dhe të përshtatshëm për nevojat e studentëve.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i punës së NJSBC është hartimi dhe administrimi i pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve nga studentët. Ato janë një mjet kyç për matjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi ofrojnë një vlerësim objektiv mbi metodologjinë, angazhimin dhe efikasitetin e pedagogëve në procesin mësimor. Plotësimi i tyre nga studentët duke ruajtur anonimatin është një detyrë e rëndësishme dhe një e drejtë e tyre, sepse ndihmon në identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim dhe në forcimin e një kulture akademike të bazuar në standarde të larta dhe transparencë. Për këtë arsye, angazhimi i studentëve në këtë proces është vendimtar për rritjen e cilësisë së arsimit dhe për krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional[406].

Nga ana tjetër përmes KSTBU-së, studentët inkurajohen të zhvillojnë aftësitë e tyre organizative dhe drejtuese, të marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore dhe të bashkëpunojnë me organet drejtuese të fakultetit për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.[407] Ndërkohë, Senati Studentor, i përbërë nga përfaqësues të zgjedhur në mënyrë demokratike, ka një rol kyç në vendimmarrjen institucionale duke adresuar çështje që lidhen me planet dhe programet e studimit, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive.[408]

Procesi transparent dhe gjithëpërfshirës i zgjedhjeve për këto struktura, përmes votimit të fshehtë dhe pjesëmarrjes së gjerë të studentëve, garanton një përfaqësim të drejtë dhe të balancuar të interesave të tyre. Për më tepër, përfshirja e përfaqësuesve të Këshillit Studentor në Senatin Akademik të kolegjit tregon angazhimin e institucionit për të integruar zërin e studentëve në vendimmarrjen e përgjithshme dhe për të ndërtuar një kulturë akademike të bazuar në bashkëpunim dhe përfaqësim aktiv.[409]

---

[406] 24.1. Relacion i NJSBC 2023-2024; 24.5.Njoftim për studentët për zhvillimin e pyetësorit; 24.5.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve.

[407] 32.3.Rregullore e Këshillit Studentor; 32.3.1. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25; 32.3.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.4.1. Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj; 38.3. Ditët informuese në TBU; https://tbu.edu.al/; 38.2.Aktivitete akademike & sociale për studentët.

[408] 32.3.1. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25; 32.3.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25.

[409] 13.3.Procedura e zgjedhjes të Senatit; 13.7. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 13.8.1. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë TBU_ 24; 13.8.2. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FBD_ 24; 13.8.3. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FTI_ 24; 13.9.1. Procedura e përzgjedhjes së KMS_TBU_24; 13.9.2.Procedura e përzgjedhjes së KMS_FBD_24; 13.9.3. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FTI_24; 13.10. Përzgjedhja e Komisionit të Etikës; 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 13.3.Procedura e zgjedhjes të Senatit; 32.3.1. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25; 32.3.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25.

**Standardi V.5 Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.**

Institucioni ndjek një politikë të qartë të orientimit dhe këshillimit të studentëve përmes Zyrës së Çështjeve Studentore, e cila ka një rol kyç në përgatitjen e tyre për tregun e punës. Kjo zyrë ofron shërbime si këshillimi i karrierës, organizimi i *workshop*-eve dhe trajnimeve, si dhe mundësimin e praktikave profesionale dhe punësimit të pjesshëm. Përmes bashkëpunimeve me sektorin publik dhe privat, ajo ndihmon studentët në krijimin e lidhjeve me punëdhënësit potencialë. Gjithashtu, organizimi i panaireve të punës dhe rrjeti Alumni kontribuojnë në mbështetjen e studentëve dhe të diplomuarve në zhvillimin profesional dhe integrimin në tregun e punës.[410]

TBU ndjek një politikë të qartë për orientimin dhe këshillimin e studentëve përmes KSTBU-së. Ky organ ka si qëllim trajtimin e shqetësimeve të studentëve, informimin dhe mbështetjen e tyre në çështje akademike dhe administrative, si dhe zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore që kontribuojnë në formimin e tyre profesional dhe social. Përmes strukturave të tij, KSTBU bashkëpunon ngushtë me organet drejtuese të fakulteteve për përmirësimin e cilësisë mësimore dhe kërkimore, organizon zgjedhje transparente për përfaqësuesit studentorë dhe ndihmon në forcimin e lidhjeve midis studentëve brenda dhe jashtë institucionit. Përfaqësimi i studentëve në Senatin Akademik të universitetit siguron që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh në vendimmarrje.[411]

TBU ndjek një politikë të qartë dhe të strukturuar për orientimin dhe këshillimin e studentëve, duke e konsideruar këtë mbështetje si një element thelbësor për suksesin e tyre akademik dhe profesional. Institucioni ka të përcaktuar këshilltarë akademikë për çdo fakultet, të cilët luajnë një rol kyç në mentorimin, orientimin akademik dhe zhvillimin e karrierës së studentëve.

Rregullorja për këshillimin akademik siguron një komunikim të hapur mes studentëve dhe këshilltarëve, duke ndihmuar studentët në hartimin e planeve të studimit, përgatitjen për tregun e punës dhe kapërcimin e sfidave akademike. Këshilltarët akademikë gjithashtu informojnë studentët mbi rregulloret, ndryshimet në kurrikul, mundësitë e mobilitetit dhe programet e shkëmbimit[412].

Përveç kësaj, TBU vendos procedura të qarta për organizimin e takimeve, monitorimin e progresit dhe ofrimin e mbështetjes individuale për çdo student. Ky angazhim i institucionit synon të krijojë një mjedis akademik gjithëpërfshirës dhe inkurajues, duke ndihmuar studentët të arrijnë potencialin e tyre maksimal.[413]

Plani i punës i Këshilltarit Akademik dëshmon qartë angazhimin e institucionit për orientimin dhe këshillimin e studentëve. Ky plan përfshin strategji dhe aktivitete të detajuara

---

[410] 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.4.1. Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj; 38.3. Ditët informuese në TBU; https://tbu.edu.al/; 38.2.Aktivitete akademike & sociale për studentët; https://tbu.edu.al/zhvillohet-ne-tbu-panairi-i-karrieres-qindra-studente-takojne-boten-e-biznesit/.

[411] 32.3. Rregullore e Këshillit Studentor; 32.3.1. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25; 32.3.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25; 13.3.Procedura e zgjedhjes të Senatit; 13.7. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 13.8.1. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë TBU_ 24; 13.8.2. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FBD_ 24; 13.8.3. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FTI_ 24; 13.9.1. Procedura e përzgjedhjes së KMS_TBU_24; 13.9.2.Procedura e përzgjedhjes së KMS_FBD_24; 13.9.3. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FTI_24; 13.10. Përzgjedhja e Komisionit të Etikës.

[412] 36. Rrregullore e Këshillimit Akademik; 36.1.Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI.

[413] 36. Rrregullore e Këshillimit Akademik; 36.1.Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI.

| |
|---|
| për të mbështetur studentët në çdo hap të udhëtimit të tyre akademik, duke filluar nga periudha e orientimit, asistenca për rregulloret dhe programet e studimit, deri te monitorimi i progresit akademik dhe përgatitja për tregun e punës. Përmes këtyre iniciativave, institucioni synon të krijojë një sistem mbështetës të qëndrueshëm, i cili ndihmon studentët të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të arrijnë sukses akademik dhe profesional.[414] |
| **Standardi V.6 Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta dhe aktivitete jashtëkurrikulare.** |
| TBU ndjek një politikë mbështetëse gjithëpërfshirëse, duke krijuar mundësi të shumta për studentët që të zhvillohen si në aspektin akademik, ashtu edhe në atë personal dhe profesional. Institucioni promovon një mjedis të favorshëm për integrimin dhe përparimin e të gjithë studentëve, duke ofruar mbështetje të posaçme për kategori të veçanta dhe duke nxitur pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme[415].<br>Në këtë kuadër, TBU organizon një sërë veprimtarish artistike, kulturore, sportive dhe sociale, të cilat u mundësojnë studentëve të angazhohen në nisma që përmirësojnë aftësitë e tyre dhe krijojnë një frymë bashkëpunimi e solidariteti. Institucioni inkurajon dhe mbështet studentët që të marrin pjesë në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca, debate dhe aktivitete mediatike, duke u ofruar mbështetje logjistike dhe financiare për të përfaqësuar universitetin në këto evente.[416]<br>Për të garantuar një përvojë të pasur studentore, TBU mbështet krijimin e klubeve dhe grupeve studentore si Entrepreneurs Club, Innovation Club, Green Club, Book Club, Debating Club dhe Sports Club, të cilat u japin studentëve mundësinë të zhvillojnë pasionet dhe aftësitë e tyre. Po ashtu, institucioni investon në krijimin e ekipeve sportive dhe promovon aktivitetin fizik përmes pjesëmarrjes në gara dhe kampionate universitare[417].<br>Nëpërmjet KSTBU-së, studentët marrin pjesë aktive në vendimmarrje dhe organizimin e aktiviteteve, duke krijuar një mjedis më të hapur dhe gjithëpërfshirës. TBU synon të lehtësojë qasjen e studentëve në burime të reja mësimore dhe trajnime, duke ndihmuar në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm.<br>Në këtë mënyrë, përmes politikave të tij mbështetëse, TBU jo vetëm që forcon përfshirjen e studentëve nga kategori të ndryshme sociale, por edhe krijon një mjedis të favorshëm për zhvillimin e tyre të gjithanshëm.<br>TBU ndjek një politikë të qartë mbështetëse për kategori të veçanta sociale dhe aktivitete me ndikim të gjerë shoqëror përmes partneriteteve strategjike dhe angazhimit të tij të vazhdueshëm në projekte edukative dhe zhvillimore. Bashkëpunimi me organizata të rëndësishme si BALFIN Group, Deutsche Sparkassenstiftung, AADF, Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjera vendase e ndërkombëtare siguron trajnime, praktika pune dhe |

[414] 36. Rrregullore e Këshillimit Akademik; 36.1.Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI.
[415] 32.7.Skema e bursave sociale në TBU ;34.4.1.Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj; 32.1. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025; 32.2. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite
[416] 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët; https://tbu.edu.al/tbu-post/.
[417] 35.Raporti Vjetor TBU 23-24, Pika 7.2; https://tbu.edu.al/studentet/#klube-konkurse.



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

mundësi për zhvillimin profesional të studentëve, veçanërisht atyre që kanë më shumë nevojë për mbështetje.[418]
Në kuadër të përgjegjësisë sociale, TBU organizon aktivitete ekstrakurrikulare dhe konkurse për të rinjtë në fusha si: sipërmarrja dhe teknologjia, duke nxitur përfshirjen dhe inovacionin. Gjithashtu, universiteti mbështet studentët e tij në zhvillimin e bizneseve të tyre përmes inkubatorëve të posaçëm, këshillimit të karrierës dhe rrjeteve të mentorimit me profesionistë të njohur[419].
Në bashkëpunim me institucione publike dhe kompani private, TBU krijon mundësi për studentët që të ndjekin praktika profesionale dhe të integrohen në tregun e punës, duke synuar që talentet më të spikatura të gjejnë mbështetje për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Për më tepër, përmes botimeve dhe organizimit të forumeve akademike e shkencore, universiteti kontribuon në avancimin e kërkimit dhe dijes, duke u bërë një qendër e rëndësishme për zhvillimin e mendimit kritik dhe inovacionit në Shqipëri[420].
Në këtë mënyrë, TBU jo vetëm që garanton një arsim cilësor, por edhe ndihmon në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe mbështetës për kategori të ndryshme sociale, duke i pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në të ardhmen.
TBU ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta, duke ofruar bursa dhe ulje tarifash për studentët në nevojë. Institucioni ofron bursa sociale për studentët nga shtresat vulnerabël, si jetimët, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet rom dhe ballkano-egjiptiane, si dhe për familjet me vështirësi ekonomike, bazuar në dokumentacionin përkatës[421]. Gjithashtu, ofrohen bursa të ekselencës për studentët me rezultate të larta në shkollën e mesme, si dhe bursa të mbështetura nga kompani për studentët e programeve Bachelor. Këto masa tregojnë përkushtimin e institucionit për të garantuar akses dhe mundësi të barabarta për të gjithë studentët, duke lehtësuar përballimin e kostove të studimeve dhe duke inkurajuar performancën akademike.[422]

**Standardi V.7 Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët.**

Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët përmes aksesit në burime akademike të njohura. Biblioteka online EBSCO, e cila ka qenë e disponueshme për studentët e TBU deri në dhjetor 2022, ka siguruar qasje në artikuj shkencorë, revista, libra dhe materiale kërkimore nga fusha të ndryshme studimi. Aktualisht, institucioni po punon për të rinovuar këtë shërbim për vitin akademik 2024-2025 dhe po shqyrton mundësinë e abonimit në bazën e të dhënave Scopus Research. Këto iniciativa dëshmojnë angazhimin e

418 7.Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029; 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët; https://tbu.edu.al/tbu-post/; 32.5.Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23; 32.6.Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25.

419 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët; https://tbu.edu.al/tbu-post/; https://tbu.edu.al/studentet/#klube-konkurse.

420 34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU; 34.5. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse).

421 32.7. Skema e bursave sociale në TBU.

422 32.1.Tarifat dhe bursat VA 2024-2025; 32.2.Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite; 13.18. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 23-24.

| |
|---|
| institucionit për të mbështetur studentët me literaturë cilësore dhe të përditësuar, duke lehtësuar procesin e tyre akademik dhe kërkimor.[423]<br>Gjithashtu në çdo program lëndor të ofruar nga institucioni, përcaktohet qartë literatura që studentët duhet të ndjekin gjatë studimeve të tyre. Silabuset e të gjitha lëndëve përmbajnë një listë të detajuar të burimeve kryesore, ku përfshihet literatura bazë, e cila shërben si referenca kryesore për kuptimin e koncepteve themelore të lëndës, si dhe literatura ndihmëse, e cila ofron informacion shtesë për të zgjeruar njohuritë dhe për të thelluar të kuptuarit e tematikave specifike. Kjo qasje siguron që studentët të kenë një drejtim të qartë në procesin e tyre akademik, duke i ndihmuar të fokusohen në materialet më të rëndësishme dhe të besueshme për përvetësimin e njohurive. Përveç teksteve tradicionale, literatura e rekomanduar mund të përfshijë edhe artikuj shkencorë, studime të fundit, burime online dhe databaza akademike, të cilat mundësojnë një qasje më të gjerë ndaj informacionit të përditësuar dhe të specializuar. Kështu, institucioni siguron një strukturë të mirëorganizuar të burimeve akademike, e cila i udhëzon studentët në zhvillimin e një metodologjie efektive studimi dhe kërkimi. [424] |
| **Standardi V.8 Institucioni favorizon punësimin e studentëve.** |
| Në misionin dhe vizionin e tij, universiteti ka një angazhim të qartë për të ndihmuar në zhvillimin e studentëve dhe në përgatitjen e tyre për tregun ndërkombëtar të punës. Ky angazhim për punësimin e studentëve shprehet në mbështetje të mobilitetit ndërkombëtar dhe mundësive për shkëmbime, si dhe përmes bashkëpunimeve me universitete dhe institucione të tjera, që ofrojnë mundësi punësimi dhe trajnimi për studentët. Gjithashtu, universiteti promovon zhvillimin e programeve të studimit që janë të njohura ndërkombëtarisht, si dhe mbështet projekte dhe mundësi që ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe profesionale, duke i forcuar mundësitë e tyre për punësim.[425]Institucioni favorizon punësimin e studentëve duke ofruar mundësi për zhvillimin e praktikave mësimore në bashkëpunim me kompani dhe institucione të ndryshme. Zyra e Karrierës merr përsipër organizimin e akomodimit të studentëve në kompani për praktika, duke përfshirë edhe mundësi punësimi për ata që janë të angazhuar në pozita që lidhen me profilin e studimeve. Gjithashtu, studentët mund të propozojnë vetë vendet e praktikës dhe të shfrytëzojnë mundësi të tjera, siç janë intership-et ose pozitat e punës në bizneset dhe organizatat përkatëse. Kjo mbështetje synon lehtësimin e kalimit të studentëve nga akademia në tregun e punës.[426]<br>Memorandumi i Bashkëpunimit i TBU-së synon të krijojë një lidhje të fortë mes universitetit dhe kompanive, duke favorizuar punësimin dhe zhvillimin profesional të studentëve. Përmes këtij bashkëpunimi, studentët përfitojnë mundësi të shumta, si praktika profesionale, |

[423] 21.2. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, Pika 7.
[424] 37. Rregullore e Bibliotekës; 37.1. Database Biblioteka 23-24.
[425] 34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve; 34.1.Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi.
[426] 34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 34.5. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse); 13.19.Vendimet për përcaktimin e Pedagogut/pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD; 13.19.1.Vendimet për përcaktimin e Pedagogut/pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI; 34.3.Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU.

punësim i pjesshëm apo i plotë, marrëveshje individuale për angazhim dhe mbështetje financiare, si dhe seminare nga drejtues të bizneseve. Gjithashtu, memorandumi përfshin shërbime kërkimore dhe konsulence, duke mundësuar një shkëmbim të vlefshëm njohurish mes akademisë dhe industrisë. Këto nisma synojnë jo vetëm të ndihmojnë studentët të fitojnë përvojë praktike, por edhe të lehtësojnë integrimin e tyre në tregun e punës.[427]

TBU ka krijuar një rrjet të gjerë partneritetesh me kompani dhe institucione të ndryshme, duke synuar të lehtësojë integrimin e studentëve në tregun e punës. Bashkëpunimi me kompani prestigjioze si BALFIN Group, bankat kryesore në Shqipëri (Tirana Bank, Raiffeisen Bank, OTP Bank, etj.), si dhe organizata si Albanian Microfinance Association, ofron studentëve mundësi të shumta për punësim dhe zhvillim profesional.

Nëpërmjet këtyre partneriteteve, studentët e TBU-së kanë akses në:

- **Praktika profesionale** në kompani të ndryshme, duke u mundësuar atyre të fitojnë përvojë praktike në sektorët përkatës.
- **Trajnime dhe seminare** të organizuara nga profesionistë të fushës, që i ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për tregun e punës.
- **Përfshirje në projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore**, duke u dhënë atyre mundësinë të zbatojnë njohuritë akademike në projekte reale.
- **Mundësi punësimi për studentët më të mirë**, duke i identifikuar ata përmes këtyre bashkëpunimeve dhe duke i rekrutuar në kompani partnere.
- **Rrjetëzimi dhe mentorimi nga profesionistë dhe drejtues të njohur të biznesit**, që u shërben studentëve për të ndërtuar një karrierë të suksesshme.

TBU synon të mbështesë studentët edhe përtej viteve akademike, duke krijuar një "rrjet partnerësh ekzekutivë" deri në vitin 2025, i cili do të përfshijë biznesmenë, menaxherë dhe ekspertë të fushave të ndryshme që do të ofrojnë udhëzime dhe mbështetje për studentët në zhvillimin e tyre profesional.[428] Për më tepër, institucioni ka një angazhim të fortë në zhvillimin e sipërmarrjes dhe inovacionit tek studentët, duke ofruar inkubator biznesi dhe organizuar konkurse kombëtare si: **"Sipërmarrësit e së Nesërmes"** dhe **"TECHnovators"**. Këto iniciativa u japin mundësi studentëve të eksperimentojnë me idetë e tyre dhe të marrin mbështetje për realizimin e tyre në tregun e biznesit[429]. Në këtë mënyrë, TBU jo vetëm që përgatit studentët me njohuri akademike, por edhe i orienton ata drejt punësimit dhe zhvillimit profesional përmes një rrjeti të fuqishëm bashkëpunimesh dhe mundësish praktike.

Institucioni ka një fokus të qartë në mbështetje të punësimit të studentëve dhe këtë e ka integruar në politikat e tij edukative dhe praktikat e mësimdhënies. Gjatë vitit akademik 2023-2024, janë realizuar pyetësorë për të monitoruar situatën e punësimit të studentëve. Sipas të dhënave, rreth 50% e studentëve të ciklit Bachelor dhe 77% e studentëve të ciklit të dytë (Master) janë të punësuar, që tregon një përqindje të lartë angazhimi të studentëve në

[427] 34.1.Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 34.2.Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 34.3.Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU.

[428] 7. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029.

[429] 38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët; https://tbu.edu.al/tbu-post/; https://tbu.edu.al/studentet/#klube-konkurse.

tregun e punës.[430] Për më tepër, universiteti siguron mundësi praktike për studentët përmes praktikave mësimore, duke i orientuar ata të bëjnë praktika gjatë vitit akademik, dhe ndihmon ata të zhvillojnë aftësi të vlefshme për tregun e punës. Ky përqindje i jep mundësinë studentëve të fitojnë përvojë profesionale para diplomimit, gjë që mund të përmirësojë shanset e tyre për punësim pas përfundimit të studimeve.
Kjo politikë e mbështetjes aktive për punësimin e studentëve është një pjesë integrale e strategjisë së institucionit për të siguruar që studentët të jenë të gatshëm për tregun e punës, duke i ofruar mundësi zhvillimi të aftësive praktike, si dhe mundësi punësimi gjatë periudhës së studimeve.

**Standardi V.9 Institucioni ruan lidhje të vazhdueshme me ish-studentët e tij.**

Një nga objektivat strategjikë të TBU-së është ruajtja e lidhjeve të qëndrueshme me ish-studentët, duke siguruar mbështetje dhe mundësi angazhimi përmes aktiviteteve dhe komunikimit të vazhdueshëm. Institucioni ka krijuar një rrjet të fortë lidhjesh me ish-studentët, duke ofruar mundësi të vazhdueshme për ata për t'u angazhuar në aktivitete profesionale dhe shoqërore, si dhe për të marrë pjesë në ngjarje që mundësojnë shpërndarjen e përvojave dhe mundësive të reja.
Kjo lidhje aktive me ish-studentët ka për qëllim të sigurojë që ata të mund të kontribuojnë me ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mbështesin të rinjtë që janë ende në procese studimi. Po ashtu, ky rrjet ndihmon në monitorimin e suksesit të studentëve pas diplomimit, duke ofruar mundësi për punësim dhe zhvillim profesional në fusha të ndryshme. Në këtë mënyrë, TBU jo vetëm që krijon mundësi për zhvillimin e studentëve gjatë periudhës së studimeve, por gjithashtu vazhdon t'i mbështesë ata pas diplomimit, duke e ruajtur lidhjen për një periudhë të gjatë pas përfundimit të studimeve.[431]

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

TBU ka zbatuar një proces transparent dhe të rregulluar për pranimin e studentëve në programet Bachelor dhe Master. Kriteret e përgjithshme dhe të posaçme përcaktohen qartë, duke garantuar një proces të drejtë dhe të bazuar në meritokraci. Departamenti akademik ka përgjegjësinë e përcaktimit të numrit të studentëve që pranohen, duke ruajtur cilësinë akademike. Institucioni pranon si studentë shqiptarë ashtu edhe të huaj, duke ndjekur standardet ndërkombëtare të mobilitetit akademik dhe njohjes së diplomave. Për më tepër, mundësia e transferimeve të studentëve dhe ndjekja e një programi të dytë studimi përforcojnë fleksibilitetin dhe diversitetin e arsimit të ofruar.
Institucioni ka ngritur Komisionin e Marrëdhënieve me Studentët (KMS) për të siguruar mbështetje akademike dhe profesionale. Ky komision organizon takime të rregullta me përfaqësuesit e studentëve, garanton respektimin e Kodit të Etikës dhe promovon përfshirjen e studentëve në jetën akademike dhe sociale. TBU ka gjithashtu Zyrën e Çështjeve

[430] 35. Raporti Vjetor TBU 23-24, fq.54-59.
[431] 35. Raporti Vjetor TBU 23-24; 29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.3.FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP; 29.4.TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës; 29.5.FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP.

Studentore, e cila ndihmon studentët të përgatiten për tregun e punës përmes këshillimit, trajnimeve dhe panaireve të karrierës. Në bashkëpunim me sektorin privat, institucioni siguron mundësi për punësim dhe praktika profesionale, duke i ndihmuar studentët të bëhen më konkurrues në tregun e punës.

TBU ka zbatuar një strategji të fuqishme marketingu, duke përdorur kanale digjitale si: rrjetet sociale (LinkedIn, Facebook, Instagram, YouTube), media tradicionale dhe evente promovuese. Përmes konkurseve dhe aktiviteteve formuese si "Sipërmarrësit e së Nesërmes" dhe "TECHnovators", universiteti identifikon dhe mbështet talentet e reja. Pjesëmarrja në panaire dhe këshillimi për karrierën ndihmojnë maturantët dhe studentët të informohen mbi programet akademike dhe mundësitë e zhvillimit profesional. Përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Mësimit (LMS) të bazuar në Moodle dhe platformave të tjera teknologjike garanton akses të vazhdueshëm në materialet akademike dhe komunikim efikas ndërmjet studentëve dhe stafit.

TBU ka krijuar struktura të qëndrueshme për angazhimin e studentëve në proceset akademike dhe institucionale. Këshilli Studentor, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Senati Studentor ofrojnë hapësira për studentët që të shprehin opinionet dhe të marrin pjesë në përmirësimin e cilësisë së arsimit. NJSBC përfshin përfaqësues studentorë në vlerësimin e standardeve akademike dhe ndjek një kulturë të cilësisë që siguron përputhshmëri me kërkesat e tregut të punës dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare. Ky përkushtim rrit përgjegjësinë institucionale dhe cilësinë e shërbimeve arsimore të ofruara.

Institucioni ka një politikë të qartë për orientimin dhe këshillimin e studentëve përmes strukturave të dedikuara si Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshilltarët Akademikë. Këto njësi luajnë një rol kyç në përgatitjen e studentëve për tregun e punës duke ofruar këshillim të karrierës, organizim të *workshop*-eve dhe trajnimeve, si dhe lehtësimin e praktikave profesionale dhe punësimit të pjesshëm. Gjithashtu, përmes panaireve të punës dhe rrjetit Alumni, studentët dhe të diplomuarit mbështeten në zhvillimin profesional dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Përfaqësimi i studentëve në organet akademike të universitetit forcon edhe më shumë zërin e tyre në vendimmarrje, duke siguruar një mjedis akademik gjithëpërfshirës dhe mbështetës.

TBU ndjek një politikë gjithëpërfshirëse mbështetëse duke krijuar mundësi të shumta për zhvillimin akademik, personal dhe profesional të studentëve. Institucioni promovon një ambient të favorshëm për përfshirjen e të gjithëve, duke organizuar aktivitete artistike, kulturore, sportive dhe sociale, si dhe duke nxitur pjesëmarrjen në konkurse dhe konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Përmes krijimit të klubeve studentore si Entrepreneurs Club, Innovation Club dhe Debating Club, studentët marrin mundësi për të zhvilluar aftësitë dhe pasionet e tyre. Bashkëpunimet me organizata prestigjioze dhe mbështetja financiare për studentët me vështirësi ekonomike e bëjnë TBU një institucion të angazhuar në garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë.

Në aspektin akademik, institucioni ofron literaturë cilësore dhe të përditësuar përmes bazave të të dhënave akademike, duke siguruar akses në materiale shkencore dhe kërkimore të rëndësishme. Strukturimi i syllabuseve me literaturë bazë dhe ndihmëse ndihmon studentët të orientohen më mirë në studimet e tyre. Përveç teksteve tradicionale, literatura përfshin edhe artikuj shkencorë, studime të fundit dhe burime online, duke ofruar një qasje të gjerë ndaj dijes. Puna për rinovimin e abonimeve në platforma si: Scopus Research tregon përkushtimin e institucionit për të garantuar burime akademike cilësore dhe të përditësuara për studentët e tij.

Në funksion të përgatitjes së studentëve për tregun ndërkombëtar të punës, TBU investon në mundësitë e mobilitetit akademik, bashkëpunimet me universitete të huaja dhe krijimin e një

programi studimor të njohur ndërkombëtarisht. Përmes marrëveshjeve me kompani dhe institucione të ndryshme, studentët përfitojnë nga praktikat profesionale, punësimi i pjesshëm ose i plotë, si dhe trajnime të specializuara. Memorandumet e bashkëpunimit me kompani të rëndësishme si: BALFIN Group, Deutsche Sparkassenstiftung dhe bankat kryesore shqiptare i ofrojnë studentëve një avantazh të dukshëm në hyrjen në tregun e punës. Së fundmi, institucioni ka një angazhim të qartë në mbështetjen e sipërmarrjes dhe inovacionit, duke krijuar një rrjet të gjerë partneritetesh me kompani dhe institucione që ofrojnë mundësi të shumta për studentët. Përmes rrjetëzimit dhe mentorimit nga profesionistë të njohur, studentët marrin mbështetje të vazhdueshme për të zhvilluar karrierën e tyre. Plani për krijimin e një rrjeti ekzekutiv partnerësh deri në vitin 2025 tregon vizionin e institucionit për të ofruar mbështetje afatgjatë për studentët dhe të diplomuarit në zhvillimin e tyre profesional.

Standardet e **Fushës së vlerësimit**: **"Studentët dhe Mbështetja e tyre" janë përmbushur plotësisht**.

**Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm**

**Tirana Business University (TBU)** angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të garantuar përputhshmërinë me standardet më të larta akademike. Procesi i akreditimit institucional është një mjet i rëndësishëm për të siguruar që programet e studimit dhe shërbimet universitare i përgjigjen dinamikës së tregut të punës dhe nevojave të shoqërisë. Për këtë arsye, TBU ka përcaktuar si prioritet kryesor cilësinë në mësimdhënie dhe formimin e studentëve të aftë për sfidat e tregut.

Një element kyç në zhvillimin e universitetit është trajnimi i vazhdueshëm i stafit akademik dhe rritja e bashkëpunimeve ndërkombëtare përmes programeve të mobilitetit dhe shkëmbimeve akademike. Këto nisma synojnë jo vetëm ngritjen profesionale të pedagogëve, por edhe rritjen e ekspozimit të studentëve ndaj metodave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Menaxhimi i universitetit bazohet në vendimmarrje të strukturuar dhe procese transparente. Diskutimet dhe debatet konstruktive në forumet akademike dhe administrative sigurojnë një qeverisje efektive, duke garantuar që burimet financiare dhe infrastrukturore të përdoren në mënyrë optimale. Për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare, TBU ka ndërtuar politika të qarta për sigurimin e fondeve dhe diversifikimin e burimeve të financimit të programeve të studimit.

Në kuadër të kërkimit shkencor dhe inovacionit, TBU ka miratuar një strategji të detajuar për zhvillimin e projekteve kërkimore dhe partneriteteve akademike. Përmes vendimeve të Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, janë përcaktuar kritere të qarta për ndarjen e fondeve të kërkimit shkencor, duke i dhënë përparësi projekteve me ndikim konkret në zhvillimin e fushave të biznesit, teknologjisë dhe ekonomisë. Një mekanizëm i dedikuar monitorimi siguron që këto projekte të zbatohen në mënyrë efektive dhe të prodhojnë rezultate me vlerë për komunitetin akademik dhe më gjerë.

Cilësia e mësimdhënies dhe programeve të studimit mbetet një përparësi kryesore. TBU ka krijuar një kulturë të vlerësimit të vazhdueshëm, ku përmes sondazheve, fokus-grupeve dhe analizave të tregut të punës, sigurohet që programet akademike të jenë në përputhje me nevojat e kohës. Ky angazhim për përmirësim të vazhdueshëm e ka vendosur universitetin në një pozitë konkurruese në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Në aspektin e administrimit dhe mbështetjes për studentët, TBU ka investuar në platforma digjitale të menaxhimit akademik, duke përfshirë Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Mësimor dhe portalin TBU LMS, të cilat lehtësojnë ndjeshëm aksesin në informacion dhe përmirësojnë përvojën akademike të studentëve. Po ashtu, universiteti ka përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e tij, duke krijuar një mjedis modern dhe të përshtatshëm për zhvillimin akademik.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është roli aktiv i studentëve në vendimmarrje dhe politikëbërje. Struktura të dedikuara përfaqësuese u mundësojnë studentëve të jenë pjesë e proceseve kryesore që ndikojnë në përvojën e tyre akademike, duke ndihmuar në krijimin e një kulture të hapur dhe bashkëpunuese.

Falë angazhimit të vazhdueshëm për përmirësim dhe përshtatje me tendencat bashkëkohore të arsimit të lartë, TBU ka arritur të përmbushë të gjitha standardet e vlerësimit në fushat kryesore:

- **Institucioni i Arsimit të Lartë, Menaxhimi, Autonomia dhe Sigurimi i Cilësisë** – TBU operon në përputhje me standardet më të larta të cilësisë dhe qeverisjes akademike.
- **Burimet dhe Partneriteti** – TBU i shfrytëzon në mënyrë efektive për të mbështetur zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.
- **Programet e Studimit, Mësimdhënia dhe Vlerësimi** – TBU i projekton dhe zbaton sipas kërkesave akademike dhe nevojave të tregut të punës.
- **Aktiviteti Shkencor, Inovacioni dhe Kërkimi** – TBU nxit dhe mbështetet kërkimin shkencor dhe inovacionin, për të siguruar rezultate me ndikim në zhvillimin akademik dhe profesional.
- **Studentët dhe Mbështetja e Tyre** – TBU garanton një përvojë akademike gjithëpërfshirëse, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për suksesin e tyre.

Në një periudhë të transformimeve të shpejta dhe të dinamizmit të vazhdueshëm në fushën e arsimit të lartë, është e domosdoshme që TBU të zhvillojë një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi situatën e tij aktuale, si dhe të identifikojë mundësitë dhe sfidat që mund të ndikojnë në ardhmen.

Ky vlerësim është i domosdoshëm për të ofruar një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi mundësitë për rritje, përmirësim dhe konsolidim të pozicionit të TBU-së, duke marrë parasysh gjithashtu sfidat që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin afatgjatë. Me anë të kësaj analize, TBU do të mund të krijojë një strategji të qëndrueshme dhe të orientuar, që fokusohet në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, mundësive profesionale për studentët dhe forcimin e partneriteteve me aktorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë. Pas këtij vlerësimi, kalojmë në një analizë më të thelluar të forcave dhe mundësive që ofron TBU, si dhe për të identifikuar fushat që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm.

**Pikat e Forta:**

1. TBU disponon një infrastrukturë të fortë dhe të qëndrueshme, e cila është ndërtuar për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të institucioni dhe për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për mësimdhënie dhe kërkime shkencore. Menaxhimi i TBU-së është efikas dhe i orientuar nga rezultatet, duke siguruar transparencë të plotë në çdo proces dhe duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe standardet e kërkuara nga autoritetet përkatëse.

2. TBU ofron një proces transparent dhe të strukturuar pranimi, i cili siguron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët. Universiteti ofron një mbështetje të fuqishme për zhvillimin e karrierës së studentëve, duke siguruar mundësi të shumta praktike dhe bashkëpunime të drejtpërdrejta me tregun e punës. Gjithashtu institucioni mbështet dhe inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete e evente social-kulturore e sportive dhe promovon studentët me arritje gjatë studimeve të tyre.
3. TBU ka investuar në zhvillimin e një infrastrukture moderne dhe të përshtatshme për veprimtarinë akademike, kërkimore dhe administrative. Mjediset e punës, mësimore dhe laboratorike janë të organizuara në mënyrë që të ofrojnë kushte optimale për personelin akademik dhe studentët. Pjesë e kësaj infrastrukture janë gjithashtu mjediset e pushimit dhe argëtimit, që mbështesin një balancë të shëndetshme mes punës dhe jetës sociale për të gjithë të përfshirët.
4. Programet e studimit në TBU janë të dizajnuara për të respektuar plotësisht standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ofruar një strukturë të qartë dhe të dokumentuar që siguron një rrugë të përshtatshme për studentët në udhëtimin e tyre akademik. Çdo program është i planifikuar me kujdes për të integruar praktikat profesionale dhe elementët e zhvillimit të aftësive praktike, të cilat janë thelbësore për përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës. Kjo qasje synon të ofrojë një lidhje të fortë mes mësimdhënies teorike dhe aplikimeve praktike, duke mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësi të nevojshme për të konkurruar në një mjedis profesional.
5. Forca kryesore e kërkimit shkencor në TBU qëndron në strategjinë e qartë dhe të strukturuar për periudhën 2024–2029. Kjo strategji, e mbështetur nga Balfin Group, ofron një bazë të fuqishme për zhvillimin akademik dhe për realizimin e projekteve kërkimore të nivelit të lartë. Mbështetja e këtij grupi të rëndësishëm biznesi siguron një nivel të lartë të financimit dhe mundësi të ndryshme bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, duke mundësuar krijimin e mundësive të reja për studentët dhe stafin akademik. Kjo ndihmon në rritjen e ndikimit të kërkimit shkencor, si dhe në avancimin e TBU-së si një lider në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri dhe më gjerë.
6. TBU ka zhvilluar një proces të rregullt dhe të qartë të vlerësimit të cilësisë, që është i integruar në të gjitha nivelet e funksionimit të institucionit. Ky proces përfshin përdorimin e metodave të ndryshme vlerësimi, përfshirë sondazhe, pyetësorë dhe fokus-grupe, që mbështeten në feedback-un e studentëve, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara.
7. TBU siguron një menaxhim të shëndetshëm dhe të rregullt financiar, duke përputhur pasqyrat financiare me standardet ligjore dhe duke ofruar transparencë të plotë për të ardhurat dhe shpenzimet e tij. Ky nivel transparence është i rëndësishëm për të siguruar besimin e palëve të interesuara dhe për të garantuar që resurset financiare përdoren në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.
8. TBU ka zhvilluar një strategji të hapur dhe bashkëpunuese për partneritetet ndërkombëtare, duke përfshirë mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve. Bashkëpunimi me institucione të tjera në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar është një nga forcat kyçe të TBU, duke i mundësuar atij të rrisë cilësinë e arsimit dhe



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

të zhvillojë praktika profesionale që janë të drejtuara nga kërkesat e tregut global të punës.

9. TBU ka një angazhim të qartë për mbështetje të inovacionit dhe sipërmarrjes, duke krijuar një ekosistem që promovon ide të reja dhe mundësi për zhvillim. Partneritetet me kompani dhe mundësitë për mentorim i japin mundësi studentëve të zhvillojnë idetë dhe projektet e tyre sipërmarrëse.
10. Në kuadër të zgjerimit të mundësive të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe forcimit të pozicionit të TBU në arenën akademike, ka krijuar partneritete të qëndrueshme në kuadër të programit Erasmus+. Këto partneritete ofrojnë mundësi për studentët dhe stafin akademik të TBU-së për të zhvilluar shkëmbime të njohurive, praktika profesionale, dhe bashkëpunime kërkimore, duke kontribuar kështu në forcimin e kapaciteteve të institucionit dhe në krijimin e mundësive të reja për zhvillim akademik dhe profesional.
11. TBU ka ndërtuar një kornizë mbështetjeje të fortë për kërkimin shkencor, duke ofruar mundësi financimi, mbështetje administrative, dhe infrastrukturë të përshtatshme për projekte kërkimore. Ky angazhim do të kontribuojë në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së kërkimit. TBU gjithashtu ka implementuar një sistem të strukturuar për vlerësimin e kërkimit shkencor, duke përdorur indikatorë të matjes për performancën kërkimore dhe monitorimin e objektivave shkencorë. Kjo është mbështetur nga një Kod Etik që siguron se aktivitetet kërkimore realizohen sipas standardeve etike dhe profesionale, përfshirë trajnimet dhe seminarët mbi përdorimin etik të teknologjive si inteligjenca artificiale.

**Pikat e dobëta:**

- Mungesa e mundësive të përshtatshme për transport dhe qasja më e kufizuar në infrastrukturën rrugore mund të ndikojnë në lehtësinë e aksesit për studentët dhe staf, veçanërisht ata që vijnë nga zonat e largëta.
- Mungesa e hapësirave të mjaftueshme dhe faciliteteve për aktivitete sportive.

**Mundësitë:**

- Bashkëpunimi me universitete evropiane, duke përfshirë mundësinë e ofrimit të diplomave të dyfishta (dual diploma), mund të sjellë përfitime të shumta për TBU-në. Ky lloj bashkëpunimi ofron mundësi për zhvillimin e programeve akademike të përbashkëta, ku studentët mund të fitojnë dy diploma të njohura ndërkombëtarisht pas përfundimit të një programi të studimit të përbashkët me një universitet të huaj.
- Ofrimi i **programeve të reja në anglisht** është një mundësi e shkëlqyer për të rritur konkurrencën dhe për të tërhequr studentë të huaj, duke kontribuar në internacionalizimin e TBU-së.
- **Shfrytëzimi i fondeve të Bashkimit Evropian dhe mundësitë për kërkime ndërkombëtare:** TBU mund të rrisë pjesëmarrjen në projekte kërkimore financuar nga Bashkimi Evropian dhe mund të aplikojë për grante ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e kërkimeve shkencore, veçanërisht ato që lidhen me inovacionin dhe

zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo mund të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve kërkimore të universitetit dhe në ngritjen e nivelit të njohjes ndërkombëtare.

**Kërcënime:**

- Rritja e konkurrencës, si nga institucionet e arsimit të lartë brenda vendit, ashtu edhe ato jashtë tij, paraqet një kërcënim të rëndësishëm për stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit tonë.
- Një tjetër kërcënim për institucionin tonë është prirja në rritje e emigracionit, ku individët e arsimuar dhe të talentuar preferojnë të largohen nga vendi për të kërkuar mundësi më të mira në shtetet e zhvilluara. Ky "largim i trurit" ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit dhe kërkimit në institucion, duke shkaktuar një boshllëk të aftësive dhe ekspertizës brenda vendit.

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

1. **Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së**

| | |
|---|---|
| 01. | Plani Veprimit TBU |
| 1. | Statuti TBU |
| 1.1. | Organigrama e re me vulën e MAS |
| 2. | Rregullore e Senatit Akademik |
| 3. | Rregullore e Kolegjit Universitar TBU |
| 3.1. | Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë |
| 3.2. | Rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit |
| 3.3. | Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike - QKSEJ |
| 4.1. | Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD) |
| 4.2. | Rregullore e Departamentit të Drejtësisë (FBD) |
| 4.3. | Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI) |
| 4.4. | Rregullore e Departamentit të Informatikës Ekonomike (FTI) |
| 4.5. | Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike (FTI) |
| 4.5.1. | Plan pune dhe aktivitete DBF 2023-2024 |
| 4.5.2. | Raporti vjetor i DBF 2023-2024 |
| 4.5.3. | Plan pune dhe aktivitete DBF 2024-2025 |
| 5.2.1. | Plan pune dhe aktivitete DD 2024-2025 |
| 5.2.2. | Raporti Vjetor i DD 2023-2024 |
| 5.3.1. | Plan pune dhe aktivitete DIS 2023-2024 |
| 5.3.2. | Raporti vjetor i DIS 2023-2024 |
| 5.3.3. | Plan pune dhe aktivitete DIS 2024-2025 |
| 5.4.1. | Plan pune dhe aktivitete DIE 2023-2024 |
| 5.4.2. | Raporti vjetor i DIE 2023-2024 |
| 5.4.3. | Plan pune dhe aktivitete DIE 2024-2025 |
| 5.5.1. | Plan pune dhe aktivitete DIK 2023-2024 |
| 5.5.2. | Raporti vjetor i DIK 2023-2024 |
| 5.5.3. | Plan pune dhe aktivitete DIK 2024-2025 |
| 6. | Plani strategjik vjetor 2024-2025 |
| 7. | Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029 |
| 7.1. | Plan Operacional për realizimin e OBJ_SZH TBU 24-29 |
| 8. | Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale |
| 9. | Kodi i Etikës |
| 10. | Marrëveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik |
| 10.1. | Marrëveshja e MAS_TBU_ 2018 _ Përcaktimi i Personeli Akademik |
| 11. | Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve në godinën e re TBU 2024 |
| 11.1. | Raporti i MAS_mbi verifikimin e kapaciteteve në TBU 22-23 |
| 11.1.1. | VKM-nr.-418-date-10.5.2017 |
| 11.2. | Çertifikatë zjarri_TBU |
| 12. | Politika e Marketingut për Programet e Studimit |
| 13.1.1. | Procedura vendim për ndryshime në Statut nga TBU |
| 13.1.2. | Procedura e miratimit të ndryshimeve në Statut nga MAS |
| 13.2. | Vendim Senati për miratimin e Strategjisë të Zhvillimit & Strategjisë të Kërkimit 2024 |

13.3. Procedura e zgjedhjes të Senatit
13.4. Vendimmarrja e zgjedhjes së Rektorit
13.5. Vendimmarrja e zgjedhjes së Dekanëve
13.6. Vendimmarrja për përzgjedhjen e Përgjegjësve të Departamentit
13.6.1. Vendim për emerimin e drejtuesit dhe anëtarëve të QSKEJ 24-25
13.7. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25
13.8.1. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë TBU_ 24
13.8.2. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FBD_ 24
13.8.3. Procedura e zgjedhjes së Komisionit të Cilësisë FTI_ 24
13.9.1. Procedura e përzgjedhjes së KMS_TBU_24
13.9.2. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FBD_24
13.9.3. Procedura e përzgjedhjes së KMS_FTI_24
13.10. Përzgjedhja e Komisionit të Etikës
13.11. Vendim për miratimin e planit lëndor semestral (sem.2) 24-25
13.12. Procesi i vendimmarrjes_planet_mësimore 24-25
13.13. Vendim për miratimin e personelit akademik njësive bazë - PAE & PAK 24-25
13.13.1. Vendim për strukturën e personelit akademik 24-25
13.14. Procedura e miratimit të Rregulloreve & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2023
13.15. Procedura e miratimit të Rregulloreve, Politikave & Udhëzimeve (si rezultat i ndryshimeve në Statut) 2024
13.15.1. Vendim Senati për një ndryshim në Rregulloren e Këshillit Studentor
13.16. Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25
13.17. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ba AB-IE-IS-IK
13.18. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 23-24
13.19. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut/pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD
13.19.1. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut/pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI
13.20. Procedura për miratimin e planit strategjik vjetor 24-25
13.21. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD
13.21.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI
13.22. Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25
13.23. Vendim për strukturën akademike 24-25
13.24. Vendim Senati për emërimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave (DPO)
14. Liria akademike dhe autonomia financiare (extract Neni 6 Statuti TBU)
15. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmesakademik dhe administrativ të “TBU“
15.1. Politika e BNJ në TBU
16. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik
16.1. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori – kolegu
17. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët
18.1.1. Kontratë Qeraje 2021
18.1.2. Pasqyrat Financiare 2021
18.1.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2021


TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

18.2.1. Kontratë Qeraje 2022
18.2.2. Pasqyrat Financiare 2022
18.2.3. Raporti i Audituesit të pavarur 2022
18.3.1. Kontratë Qeraje Godina e Re_TBU-UAT 13.12.2023
18.3.2. Procesverbal Inventari 29.12.2023
18.3.3. Pasqyrat Financiare 2023
18.3.4. Pasqyrat Financiare 2023 & Raporti Audituesit të pavarur
19. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27
20. Rregullore për shkëmbimin e stafit
20.1. Rregullore për shkëmbimet studentore
20.1.1. IIA_TBU_Staffordshire_University_2017
20.1.2. IIA_TBU_Staffordshire_University_2018
20.1.3. Inter-Institutional Agreement_Bielefeld
20.1.4. ICCM Agreement
20.1.5. MoU_UniCusano_TBU
20.1.6. WSB - TBU - MoU – 2024
20.1.7. MoU Obuda
20.1.8. MoU Italy
20.1.9. MoU IGS- TBU
20.2. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve
21. Strategjia e Zhvillimit të IT
21.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
21.2. Udhëzues për përdorimin e strukturës së TI deri në Dhjetor 23
22.1. Politikat Institucionale të Publikimit të Informacionit
22.2. Rregullore e Arkivit
23. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies
23.1. Politika për propozimin e programeve të reja
23.2. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU
23.3. Kodi Etik i Kërkimit Shkencor në TBU
23.4. Politika e Vlerësimit të Arritjeve Akademike të Studentëve TBU
23.5. Politika për Shërbimet Mbështetëse në TBU
23.6. Rregullore e Transferimeve në TBU
24.1. Rregullore NJSBC
24.2. Relacion i NJSBC 2023-2024
24.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025
24.4.1. Raport i KC TBU 2023-2024
24.4.2. Raport i KC FBD 2023-2024
24.4.3. Raport i KC FTI 2023-2024
24.5.1. Plan pune i KC TBU 24-25
24.5.2. Plan pune i KC FBD 24-25
24.5.3. Plan pune i KC FTI 24-25
24.6. Njoftim për studentët për zhvillimin e pyetësorit
24.6.1. TBULMS-al-mood-questionnaire-Vlerësimi i pedagogëve dhe-lëndëve
24.7. Raporti i Fokus Grupeve 23-24
25.1. Kontrolli i dijes dhe procedura e diplomimit (Shkëputur nga Rreg. e Instucionit)



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

25.2. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës (me anekse)
26.1.1. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi"
26.1.2. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi" 60 ECTS
26.1.3. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në"Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS
26.1.4. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"
26.1.5. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike
26.1.6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Software
26.1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike
26.1.8. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike
26.1.9. Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software
26.2. Lista e programeve të studimit, të dhënat për licencimin dhe akreditimin e tyre
26.3.1. Broshure Bachelor "Administrim Biznesi" me 3 Profile
26.3.2. Broshure Master Profesional 60 ECTS "Administrim Biznesi" Profili Menaxhim -Fin-Kon
26.3.3. Broshure Master Profesional i Avancuar 120 ECTS "Administrim Biznesi" Profili Menaxhim
26.3.4. Broshure Master Profesional i Avancuar 120 ECTS "Administrim Biznesi" Profili Fin-Kon
26.3.5. Broshure Master Profesional i Avancuar 120 ECTS "Administrim Biznesi" Profili "E Drejte Biznesi"
26.3.6. Broshure Master i Shkencave "Administrim Biznesi"
26.3.7. Broshure Bachelor "Inxhineiri Software"
26.3.8. Broshure Bachelor "Inxhinieri Kompjuterike"
26.3.9. Broshure Bachelor "Informatike Ekonomike"
26.3.10. Broshure Master i Shkencave "Informatike Ekonomike"
26.3.11. Broshure Master i Shkencave "Inxhinieri Software"
27.1.1. Miratimi i formës së diplomës Ba AB MEN
27.1.1.1. Suplement Ba AB MEN
27.1.2. Miratimi i formës së diplomës Ba AB FINKON
27.1.2.1. Suplement Ba AB FINKON
27.1.3. Miratimi i formës së diplomës Ba AB MKG
27.1.3.1. Suplement Ba AB MKG
27.1.4. Miratimi i formës së diplomës MP AB MEN 60
27.1.4.1. Suplement MP MEN 60
27.1.5. Miratimi i formës së diplomës MP KF 60
27.1.5.1. Suplement MPKF60
27.1.6. Miratimi i formës së diplomës MP AVANC.MEN 120
27.1.6.1. Suplement MP 120 MEN
27.1.7. Miratimi i formës së diplomës MPAVANCUAR KF
27.1.7.1. Suplement MPKF 120
27.1.8. Miratimi i formës së diplomës MP AVANC.MIX 120

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

27.1.8.1. Suplement MP MIX 120
27.1.9. Miratimi i formës së diplomës MSH AB
27.1.9.1. Suplement MSHAB
27.2.1. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Menaxhim
27.2.1.1. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i Diplomës - Profili Menaxhim
27.2.2. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës- Profili Kontabilitet Financë
27.2.2.1. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës Profili Kontabilitet Financë
27.2.3. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Marketing
27.2.3.1. TBU - FBD - Ba Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Marketing
27.2.4. TBU - FBD - MP60 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Kontabilitet Financë
27.2.4.1. TBU - FBD - MP60 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Kontabilitet Financë
27.2.5. TBU - FBD - MP60 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës – Profili Menaxhim
27.2.5.1. TBU - FBD - MP60 Administrim - Biznesi -- Suplementi i propozuar i ri i diplomës – Profili Menaxhim
27.2.6. TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili E drejte biznesi
27.2.6.1. TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili E drejte biznesi
27.2.7. TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Kontabilitet Financë
27.2.7.1. TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Kontabilitet Financë
27.2.8. TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës - Profili Menaxhim
27.2.8.1. TBU - FBD - MP120 Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës - Profili Menaxhim
27.2.9. TBU - FBD - MSH Administrim - Biznesi - Forma e propozuar e re e diplomës
27.2.9.1. TBU - FBD - MSH Administrim - Biznesi - Suplementi i propozuar i ri i diplomës
27.2.10. TBU - FTI - Ba Inxhinieri Softuerike - Forma e propozuar e diplomës
27.2.10.1. TBU - FTI - Ba Inxhinieri Softuerike - Suplementi i propozuar i diplomës
27.2.11. TBU - FTI - Ba Inxhinieri Kompjuterike - Forma e propozuar e diplomës
27.2.11.1. TBU - FTI – Ba Inxhinieri Kompluterike - Suplementi i propozuar i diplomës
27.2.12. TBU - FTI - Ba Informatikë Ekonomike - Forma e propozuar e diplomës
27.2.12.1. TBU - FTI - Ba Informatikë Ekonomike - Suplementi i propozuar i diplomës
27.2.13. TBU - FTI- MSH - Inxhinieri Softuerike - Forma e propozuar e diplomës

27.2.13.1. TBU - FTI - MSH Inxhinieri Softuerike - Suplementi i propozuar i diplomës
27.2.14. TBU - FTI – MSH Informatikë Ekonomike - Forma e propozuar e diplomës
27.2.14.1. TBU - FTI - MSH Informatkë Ekonomike - Suplementi i propozuar i diplomës
28. Procedura që ndiqet në rast apelimi apo ankimimi (Shkëputur nga Rregullore e TBU)
29.1. Studimi i tregut të punës
29.2. TBU - FBD - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës
29.3. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP
29.4. TBU - FTI - AGJENDA - Bordi i Tregut të Punës
29.5. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP
30. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU)
31. TBU - Rregullore e Sekretarisë
32.1. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025
32.2. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite
32.3. Rregullore e Këshillit Studentor
32.3.1. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25
32.3.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25
32.4.1. Plan i KMS 23-24 TBU
32.4.2. Relacion i KMS 23-24 TBU
32.4.3. Plan i KMS 24-25 TBU
32.4.4. Plan i KMS 23-24 FTI
32.4.5. Relacion i KMS 23-24 FTI
32.4.6. Plan i KMS 24-25 FTI
32.4.7. Plan i KMS 23-24 FBD
32.4.8. Relacion i KMS 23-24 FBD
32.4.9. Plan i KMS 24-25 FBD
32.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23
32.6. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25
32.7. Skema e bursave sociale në TBU
33.1. Stratregjia e Kërkimit Shkencor në TBU
33.1.1. Plan Operacional për realizimin e OBJ_SKSH TBU 24-29
33.2. Indikatorët e matjes së performances
33.3. Politika për grantet e punës kërkimore dhe shkencore
33.4.1. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24
33.4.2. Plan pune për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 24-25
33.5. Raporti Vjetor për Realizimin e Planit të Punës për Kërkimin Shkencor të QKSEJ 23-24
33.6. Raportimi i punës shkencore në TBU ( në rang institucioni)
33.7.1. Program of TBU Conference
33.7.2. Brochure Scientific Conference TBU
33.8. Parimet e Organizimit të Zyrës së Projekteve për Kërkim & Zhvillim
34. Politika për Bashkepunimin Ndërkombëtar-Partneritete & Menaxhimin e Projekteve
34.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi

34.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt
34.3. Shembuj komunikimi të Zyrës së Çështjeve Studentore me organizata/biznese për punësimin e studentëve të TBU
34.4. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
34.4.1. Roli i Zyrës së Çështjeve Studentore në Ambientimin e Studentëve të Rinj
34.5. Rregullore për praktikën mësimore (me anekset përkatëse)
35. Raporti Vjetor TBU 23-24
35.1. Raporti Vjetor TBU 20-21
35.2. Raporti Vjetor TBU 21-22
35.3. Raporti Vjetor TBU 22-23
36. Rrregullore e Këshillimit Akademik
36.1. Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI
37. Rregullore e Bibliotekës
37.1. Database Biblioteka 23-24
37.2. TBU - Procedura e Blerjes se Literatures ne Tirana Business University College
38.1. Aktivitete akademike për pedagogët
38.2. Aktivitete akademike & sociale për studentët
38.3. Ditët informuese në TBU
39. TBU_Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06. 10. 2010 Licensimi i TBU
39.1. Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 506, dt 18.07.2013
39.2. Urdhër MAS Nr. 326,dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve
39.3. Vendim Senati Akademik Nr. 34-1 dt.17.10.2016 Për miratimin e Statutit dhe Organigramës
39.4. Vendim Bordi Nr. 18 dt.26.06.2017 Mbi Statutin e TBU në përputhje me LAL
39.5. Vendim Senati Akademik Miratim i Statutit 2017
39.6. Urdhër MASR Nr.417 dat.20.09.2017 Miratimi i Statutit TBU
39.7. Vendim i Bordit Akredititimi Nr. 104. dt 10.11.2017 Akreditimi i dytë Institucional TBU
39.8. Vendim BA-ASCAL Nr. 56. dt. 16.12.2021 Akreditmit Institucional Periodik TBU
40. Ligj_80-2015